

Korrik 2016
Numri: 100
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ETIKA

100

Gjurmë

në rigjallërimin e së sotmes
dhe në rindërtimin e së ardhmes...

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Korrik 2016

VITI: X

NUMRI: 100

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 607 8484

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Çdo revistë lë një gjurmë pas. Çdo revistë ka një gjurmë në përbërjen e mendimit të përgjithshëm të një vendi. Mirëpo, disa i kanë më të theksuara, sepse ato kanë mundur të lënë gjurmë të përhershme. Sa më shumë gjurmë të lërë në vetëdijen e shoqërisë një linjë mendimi, aq më shumë jeton. Me kalimin e viteve, konturet e revistës theksohen edhe më tepër, sepse vitet janë ato që e vënë në sprovë konsistencën dhe permanencën e një konturi.

Në numrin e parë përcakton një pikëpamje, duke e lidhur veten me disa parime të caktuara. Por kur arrini në numrin e njëqindtë dhe hidhni sytë pas, vallë a keni arritur t'i ruani parimet tuaja? Këtë mund ta vlerësoni edhe vetë. Por ata që do ta vlerësojnë më mirë, janë lexuesit tuaj të rregullt, të cilët kanë cilësinë e një historiani të revistës.

Revista Etika mbush numrin e saj të 100. Një revistë së cilës i ka dalë në qarkullim numri i 100, do të thotë se tashmë ajo ka lënë gjurmë të qarta në historinë e mendimit. Mendojmë se këto gjurmë dallohen edhe nga ata që e ndjekin atë.

Por, se cila është linja, këtë na takon ta themi ne. Nëse shihet me vëmendje në numrin e 100, do të vërehet qartë se pikëpamja kryesore e Revistës Etika, është "ndjeshmëria Islame në çdo çështje". Kjo, sepse Etika e ka filluar rrugën e saj me këto ndjesi:

"Koha në të cilën jetojmë është në kaos. Dhe, shkaku i kësaj është mungesa e Islamit, sepse lidhja midis Islamit dhe jetës është këputur. Fuqitë dominuese botërore, e kanë nxjerrë jashtë loje rolin përcaktues të Islamit, duke e shndërruar atë në një subkulturë. Islami nuk është më përcaktues as në shoqëritë Islame. Koha jonë, është e detyruar të takohet përsëri me Islamin dhe ta bëjë atë mbizotërues në të gjitha fushat e jetës. Dhe për këtë është e domosdoshme që më parë, bota Islame dhe myslimanët ta kuptojnë mirë përgjegjësinë që kanë. Detyra themelore, është ndërtimi i një myslimanizmi të tillë. Ai, është myslimani, zemra e të cilit është brumosur me ndjesinë Islame."

Revista Etika, e di se pa besim dhe përjetësimin e tij, nuk mund të ketë Islam dhe nuk mund t'i jepet asnjë mesazh kohës. Prandaj, ajo beson se hulumtimi ynë kryesor duhet të jetë në këtë drejtim. Këtë e tregon edhe fakti se në të 100 numrat e botimeve të saj, gjendet kjo atmosferë besim monoteist dhe përjetësimi i saj.

Asnjë lëvizje, e cila nuk e vendos në themel të saj "ndjeshmërinë Islame", nuk mund ta ketë të përhershme atë ndjesi dhe nuk mund t'i kalojë me anë të saj rrugët plot pengesa. Motivimi kryesor i Revistës Etika, është ndjenja për të ringjallur shpirtin e bashkimit të myslimanëve, e shprehur ndryshe, "vetëdijen e umetit". Kjo, sepse në fillim të shekullit të kaluar, ne humbëm unitetin e umetit. Procesi që do ta bëjë përsëri Islamin një fuqi botërore, është procesi i unitetit të forcës së umetit. Mirëpo, për këtë, më parë duhet formuar përgjegjësia e umetit në vetëdijet e besimtarëve.

Një nga parimet kryesore të Revistës Etika, është edhe pajisja e besimtarit me ndjenjën e "përgjegjësisë universale". Sikur të jetë përballë përgjegjësisë së marrë direkt prej gojës së Profetit tonë të dashur (a.s.), në Hutben e Lamtumirës: "Ata që ndodhen këtu, le tua çojnë fjalën time atyre që nuk ndodhen këtu. Mbase ata që nuk ndodhen këtu, e kuptojnë më mirë se ata që ndodhen këtu dhe i dalin zot asaj." Ky, është një amanet që i është dhënë besimtarëve të të gjitha kohërave. Ata që i dolën zot kësaj përgjegjësie para nesh, e sollën Islamin deri në ditët tona. Në myslimanizmin tonë, ndodhen përpjekja dhe ndjenjat e tyre.

Nëse myslimani i kohës sonë e merr përsipër këtë përgjegjësi, koha do të takohet përsëri me Islamin dhe Islami do të përçohet në shekujt e ardhshëm. Revista Etika, në të 100 numrat e saj, ka kërkuar gjithmonë njerëz që do ta bartin këtë përgjegjësi. Dhe ajo beson se i ka gjetur shumë prej tyre. Këta do të jenë ata që do të ringjallin Islamin në këtë kohë kaosi dhe do ta përcjellin atë në shekujt e ardhshëm.

Numri i 100 është një e kaluar ku do të mbështetim shpinën tonë. Aty ka përpjekje dhe rezultate të arritura. Por, nuk mjafton. Në 100 numrat e ardhshëm, shpresojmë se do të jemi dëshmitarë të ditëve më të bukura për Islamin.

Përmbajtja




8

Libri i librave
Edison Çeraç



Cilësitë e një edukuesi
Osman Nuri Topbash

34




16

22



Djelmohat që i besuan Allahut
Razije Tekgyl

- 5 Boshti i Teuhidit
Idris Arpat
- 10 Shtatë njerëz të mirë
Murat Kaja
- 13 A e ke parë atë
që hyjnizon epshin e vet?
Ahmet Tashgetiren
- 16 Iluzioni i statistikave
Rene Guenon
- 19 Të kamurit e kohës së Kuranit
Ibrahim Sarmësh
- 26 Nëse puna s'i jepet ekspertit
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 29 E fshehta e shprehjes:
"La ilahe il-lallah"
A. Jasin Demirxhi
- 30 Dy fytyrat e vdekjes
Ali Riza Temel



44

Feja është këshillë 32

Rrënjët islamike të Evropës 38
Massimo Jevolella

Hasan Basriu 44
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Cila është më e rëndësishme për lumturinë,
pamja apo natyra e njeriut?! 47
Sami Byjykkajnak


Ç'të mbjellësh do të korrësh 52
Mustafa Erish

Bajramet e dashurisë dhe respektit 56
Xhafer Durmush

Kuranit, lajmi tronditës 58
Abdullah Draz

Dijetarë të robëruar pas dynjasë 62
Prof. dr. Sulejman Derin

Domosdoshmëria e të lexuarit të Kuranit
Ma. Gilman Kazazi



50

Besimi në Allahun
Prof. dr. M. Jashar Kandemir



54



Boshti i Teuhidit

Idris Arpat

Në themel të luftës së Profetëve ka dy parime universale të cilat nuk ndryshojnë asnjëherë: Teuhidi përballë shirkut (bërja shok Allahut), dhe drejtësia përballë dhunës.

Fjala teuhid do të thotë të njësoh, të bësh një, ndërsa si term, teuhid do të thotë të pranosh se Allahu Teala nuk ka të ngjashëm as në thelbin ekzistencial dhe as në thelbin cilësor. Faza e teuhidit është një aforizëm, i cili shpreh obligimin që ka myslimani për të njësuar Allahun Teala dhe për këtë arsye, Profeti (a.s.) thotë: *“Ai që thotë, La ilahe il-lallah, shpëton.”*

Kur themi njëshmëria e Allahut, ajo që na vjen në mendje në fillim është njëshmëria në esencën e besimit, ndërsa njëshmëria me vepra është pika e dytë, e cila do të thotë se rregullat e vlerësimit të të gjitha veprimeve tona merren nga një burim i vetëm dhe ajo që është e lejueshme, përcaktohet nga këto rregulla.

Meqënëse tokat, qiejt, pasuria dhe bota e ekzistencës, bota e dukshme dhe e padukshme janë të Allahut Teala, edhe autoriteti dhe pushteti janë të Tijat.

Allahu Teala nuk ka të ngjashëm as në thelbin ekzistencial dhe as në thelbin cilësor. Ai nuk është i lindur dhe s’ka lindur askënd. Cilësitë e Tij nuk kanë fund e kufi. (Shih. Sure Ihlas.)

Allahu Teala është Qenia Madhështore të cilin Kur’ani dhe Sunneti e përshkruajnë me 99 emrat më kryesorë. Ashtu sikur nuk e dimë se sa janë në të vërtetë emrat e Allahut, ashtu nuk mund të dijmë

në mënyrë të saktë se ç'kuptim kanë dhe se ç'farë ndikim ka pasqyrimi i tyre në jetën njerëzore dhe në univers. Kështu që, ato që dijme për Allahun Teala nuk janë të qarta dhe të mjaftueshme. Sikur t'i njihim të gjitha dimensionet e "Esmau'l Husna" (Emrat më të bukur të Allahut) dhe të merrnim mësim prej kësaj njohurie, do të zotëronim një botëkuptim më të bukur se atë që kemi sot dhe do të kishim një jetë më cilësore. Botëkuptimi ynë njerëzor dhe shikimi ynë kundrejt materiales do të ishte shumë më i ndryshëm dhe më me nivel.

Kuptimi i teuhidit (njëshmërisë) është i lidhur me kuptimin e "Esmau'l Husna". Nuk na hyn në punë një teuhid i kuptuar si: "Allahu është një dhe nuk është dy". Ç'është përmbajtja e kësaj njëshmërie dhe si pasqyrohet ajo në jetë? Çfarë botëkuptimi zgjon tek ata që e pranojnë? Kjo pra është edhe pika më e rëndësishme.

Allahu është zotëruer i vullnetit dhe Krijuesi Madhështor. Ashtu siç ka caktuar ekzistencën e gjithçkaje, po ashtu cakton edhe qëllimin e saj. (Shih: Sure Nahl, 9.) Allahu rregullon të gjitha çështjet e jetës. Flamurtarët e teuhidit meditojnë për të gjitha çështjet që përmbajnë jetë. Ata zotërojnë një mënyrë shikimi kritik.

E kundërta e teuhidit është adhurimi i tagutit. Tagut është çdo lloj fuqie, institucion apo person, që merr mbi vete kompenat e Allahut dhe mundohet t'i skllavërojë dhe t'i bëjë njerëzit adhurues të tij. Taguti e vazhdon sundimin e vet duke prishur dhe shtrembëruar rregullat e besimit.

"Ju, në jetën tuaj mund të mos kryeni adhurime ndaj njerëzve sikur dilni përpara Allahut dhe falni namaz. Mund të mos prisni kurban për ta, mirëpo, kur këto njerëz ndalojnë diçka kundër vullnetit dhe dëshirës së Allahut, ju nuk i veproni dhe ruheni prej tyre. Dhe, megjithëse këto urdhëra dhe ndalesa bien në kundërshtim me urdhërat dhe ndalesat e Allahut, ju u bindeni atyre. Ja pra, kjo do të thotë shirk (t'i bësh shok Allahut)." (Prof. Dr. H. Karaman, Ensar Vakfi Bülteni Mart-Nisan 1993. s.6.)

Teuhid do të thotë, t'i bëhesh rob vetëm Allahut.

"Thuaj: Namazi im, kurban i im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!" (En'am, 162-163.)

Profeti (a.s.), urdhërohet që krahas adhurimit që bënin mushrikët ndaj putave (zota), tërë jetën e Tij t'ia përkushtonte vetëm Allahut Teala, me namazet, me kurbanet dhe me gjithë qenien e Tij, deri në vdekje, dhe të jetë myslimani i parë që e merr mbi vete këtë detyrë. Kështu, që të deklarojë me besim të plotë dhe të sigurt se kurrë nuk do të njohë zot tjetër përveç Allahut Teala. (Kur'an Yolu, 2. C.)

Pjesa "...Vetëm Ty të adhurojmë" do të thotë, besim, adhurim dhe rregull social. Fjalja "vetëm prej teje kërkohet ndihmë", shpreh sinqeritetin dhe njësimin e Allahut me vepra (të mos e ulim kokën para askujt përveçse para Tij dhe të mos njohim askënd tjetër me cilësitë dhe kompetencat që i takojnë vetëm Atij). Fjalja "Udhëzoni (përforconi) në rrugën e drejtë!" mbart në vetvete, adhurimin, disiplinën, mendimin dhe moralin. (Kur'an Yolu, Shpjegimi i Sures Fatiha)

Meqenëse ne kemi premtuar se do të adhurojmë vetëm Allahun dhe jemi shprehur se jetën tonë ia kemi kushtuar vetëm Atij, do të thotë se ne kërkojmë një jetë, boshti i së cilës të jetë Allahu. Jeta që ka si bosht Allahun, është një jetë që ka për bosht Kuranin, Sunnetin, natyrshmërinë dhe ndërgjegjen. Kurani dhe Sunneti janë shpallja e vullnetit hyjnor. Natyrshmëria është gjendja e parë e njeriut, e cila është rregulluar nga Allahu. Ndërsa ndërgjegjja është zëri i Allahut brenda nesh, i cili është futur në zemrën tonë.

"Jetën time ia kushtova Allahut" do të thotë: "Për mua, kënaqësia e Allahut është gjithmonë në plan të parë." Por ç'është e kundërta e kësaj? Ajo është të kushtuarit e jetës vetëm njeriut ose gjërave të tjera që janë nën nivelin e tij ose e thënë ndryshe të shpërdoruarit e jetës pas dëshirave dhe epsheve. Të kushtuarit e jetës një krijese me të njëjtin nivel, apo edhe më të ulët, nuk përputhet me urtësinë, por gjithashtu nuk është as diçka e logjikshme dhe e natyrshme.

Meqenëse zotëruesi i Tokës dhe i gjithë universit është Allahu i Madhëruar, ndërhyrja në to bëhet vetëm me vullnetin e Tij dhe me aq sa lejon Ai.

"La ilahe" është refuzimi i gabimeve dhe "il-lallah" është pranimi i së drejtës. Shkrimtarë dhe mendimtarë si Niçja, Sartri, Kamy dhe të tjerë, parullën "la ilahe" e përhapën në një fushë të gjerë, por nuk mundën të hynin në kopshtin e "il-lallah". Kjo i çoi ata nga gabimi në gabim. Dhe më në fund, ata u përpëlitën në moçalin e të pashpresëve dhe vuajtën shumë.

Nëse pranohen të drejtat pa u refuzuar gabimet, ndodh përplasje midis të vërtetës dhe të gabuarës. Kjo është një sintezë (lidhje) që tashmë e ka humbur interesin për të vërtetën. Ne myslimanët, ashtu siç jemi të urdhëruar të mos e fshehim të vërtetën, po ashtu jemi urdhëruar edhe të mos e ngatërrojmë të vërtetën me të pavërtetën. (Shih: Bakara, 42.)

E vërteta është ajo, e cila i përshtatet caktimit të Allahut, ndërsa e pavërteta është ajo e cila nuk i përshtatet atij. Teuhidi nuk i pranon as idetë e paqarta që do t'i ngatërrojnë mendjet. Çdo të thotë të rrih e të thuash "la ilahe", ndërsa je duke i hedhur me dhjetra heshta të helmatisura mendjes dhe zemrës? Ashtu siç shprehet dhe Imam Gazzaliu, "Nëse ti nuk e kupton të vërtetën e teuhidit dhe të ndarjes që për-

mban “kelime-i teuhid” (fjala e njësitit të Allahut), atëherë ti nuk je duke thënë “la ilahe il-lallah”. Për këtë e ka fjalën edhe ajeti i nderuar kur shprehet: **“Mjerë për ata, të cilët nuk falen, janë të pakujdes-shëm ndaj namazit”** (Maun 4-5.) Ne jemi të obliguar që më parë të kuptojmë pastaj të përkujtojmë, të dimë pastaj të flasim.

Ashtu si shprehja “Eudhu bil-lahi minesh-shejtani rrahim” nënkupton strehimin tek Allahu për t’u shmangur gabimeve, ashtu edhe shprehja “Bismil-lahi Rrahmani Rrahim” nënkupton pranimin e gjërave të drejta. Nga një këndvështrim, teuhid do të thotë, të jetosh jetën me qëllime të pastra, me rregulla të drejta dhe ndjenja të bukura. Për ne, burimi i së drejtës dhe së bukurës është Kurani Famëlartë dhe Sunneti i Profetit (a.s.). Çdo rregull që përshtatet me Kuranin dhe Sunnetin është brenda kornizës Islame. Si myslimanë që jemi, duhet të studiojmë të gjithë kulturën botërore, dhe duke e pranuar çdo gjë të drejtë mund ta pasurojmë në përmasa të mëdha kulturën dhe botëkuptimin tonë.

Teuhidi pasqyrohet në jetën tonë edhe si drejtësi dhe sinqeritet. Dhe nga ky pasqyrim, lind një pavarësi nga të tjerët, përveç Allahut, dhe një cilësi e mrekullueshme e jetës, sepse gjëja kryesore është që Allahu të pëlqejë qëllimin dhe veprën tonë. Veprat dhe qëllimet që do të paraqiten në një post më të lartë, duhet të jenë pa të meta. Nuk kërkohet pëlqimi i njerëzve, por i Allahut.

Ekzistenca dhe njëshmëria e Allahut e përfshin njeriun nga jash-të dhe nga brenda. **“Vërtet, ata dyshojnë në takimin me Zotin e tyre, por le ta dinë se Ai ka nën kontroll çdo gjë.”** (Fusilet 54.)

E ka përfshirë aq shumë sa që nuk ka asnjë gjethë që bie nga pema dhe Ai të mos e dijë. (Shih: Sure En’am 59.) Për këtë arsye, ashtu si zemra e myslimanit është e mbushur vazhdimisht me dashurinë ndaj Allahut, ashtu edhe çdo mrekulli në këtë botë ia mban gjallë emocionin hyjnor, ndërsa fryti i kësaj është mosdhënia rëndësi gjërave të kësaj bote, ose thënë ndryshe, të kalosh përfundimisht nga bota e vdekshme dhe të qëndrosh tek Allahu.

Teuhidi është përqendrimi i miliarda njerëzve në një qendër dhe në një zë dhe nga kjo, lindin rregulla dhe emocione të përbashkëta.

Njeriu do të përqendrohet tek zëri, i cili tregon për ngjarje shumë të rëndësishme si: ardhja dhe ikja nga kjo botë, një zëqë tregon një nga një çdo gjë që ka lidhje me jetën tjetër. Ky është një zë që e qetëson mendjen dhe shpirtin e njeriut.

Një pasqyrim tjetër i teuhidit në jetën e myslimanit është ajo që e bën atë (myslimanin) të marrë pjesë në korin kozmik. Teuhidi me gjithë universin rrotullohen vazhdimisht në të njëjtën qendër tërheqjeje. Besimtari, i cili mendon dhe e di se i gjithë universi i përshtatet ligjeve të Allahut, e ndien veten si vëllai i universit, ndërsa njeriu i përkulet ligjeve të shkruara, të gjitha krijesat e tjera u përkulen ligjeve të cilat Allahu ka caktuar për natyrën. Megjithatë, edhe në trupin e njeriut ka pjesë, të cilat u përkulen ligjeve natyrore si, rrahjet e zemrës, lëvizja e gjakut etj. Njeriu nuk duhet t’i bindet vullnetit të vet, por vullnetit të Allahut dhe nga kjo sigurisht që do të lindi vëllazëria fetare. Kështu që, midis njeriut dhe natyrës (botës) ka një lidhje vëllazërore dhe jo një luftë e përgjakshme për mbijetesë ashtu sikur pretendon filozofia materialiste. Nëse e shikojmë nga pikëpamja Islame, vëmë re se midis njeriut dhe natyrës nuk ka asnjë lloj përplasjeje, por në të kundërtën, shohim një sakrificë vëllazërore. Bota dhe

krijesat që ndodhen në të, i janë vënë në shërbim njeriut dhe kaq! Në të njëjtën kohë, kjo është një kompetencë e kufizuar që i është dhënë njeriut, sepse, njeriu nuk është zoti i të gjitha këtyre krijesave, madje as edhe i trupit të tij, por veçse një ruajtës amaneti dhe patjetër që ruajtësi i amanetit duhet të jetë i sigurt (që e mban amanetin). Më i rëndësishëm është vullneti i Atij që jep amanetin.

Teuhid do të thotë, të dalësh prej moçalishtes së shumësit dhe të futesh në ujërat e qarta dhe të ëmbla të njësitit.

Teuhid do të thotë, qartësim i të vërtetave, metodave dhe rrugëve.

Teuhid do të thotë, të ecësh me hapa të sigurt në këtë botë.

Teuhid do të thotë, të përqafosh universin me një emocion të pashoq, të cilin na e ka futur në zemër zotëria i tij (universit).

Teuhid do të thotë, të shohësh botën e ngurtë dhe të ngushtë materiale nga majat e larta dhe madhështore të shpirtit.

Teuhid do të thotë të refuzosh shndërrimin në një qenie mekanike dhe të qëndrosh në rrugën e të qenit njerëzor.

Të gjitha krijesat iu bindën me dëshirë thirrjes së Allahut, gjithashtu edhe një pjesë e njerëzve, mirëpo, iblisi dhe shumica e njerëzve nuk morën pjesë në korin e teuhidit, madje nuk u mjaftuan me kaq, por u munduan ta sabotonin atë.

Sa guxim i çmendur!

Teuhidi është përqendrimi i miliarda njerëzve në një qendër dhe në një zë dhe nga kjo, lindin rregulla dhe emocione të përbashkëta.

Libri i librave

Edison Çeraj

Le ta themi që në kryeherë se libri i librave është Kurani. Mund të tingëllojë radikal ky pohim, aq më tepër në këtë kohë ku qytetërimi ynë materialist është më i gazmendur se kurrë ndonjëherë më parë, që sipas të cilit nuk ka asnjë të vërtetë absolute: Çdo gjë varet, por ky pohim nuk është gjë tjetër vetëm se bindja e njëmendtë e të gjithë atyre që e besojnë këtë libër bashkë me librat e tjerë para tij. Kurani duke qenë i qartë dhe i prerë në atë që kumton, duke mos lënë asnjë tis dyshimi për atë që njëmend kërkon të udhëzohet përmes tij, e sfidoi dhe vazhdon ta sfidojë njerëzimin për të bërë një të barabartë me të (Kurani, 10-38; 28-49); por, Zoti duke qenë i gjithëditur për paaftësinë e njeriut e zbriti këtë sfidë në dhjetë sure ose kapituj (Kurani, 11-13), ndërsa më pas në një kapitull të vetëm (Kurani, 2-23), e në fund vetëm në disa vargje (Kurani, 52-33). Kështu duke dalë pakrahasimisht më superior se çdo inteligjencë njerëzore, Kurani shpalli mrekullinë e tij dhe njëherësh paaftësinë njerëzore duke e nxitur edhe më shumë ngasjen, se, edhe nëse mblidhen sëbashku me njerëzit edhe xhinët nuk kanë për t'ia dalë kurrë që të bëjnë qoftë edhe një ajet të vetëm (Kurani, 17-88). Çdo libër i dalë nga dora e njeriut nuk është gjë tjetër vetëm se gjakim i pavetëdijshëm për të sjellë në jetë një vepër

e cila të përthithë e të mbërthejë të gjitha shikimet, thënë ndryshe një libër udhërrëfytes, pasi nuk ka asnjë autor që sado i përunjur të jetë që të mos dojë që vepra e tij të jetë në qendër të vëmendjes, por siç edhe e dimë fort mirë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe nuk do të ndodhë. Nuk ekziston asnjë libër që të mund të jetohej sipas tij. Askush nuk mund të jetojë sipas Platonit ose Kantit, Homerit apo Shekspirit, pavarësisht se këta filozofë dhe poetë kanë lënë një trashëgimi të pashlyeshme për pasardhësit, prapëseprap nuk kanë lënë një *modus vivendi*, një shembull të prekshëm se si duhet të jetohej.

“Shumë kohë përpara Profetit - paqja qoftë mbi të -, arabët e kishin përsosur artin e tyre letrar dhe kishin arritur shkëlqim të veçantë në të. Aftësia e tyre për të prodhuar vepra me vlera të mëdha letrare ishte e pakrahasueshme me çdo kulturë tjetër. Historia nuk njih popull tjetër, tek i cili fjala dhe bukuria e saj të kishte po kaq rëndësi. Për arabët, bota ishte çështje jete dhe vdekjeje, harrese dhe përjetësie, lufte dhe paqeje, virtyti dhe vesi, fisnikërie dhe rëndomtësie.

“*Ixhaz*” është emri që i është dhënë dukurisë së Kuranit për t'i sfiduar të gjithë njerëzit në të gjitha kohërat, por veçanërisht bashkëkohësit arabë të Profetit, për të bërë një vepër që të ishte e barabartë me

të në bukuri e përsosmëri. Ai përmban dy elemente: i pari është karakteri prej natyre i Kuranit, i cili, kur perceptohet prej mendjes së aftë për ta perceptuar atë, shkakton ndienjën e mahnitjes, të të qenit i prekur, të të ndierit të vlerave më të larta e më të thella, shkurt, të përballjes së realitetit fatfundësor me të gjitha përvojat shoqëruese për një përballje të tillë. E dyta është të kuptuarit e dallimit që ndan njeriun, perceptuesin, nga Zoti, i perceptuari, një tregues i të cilit është paaftësia e njeriut për të bërë diçka të ngjashme me Kuranin. E para është prej natyre për Kuranin, e dyta për njeriun. Arabët të dytës i thonë thjesht “*ixhaz*”, dukuri apo ngjarje e të mrekullueshmes; kurse të parën e quajnë “*vuxhuh el ixhaz*” apo aspekte të mrekullisë së Kuranit”. (Ismail Faruki)

Nëse letërsia si fusha më e epërme që ka arritur njeriu me fjalën e shkruar, përmes ngjarjes na zbulon rregullin, Kurani përmes rregullit përcakton ngjarjen, pra çdo që i duhet të dijë njeriut për të ndërmarrë pozicionin e duhur.

Sfida që Kurani i ka bërë dhe i bën njeriut, në fakt nuk njih kohë, por është gjithnjë e vazhdueshme. Një dëshmi e dukshme për këtë është forca e Kuranit për t’ua ndryshuar jetën njerëzve duke pranuar Islamin, për t’i bindur ata menjëherë për prejardhjen hyjnore qoftë të tij qoftë të tyre, sepse në thelb njeriu mbetet një qenie thellësisht religjioze, pavarësisht harresave që mund ta kapullojnë atë përgjatë rrugëtimit jetësor. Nuk ka njeri që të lexojë atë që muslimanët kanë shkruar në lidhje me përvojën e tyre me Kuranin, apo që pikas ndikimin e Kuranit mbi ndërgjegjen, jetën dhe mendimet e tyre, dhe të mund të shmangë përfundimin se Kurani është fjala e Zotit zbuluar Profetit Muhamed - paqja qoftë mbi të.

Në të vërtetë, qëllimi i Kuranit dhe i çdo zbulesë para tij, nuk është sfida ndaj njeriut, përkundrazi, Kurani është shpërfaqje e madhërishme drejtuar njeriut për të kuptuar jetën dhe ekzistencën duke u ndihur pikërisht nga dituria e pamatë e Atij që dhuntoi çdo ekzistencë, ndërkohë që s’ekzistonte absolutisht asgjë. Muslimanët besojnë që Zoti është i vetmi burim epistemologjik, që përmes Zbulesës i mundësoi njeriut të kuptonte mungesën e çdo rastësie rreth krijimit të jetës, ndërsa nga ana tjetër, duke patur parasysh këtë, mundshmërinë e çdo rastësie - sidomos në trajtën e mitit, legjendës, përrallës etj. - nëse si burim epistemologjik merret një autoritet tjetër veç Zotit. Kurani i jep njeriut aq dituri sa është e mjaftueshme për të njohur Zotin dhe të Dërguarin e Tij, e më pas me anë të kësaj diturie ai është i gatshëm ta farkëtojë këtë botë në kuptim dhe në formë, pasi kjo botë nuk është “mbretëria e djallit”, siç besojnë të krishterët, porse një realitet i pashmangshëm për të humbur ose për të fituar botën tjetër - dhe si e tillë e paanashkalueshme. Pra, në këtë pikë hasim një veçori tjetër të Kuranit, që në fakt nuk gjendet te librat e tjerë, që është të qenurit

burim i përhershëm njohurie (epistemologjik) për njeriun. Vetë fjala *njohje* nënkupton të kutposh ose të qartësohesh për një gjë për të cilën nuk mjafton forca e shqisave për ta kuptuar, që pak a shumë i bie të jetë metafizika, gjithnjë sipas kënvështrimit të filozofisë perëndimore, që Kurani e përshenjon me fjalën *gajb*. E gjithë sa më sipër, nënkupton që njeriu nuk mund ta njohë Zotin dhe asgjë tjetër përtejësore (në kuptimin e pamundësisë së arsyes dhe shqisave për ta kapur), vetëmse duke iu drejtuar fjalës së Zotit, dija e të cilit nuk njih kufij, dhe siç u përmend edhe më lart, i jep njeriut aq dituri sa ç’është e nevojshme për të kuptuar atë që i duhet të kuptojë, pasi fatkeqësisht një problem tjetër i njeriut modern është se nuk e di edhe se çfarë duhet të kuptojë! Edhe në këtë pikë Kurani e ka dhënë zgjidhjen, madje që në vargjet e para hyrëse: “Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, të Gjithëmshtirshmit, Mëshireplotit, Sunduesit të ditës së Gjykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Udhëzونا në rrugën e drejtë! (Fatiha, 1-5)

Kurani në mënyrë tejet mbresëlënëse i ofron çdoci lit atë që i duhet dhe sidomos aq sa i duhet, duke iu drejtuar thjeshtë “atyre që mendojnë”, pra intelektit. Çdokush mund të gjejë atë që kërkon në këtë libër, mrekullitë e të cilit nuk kanë të sosur, pavarësisht besimit, gjinisë, moshës, kombësisë apo ndonjë dallimi tjetër, pasi kumti kuranor është i gjithëbotshëm.

Një tjetër veçori e këtij libri është se, ndryshe nga profetët e hershëm, profetësia dhe zbulesat e të cilëve u ngritën përmes thyerjeve të ligjeve të natyrës (d.m.th. përmes kapërcimit të fuqive epistemike të vetëdijes njerëzore), Kurani ua paraqiste “mrekullinë” e tij vetë atyre fuqive që ishin të afta ta kuptonin atë dhe i ftonte ato që ta vlerësonin dhe ta pohonin me kujdes këtë mrekulli apo prejardhjen e tij hyjnore. Thirrja e tij i drejtohej të menduarit dhe të arsyetuarit si dy entitete qenësore të njeriut. Ndërsa zbulesat e tjera e “shtrëngonin” ndërgjegjen përmes thyerjeve të ligjit të natyrës nga ana e tyre, Kurani e bindte atë përmes përmbushjes së asaj çka arsyeya më së tepërmi priste të përmbushej. Kjo është arsyeya se pse natyra e mrekullueshme e Kuranit u bë subjekt studimi dhe analize nga shumë e shumë studiues, por natyrisht edhe nga njerëz të thjeshtë. Një mrekulli fizike si e Moisiut apo e Jezusit thjesht i trondiste shikuesit. Një mrekulli e tyre ishte, për nga natyra e saj, përtej arsytimit dhe përtej diskutimit. Kurani troket tek arsyeya e njeriut, pra është pranë njeriut, madje më pranë se ç’mund të imagjinohet. Çdo arsyetim të shpie te ky përfundim, ndërsa refuzimi vetëm e mbulon këtë realitet, por nuk e shmang dot: ky është thelbi i mosbesimit, ilaçi i të cilit besoj që sapo është treguar: thjeshtë duhet pak guxim për ta përdorur.



SHTATË NJERËZ TË MIRË

1. Kryetari i shtetit i cili punon me drejtësi.
2. I riu që edukohet me dashuri dhe respekt ndaj adhurimit të Allahut.
3. Njeriu, zemra e të cilit është e lidhur mbas xhamisë.
4. Ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut.
5. Ai që ruan nderin dhe namusin.
6. Mirëbërësi, i cili atë që jep me dorën e djathtë nuk ia di e majta.
7. Ai që e përmend Allahun kur është i vetmuar.

❧ Murat Kaja ❧

Profeti (a.s.), ka ndjekur metoda të shumta për t'ia mësuar njerëzve këtë fe. Përveç urdhërave dhe ndalesave, ndonjëherë ka rregulluar gabimin ose ka miratuar edhe punën e mirë të ndokujt. Ndonjëherë u ka drejtuar pyetje shokëve të tij dhe përgjigjen përsëri e ka dhënë vetë. Pyetjeve që i bëheshin, ndonjëherë u përgjigjej ashtu sikur ishte, por ndonjëherë duke dhënë edhe më tepër detaje nga ç'kërkohej.

Ka qëlluar t'i mësonte edhe duke e vepruar, ose duke u larguar vetë nga një vepër. Ndonjëherë ka folur pak dhe saktë, arsye për të cilën e kanë quajtur edhe "**xhevamiu'l-kelim**", që do të thotë, "tregon shumë, me pak fjalë". Këto fjalë ai i ka gëdhendur

në mendjen e njerëzve, duke i përmendur nga tri herë. Ndonjëherë, çështjen e ka shpjeguar gjërë e gjatë, ka treguar ndodhi dhe ka portretizuar çështje të ndryshme. Dhe ndonjëherë, i shpjegonte të ndara në kategori...

Është e mundur që këto t'i japim një nga një, me shembuj, sepse librat e haditheve janë të mbushur me mijëra nga këto shembuj. Mirëpo, këtu duam të marrim në dorë një hadith që na tregon se si i Dërguari i Allahut u ka mësuar njerëzve fenë, moralin e lartë, urtësinë dhe vlerat, duke ua dhënë diturinë të ndarë në kategori dhe grupe.



I Dërguari i Allahut na e përkujton shpesh botën tjetër dhe i portretizon në një mënyrë të gjallë ato që do të ndodhin atje, gjëndjen dhe veprimet e njerëzve. Ja pra, hadithi ynë fillon duke treguar gjëndjen e njerëzve në botën tjetër: **“Atë ditë Allahu do të marrë nën hijen e (arshit të) vet shtatë persona. Atë ditë nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së (arshit të) Tij.”** (Buhari, Xhemaat dhe Imamet, 8; Muslim, Zekat, 91) Me këtë, Profeti ynë (a.s.) na sjell para syve edhe gjëndjen e asaj dite në botën tjetër, por na bën edhe kureshtar për të ditur se cilët janë këta persona. Cilët janë këta shtatë persona fatlumë? Ç’është ajo që i bën ata të përgëzohen me këtë mirësi?

Në fillim Resulullahu (a.s.) tregon për kryetarin e shtetit që punon me drejtësi. Pra këtu na jepet një stimulim drejt fushës materiale të kësaj bote. Që në fillim, ai sikur na jep mesazhin se në këtë fe materialja dhe shpirtërorja janë të lidhura si mishi me thoin. Resulullahu (a.s.) i jep shumë rëndësi sigurisë dhe mirëqënies ekonomike të njerëzve dhe dëshiron që populli të jetojë i qetë dhe i sigurtë. Për këtë arsye, nuk e lë bosh këtë fushë. Ai vë në dukje një vlerë universale: Drejtësinë. Ky është edhe një princip i cili theksohet shumë në Kur’anin Famëlartë. (Nisa 4/58; Maide 5/8; Nahl 16/90) Madje Kur’ani na tregon për Davudin (a.s.), i cili gjendet në kulmin e fuqisë shpirtërore dhe materiale. Allahu e urdhëron edhe atë, që të prijë me drejtësi dhe me barazi. (Sad 38/26). Në një farë mënyre, edhe Omeri (r.a.) halifja i dytë i Profetit (a.s.) e përforcon këtë princip. Me veprimtaritë që zhvilloi, me institucionet që formoi dhe me vendimet që mori, ai u bë njeriu i parë që përfitoi nga ky përgëzim që solli Profeti ynë (a.s.). Ai përbën shembullin konkret të këtij principi që stabilizoi Islami. Për këtë arsye, ai është quajtur “Umeru adlun”, që do të thotë, “Omeri (r.a.) është vetë drejtësia”.

Së dyti, Profeti (a.s.) bën fjalë për të riun që edukohet me dashuri dhe respekt ndaj adhurimit. Këta janë kategoria e dytë e njerëzve që do të strehohen nën hijen e arshit të Allahut. Të rinjtë që edukohen prej vegjëlisë me vetëdijen e besimit, të cilët ecin me kokën lart dhe pa u ndarë nga rruga e drejtë, në kohën kur iu zjen gjaku dhe kur mjedisi përreth tyre është mbushur përplot me qendra joshëse. Të rinjtë që përkushtohen me kujdes, me dashuri, me energji dhe dinamizmin në këtë rrugë...

Në Kur’anin Famëlartë kemi shembullin e “Shokëve të shpellës”. Allahu shprehet me lëvdata për këta të rinj sakrifikues! Që në fillim, përreth Resulullahut ka patur gjithmonë të rinj. Çështja e shenjtë e Islamit është lartësuar mbi supet e këtyre të rinjve të devotshëm. Janë ata që mundohen dhe punojnë për t’ia mësuar vets dhe të tjerëve Kur’anin në Mekke. Janë përsëri ata që qëndrojnë në krye të luftës në Medine dhe në përhapjen e Islamit në vënde të ndryshme. Aliu (r.a.) është shembulli më i mirë i atyre që e kanë kushtuar jetën e tyre në rrugën e Allahut. I pari që besoi, i pari që rrezikoi jetën në kohën e hixhretit, Luani i Allahut në Bedir dhe Uhud, Aliu (r.a.).

Së treti, vjen ai zemra e të cilit është e lidhur me xhaminë. Pra, besimtari në zemrën e të cilit ndodhet një dashuri e pashoqe për xhaminë. Një vakt namaz e ka falur dhe pret me padurim të vijë vakti tjetër. Një njeri shumë i përkushtuar në faljen e namazit në xhami dhe në ripërtëritjen e sunnetit. Xhamia ujë dhe besimtarët peshq! Si mos ta dojë xhaminë besimtari? Në kohën kur Resulullahu (a.s.) emigroi për në Medine, puna e parë që bëri ishte ndërtimi i një xhamie dhe dhe ai vetë mbajti gurë në supet e tij. Zemra e muslimanëve dhe pulsi i bashkësisë Islame rreh gjithmonë nëpër xhamia. Bashkimi, vëllazëria është aty. Ndihma dhe solidariteti janë aty. Libri i Allahut lexohet aty, emri i Tij përmendet aty dhe

njerëzit po prej aty thirren për në shpëtim. Xhamitë janë projektimi i mëshirës që zbret nga Qabja. Mëshira gurgullon në xhami, qetësia zbret në xhami. Ja pra, për këtë arsye besimtarët që kanë dashuri për xhaminë dhe xhematin dhe që ndjejnë dëshirën për shërbim ndaj xhamisë, do të jenë nën hijen e arshit në ditën e kiametit.

Së katërti, Profeti (a.s.) na tregon për **ata që e duan njëri-tjetrin për hir të Allahut**. Midis tyre nuk ka ndonjë interes të kësaj bote por ka vetëm një miqësi të pastër dhe pa pretendime. Kur bashkohen, bashkohen për hir të Allahut duke shpresuar kënaqësinë e Tij. Madje, edhe kur ndahen, ndahen për hir të Tij dhe shpresojnë kënaqësinë e Tij. Dhe kjo dashuri midis tyre vazhdon deri në fund të jetës. Çfarë ka më me vlerë në jetë se sa një mik i sinqertë? Të dimë që kemi një mik të sinqert dhe besnik, që e duam dhe e duan, na jep një qetësi të madhe shpirtërore. Një pjesë e bukurisë së jetës përbëhet nga miqësia e ngrohtë, nga ajo miqësi që nuk bazohet në interesa...

Në Kur'anin Famëlartë flitet për miq që do të jenë armiq në ditën e kiametit. Mirëpo, miqtë e vërtetë do të jenë larg kësaj. (Zuhruf 43/67) Në një vend tjetër tregohet për dikë që meriton dënimin dhe ky me një pendim të thellë thotë: **“Ah sikur të mos isha mik i filanit!”** (Furkan 25/28) Sa miqësi e bukur është ajo e të Dërguarit të Allahut (a.s.) me sahabët e Tij si Ebu Bekri dhe Omeri (r.a)! Përfytyroni për pak çaste tabllon e sinqertë që ekspozojnë këta miq të ngrohtë, të cilët bisedojnë të ulur pranë një pusi!

I pesti është ai që i jep një rëndësi të veçantë, nderit dhe namusit. **Një grua me pushtet i propozon këtij marrëdhënie të pamoralshme dhe ky e refuzon atë duke thënë, “unë i friksohem Allahut”**. Sa virtyt i madh është nderi! Për çfarë virtytesh mund të bëhet fjalë, nëse në një popull ka humbur ndjenjat e nderit dhe namusit!? Ja pra, ajo që na e siguron këtë ndjenjë është devotshmëria. Pra të jesh i vetëdijshëm kundrejt përgjegjësive që ke ndaj Allahut.

Ato që ka jetuar Jusufi (a.s) janë të njëjta me ato që na ka treguar Resulullahu (a.s.). Të gjithë e dimë ndodhinë. Në suren Jusuf ajo jepet me detaje. Mirëpo, përgjigja e atij njeriu të lartë ndaj një propozimi të pamoralshëm është shumë ndikuese: **“Allahu më ruajtë nga kjo gjë. Si mund të bëj këtë pasi që Allahu më ka dhuruar këto mirësi.”** (Jusuf 12/23) Në rrethin që jetonte Jusufi (a.s), edhe burrat edhe gratë ishin zhytur nga koka tek këmbët në imoralitet. Jusufi (a.s) e pa më të arsyeshme të qëndronte në burg, se sa të jetonte pa ndjenja në një rreth të tillë: **“Ai (Jusufi) tha: “O Zoti im, burgu është më i dashur për mua, se sa ajo që ma ofrojnë ato mua...”** (Jusuf 12/33) Lutja e Profetit tonë (a.s.) do të na ndihmojë në këto raste: “Allahu im, dëshiroj prej teje që të jem në rrugë të drejtë, të përqafohem me devotshmërinë dhe të jetoj me nder.” Gjithashtu, edhe zotëruesi i dy dritave në

kohën e Profetit, Osmani (r.a), na ndriçon rrugën me ndjesinë e tij të veçantë ndaj nderit dhe turpfit!

Për sa i përket të gjashtit, Profeti ynë (a.s.), me këtë nënvizon një pikë të rëndësishme. Pra, **dora e majtë e atij që bën mirë nuk duhet të dijë se ç'bën dora e djathtë**. Kështu që, ai njeri mirësinë e bën në mënyrë të fshehtë. Sepse qëllimi i tij është vetëm kënaqësia e Allahut. Ai nuk e bën këtë për sy e faqe. Në ajetin e ndershëm shprehet se të japësh haptas është mirë, por të japësh fshehtas është edhe më mirë, (Bakara 2/271). Profeti ynë i dashur, çështjen e fshehtësisë e ka shprehur në një mënyrë shumë interesante, për arsye që ai i cili merr lëmoshë të mos turpërohet midis të tjerëve. Atë që jep dora e djathtë të mos e dijë e majta! Sigurisht, edhe njerëzit që marrin lëmoshë kanë një ndjenjë nderi dhe krenarie. Prandaj, kur të jepet, duhet të jepet pa i cënuar ndjenjat e tyre. Ja pra, edhe ata që e kanë këtë ndjesi, do të jenë nën hijen e arshit.

I shtati dhe i fundit është **ai që e përmend Allahun dhe të Dërguarin e Tij kur gjëndet i vetmuar**. Ky njeri është aq i mbushur me dashuri ndaj Allahut, sa që nga sytë e tij rrjedhin lot. Dashuria hyjnore ia djeg zemrën. Zemra e shuan zjarrin dhe shpirti e ujit tokën me lotët e tij. Kur e përmend Allahun dhe e lexon librin e Tij, zemra i rrënoqet dhe i mbushet me devotshmëri dhe mëshirë. Shpirti i tij fiton butësi dhe pastërti! Edhe Profeti ynë (a.s.) i ka kaluar disa nga netët e Tij i mbytur në lot. Kryen adhurim, lexon Kur'an dhe derdh lot i Dërguari i Allahut (a.s.). Edhe shoku i Tij më i ngushtë Ebu Bekri (r.a) kishte një zemër të tillë. Në mesxhidin që ndërtoi përpara shtëpisë së tij në Mekke, lexonte Kur'an duke qarë. Vajza e tij Aishe (r.a) na e tregon atë si “një njeri me zemër të butë dhe sylagur”. Mirëpo këtë nuk mund ta shpjegosh dot me fjalë, nëse nuk e jeton, nuk e kupton.

Hadithi ynë fillon me materialen dhe mbaron me shpirtëroren. Në këtë fe, rëndësia që i jepet rregullimit të jetës së kësaj bote është po aq e madhe sa edhe rëndësia që i jepet forcimit dhe pasurimit të botës shpirtërore të njeriut. Me këtë hadith, i Dërguari i Allahut (a.s.) na ka paraqitur një manifestim të principeve universale të Islamit. Ky hadith është si një ylber që pasqyron shtatë ngjyrat themelore të diellit Islam. Ai nxjerr në pah ngjyrat që i jep Islami këtyre vlerave, që nga principi i lidhur me shtetin, marrëdhëniet shoqërore, kujdesi që duhet treguar në punë të mira dhe deri tek rëndësia që kanë marrëdhëniet e njeriut me Allahun. Nëse e marrim numrin shtatë si një kuptim figurativ të shumicës, pra simbolin që tregon një sasi të madhe, do të shikojmë se këto pika janë dimensione që zgjaten për tek principet e tjera.

A E KE PARË ATË QË HYJNIZON EPSHIN E VET?

Ahmet Tashgetiren

Parimi themelor i **“Besimit Islam”** është **“teuhidi”**. Teuhid do të thotë pranim dhe vërtetim i njëshmërisë së Allahut. Të gjitha konceptet e jetës dhe të besimit lidhen me **“teuhidin”**. Sipas Islamit, teuhidi është kuadri ligjor më themelor midis Krijuesit dhe njeriut. Pra, Krijuesi i bën të ditur njeriut se *“Vetëm brenda këtij kuadri mund të kesh marrëdhënie të drejta me Mua.”* Ndërsa shprehja unike e kësaj është **“kelime-i teuhid”**, pra shprehja **“La ilahe illallah”**. Për të këtë arsye, qoftë Profeti (a.s.), qoftë Kurani dhe ndjenja më e lartë e vetëdijes së myslimanit janë të orientuara në mbrojtjen e teuhidit. Pothuajse e gjithë periudha e Mekes i është dedikuar ndërtimit të vetëdijes së teuhidit. Sipas asaj që mësojmë nga ajete të ndryshme të Kuranit Famëlartë, gjatë gjithë historisë njerëzore i pari mesazh i Krijuesit që të gjithë profetët u kanë komunikuar popujve te të cilët janë dërguar ka qenë shprehja **“La ilahe illallah”**. Në polin e kundërt të teuhidit qëndron **“shirku”**. Shirk do të thotë t’i bësh ortak Zotit, pra të shkelësh ligjin e Tij. Në Kuranin Famëlartë bëhet çdo lloj paralajmërimi për të pastruar mendjen e njeriut prej shirkut. Kështu që, këto paralajmërimet bëhen në të gjitha ato fusha, ku njeriu mund të bie në shirk. Shenjtërimi i fuqisë, i urdhrit, i dashurisë, i frikës së dikujt... Pra, nëse dashuria, frika dhe lidhjet e çdo lloji janë më të forta se lidhja me Allahun e Madhëruar, kjo do të thotë se shirku ka filluar. Por Islami refuzon në mënyrë të prerë çdo lloj dashurie, çdo lloj frike dhe lidhjeje të këtillë. Islami kërkon prej njeriut që brenda kornizës së **“teuhidit”** të pranojë Allahun si të vetmin Krijues, Furnizues, Ligjvënës, dhënës dhe marrës të jetës e llogaritës në ditën e gjykimit. Gjithashtu, nuk pranohet që brenda këtyre fushave

të futet në veprim ndonjë fuqi tjetër. Shpesh gjejmë në Kuran ajete që fillojnë me shprehjen **“Pyeti ata.”**, e menjëherë pastaj radhiten pyetjet si: **“Kush i krijoi qiejt?, Kush ju krijoi prej një pike uji?, Kush është ai që ju furnizon prej tokës?, Kush është krijuesi i jetës dhe i vdekjes?, Kush e zbrit ujin prej qiellit?”**.

Përsëri, po në Kuran na bëhet me dije se njerëzit i përgjigjen këtyre pyetjeve me **“Allahu”**. Pastaj vjen pyetja **“Mirë, po atëherë përse një zot tjetër?”**. Në përgjithësi njerëzit ngatërrohen në **“përcaktimin e mënyrës së jetesës”**. Ndonjëherë futen në mes fuqi politike si Faraoni, ndonjëherë futet klasa e priftërinjve, kurse ndonjëherë tjetër epsi dhe pasioni i vetë njeriut... Mbase njeriu as që mund ta kuptojë që në këtë rast ka përdhosur **“teuhdin”** dhe është drejtuar kah **“shirku”**, pra ka shkelur ligjin e Allahut. Një ngjarje e tillë ka ndodhur edhe në periudhën e Profetit (a.s.). Ajo zhvillohet kështu:

Një ditë, djali i Hatem-i Tainit, Adiji i cili ishte i njohur për bujarinë e tij, vjen për vizitë tek Profeti (a.s.). Në atë kohë, Adiji ishte ende në fenë e krishterë, pra ende nuk e kishte pranuar Islamin. Në atë çast Resulullahu (a.s.) lexon këtë ajet prej sures Teube:

“Në vend të Allahut, ata kanë zgjedhur për zot rabinët dhe murgjit e tyre...” (Teube, 31)

Me të dëgjuar këtë ajet, Adiji tha: **“O Resulullah, ata nuk i adhurojnë murgjit e tyre”**. Përgjigja që i jep Resulullahu (a.s.) Adijit tregon rëndësinë që i jepet teuhidit Islam dhe rregullit të jetës. Profeti (a.s.) urdhëron kështu: **“Atë që Allahu e ka bërë hallall, ata e bëjnë haram. Ju a nuk vepronit kështu (sipas fjalës së tyre)? Atë që Allahu e ka bërë haram, ata e bëjnë hallall. Ju a nuk vepronit kështu (sipas fjalës**

së tyre)?” Ndërsa Adiji i miratoi fjalët e Resulullahut dhe tha: **“Po”**. Pastaj, Resulullahu (a.s.) tha: **“Ja pra, kjo do të thotë t’i adhurosh ata”**. Ndërsa adhurimi i bëhet vetëm atij që pranohet për Zot. Sipas Kuranit, nëse njeriu fillon t’i pranojë si **“Hallall - Haram”** mendimet e priftërinjve, të murgjve apo të gjithë atyre prijësve fetarë që shkulin ligjet e Allahut, kjo do të thotë se e ka humbur orientimin e devotshmërisë. Në lidhje me këto ajete, Elmallëllë Hamdi Jazër, në tefsirin e tij shprehet kështu: *“Këto transmetime tregojnë se për të bërë dikë zot nuk është kusht që t’i vihet emri “zot”. T’i bindesh urdhrave të dikujt pa e llogaritur nëse është apo jo në përshtatje me urdhrin e Allahut, veçanërisht në çështjet fetare për të cilat pretendohet se ka kompetenca, t’i bindesh atij pa menduar se ato që thotë mund të jenë në kundërshtim me urdhrat e Allahut, si dhe t’i zbatosh këto urdhra si adhurime, do të thotë se e ke bërë zot atë dhe po e adhuron.”* Në të njëjtën kohë, Elmallëllë flet edhe për ndryshimin që ekziston midis urdhrat të Kuranit për **“Bindje ndaj udhëheqësve”** dhe qortimeve për **“bindjen ndaj priftërinjve dhe murgjve”**. Më konkretisht, ai shprehet kështu: *“A nuk është farz urdhri i Allahut për t’iu bindur dijetarëve të fesë e prijësve që janë edhe udhëheqës të shtetit? Atëherë përse qortohet bindja e jahudinjve dhe e të krishterëve ndaj urdhrave të prijësve të tyre fetarë, murgjve dhe priftërinjve? Këtu s’ka arsye të mendojmë në këtë mënyrë, sepse ajo për të cilën bëhet fjalë nuk është bindja dhe dorëzimi ndaj Allahut, por bindja ndaj urdhrave që bien ndesh me urdhrat e Allahut.”* Gjithashtu, Elmallëllë na kujton se kur thuhet zot **“përveç Allahut”**, nënkuptohen krijesa si shejtani, Nemrudi dhe Faraoni. Për më tepër, ai thotë kështu: *“Nëse shpërfillen urdhrat e Allahut dhe të dijetarëve, u jepen kompetenca për të vënë ligje ose për të bërë ndryshime qoftë edhe në një pjesë të vogël të ligjit, do të thotë se dikujt tjetër përveç Allahut i janë dhënë kompetencat e Zotit. Ashtu sikundër është shirk e kufur të adhurosh shejtanin, Nemrudin, Faraonin dhe idhujt e tjerë, po ashtu është shirk edhe lartësimi e madhërimi i tepruar i dijetarëve. Për shembull, t’i bindesh dikujt që nuk e ndan të drejtën nga e shtrembëra, të vërtetën nga e kota, një personi, fjalët e të cilit nuk mbështeten në urdhrat e Allahut, duke i mbajtur lart fetvatë që mbështeten në qejfet e tij, a thua se ka kompetenca të bëjë haram atë që Allahu ka bërë hallall dhe të kundërtën, a thua se ka të drejtë të ndryshojë ligjet e Allahut, ndërkohë që gabimet e këtij njeriu duken qartë, e tërë kjo përbën shirk dhe kufur. Pra, kjo do të thotë të lësh Allahun dhe të adhurosh dikë tjetër.”* Duke trajtuar çështjen e botës së krishterë, Elmallëllë prek edhe një pikë tjetër interesante dhe shprehet: *“Kompetenca e Zotit kaloi prej priftërinjve tek deputetët (parlamentarët)”*. Më tej vazhdon kështu: *“Në kristianizëm, privilegji i klasës së priftërinjve për të marrë kompetencat e Zotit quhet “klerikalizëm”. Protestantizmi doli si rrymë që*

e kundërshtoi këtë koncept. Më vonë, kompetencat e Zotit dolën nga duart e priftërinjve dhe kaluan te parlamentarët.” (Hak Dini Kur’an Dili, c.4, s.318-319, I. Karaçam, E. I. İık, N. Bolelli, A. Yücel)

Në Kuran, ka shumë ajete që i tërheqin vëmendjen njeriut që **“të mos i bindet epshit të tij apo epshit të dikujt tjetër”**. Mirëpo, dy ajete e vënë theksin tek rreziku i shirkut. Kur i lexojmë këto dy ajete si një të vetëm, del në pah qartë mënyra e konceptimit të personit që **“hyjnizon epshin e tij”**. Ja disa ajete të sures Xhathije:

“Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njeri të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?! A nuk po merrni vesh? Ata thonë: ‘Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron’. Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, ata vetëm hamedësojnë ashtu.” (Xhathije, 23-24)

Ndërsa në suren Furkan, profili i personit që **“hyjnizon epshin e tij”** jepet në këtë mënyrë:

“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot? A do t’i bëhesh mbrojtës atij? A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër, veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë.” (Furkan, 43-44)

Në komentimin e këtyre ajeteve Ibën Xheriri thotë: *“Ai që vepron sipas epshit dhe dëshirës së vet pa marrë parasysh hallallin dhe haramin që ka caktuar Allahu, e ka marrë epshin e vet për zot”*. Ndërsa El Xhessasi thotë: *“Një njeri i tillë i bindet epshit të vet ashtu siç i bindet Allahut”*. Zemahsheri në tefsirin e tij shprehet kështu: *“Ai që vepron sipas orientimit të epshit të tij i bindet epshit të tij njësoj siç i bindet Allahut”*. (Meududi, Tefhimu’l Kur’an, vol. 5, faq 326-328)

Në lidhje me **“atë që hyjnizon epshin e tij”**, ajetet e Kuranit nënvizojnë këto veçori:

- Këta lloj njerëzish i kanë veshët dhe zemrat të kyçura, pra nuk mund të dëgjojnë dhe nuk mund të ndjejnë dhe në sytë e tyre ka rënë perde.

- Ata kujtojnë se jeta e kësaj bote është gjithçka. Të lindësh, të vdesësh dhe kaq. Sipas tyre kjo jetë nuk ka kuptim tjetër. Ata janë të pavetëdijshëm për jetën e amshueshme dhe si rrjedhojë janë larg mendimit se një ditë do të japin llogari për gjithçka që veprojnë e nuk veprojnë. Mirëpo kjo është një hamendje e tyre që nuk mbështetet në asnjë dituri të saktë.

- Të adhurosh epshin, pra të bëhesh rob i pasioneve personale, kjo të degradon në nivelin e kafshës, madje të bën edhe më të hutuar se ajo, sepse kafsha nuk ka vetëdije e nuk planifikon gjë sipas pasioneve. Ndërsa njeriu që bëhet rob i pasioneve të veta, ai

është në gjendje të bëjë çdo të keqe. Për këtë arsye, njeriu që është rob i pasioneve të veta mund të de-gradohet në një nivel më të ulët se kafshët. Ky lloj individi ndodhet në një gjendje edhe më të rrezikshme se ata që adhurojnë drurët apo gurët. Nga një anë, pasionet e veta e kanë shtyrë ta vendosin veten në qendër të të gjithë njerëzimit, pra, pasionet ia kanë verbuar sytë e zemrën, ndërsa nga ana tjetër është kapluar nga ndjenja e mungesës së përgjegjesisë, e cila e bën të pandehë se kjo jetë është gjithçka dhe se nuk do të japë llogari për asnjë vepër. Mendjen dhe vetëdijen që i është falur e ka bërë rob të egos së tij... Prandaj, nuk ka adhurim idhujsh që mund të jetë më i prishur dhe më i rrezikshëm se ky. Sipas një hadithi të transmetuar nga Ebu Umame, Resulullahu (a.s.) ka urdhëruar kështu:

“Tek Allahu, prej idhujve të rremë që adhurohen për-veç Tij, më i keqi është epshi i njeriut.” (Taberani)

Po ç’është **“hyjnizimi i epshit”**? Si ndodh?

Ky fenomen është tejkalimi i rregullave të përcaktuara prej Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Për shembull.:

- Nëse ambicia për pasuri e lë nën hije respektimin e parimeve të haramit dhe hallallit.

- Nëse bëhet shkak për neglizhimin e përgjegjësive si zekati apo sadakaja...

- Nëse marrëdhënia juaj me pasurinë ju bën të mendoni se jeni zotëruesi absolut i kësaj pasurie, që e keni fituar me mundin tuaj dhe kjo ju krijon ndjenjën se jeni ju që po i **“jepni rrizkun”** punëtorëve që keni...

- Nëse bëni si t’ju dojë qejfi...

- Nëse dashuria për fëmijët ju shtyn t’i ndihmoni ato qoftë edhe në vepra të ndaluara...

- Nëse ambicia për famë ju bën që çdo gjë ta shihni si të lejuar, pa marrë parasysh se është haram apo hallall, vetëm e vetëm për tu ngjitur sa më lart...

- Nëse kur të keni arritur lart, arroganca ju nxit të nënçmoni devotshmërinë ndaj Allahut...

- Nëse pasioni për pushtet ngjall brenda jush një ndjenjë fuqie të pakufishme, ndjenjë e cila ju bën të mendoni se **“Nuk ka më të madh se unë”**...

- Nëse epshet seksuale ju bëjnë të shkëlqi ligjet hyjnore në këtë fushë... dhe nëse bota e juaj e pasioneve ka dalë jashtë kontrollit dhe ka filluar të marrë në dorë frerët... kjo do të thotë se në atë moment ka filluar katastrofa e **“hyjnizimit të epshit”**.

Shikoni se si e paralajmëron Kurani njeriun në lidhje me tejkalimin e kufinjve të pasioneve njerëzore: **“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia, për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.”** (Teube, 24)

Kurani është harta e rrugës që do t’i ndriçojë udhën njeriut deri në pafundësi. Kurani është një udhëzues hyjnor që përcakton në çdo kohë problemet personale të njerëzve dhe i nxit ata të gjejnë marrëdhëniet e duhura me Allahun Teala. Edhe sot, e madje më shumë se kurrë, problemi i **“hyjnizimit të epshit”** është kthyer në problemin kryesor të njeriut. Mentaliteti **“jetojmë dhe vdesim... më tej nuk ka”** ndikon një pjesë të madhe të shoqërisë. Imagjinata e një jete pa botë tjetër e çrregullon mendjen njerëzore. Pasionet e përkohshme të

kësaj bote kanë fituar një ndikim aq të madh, sa ia ka errur sytë egos së njeriut. Njeriu është rrethuar në të gjitha anët nga kjo botë, dhe përderisa ai të vazhdojë të jetë rob i pasioneve, kjo botë do të vazhdojë t’i ngajë një pylli të egër...

I ndërthurur me teknologjinë marramendëse, ndërveprimi i pasioneve të njeriut do ta çojë Gjithësinë në një atmosferë shkatërrimi dhe egërsie të pamendueshme, në luftëra dhe në padrejtësi ndaj të dobtëve.

“Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve...” (Rum, 41)

“Sikur e Vërteta të ishte sipas dëshirave të tyre, atëherë do të shkatërroheshin qiejt dhe Toka e gjithçka që gjendet në to...” (Mu’minun, 71)

Në Kuranin Famëlartë, Allahu Teala përcakton një lloj njeriu dhe kërkon prej nesh që të mos jemi brenda cilësive të atij lloji. Ai lloj njeriu është rob i pasioneve të veta. Ai lloj njeriu hyjnizon pasionet e veta dhe po në emër të pasioneve qëndron larg ligjeve hyjnore.

Brenda kornizës së teuhidit duhet të skanojmë edhe njëherë personalitetin tonë dhe të pastrohemi njëherë e përgjithmonë prej gjërave që janë në kundërshtim me **“Teuhidin”** e që na kujtojnë adhurimin e egos, adhurimin e epshit tonë dhe të krijesave të tjera përveç Allahut.

*“A e ke parë
ti atë që epshin e vet e ka
marrë për zot? A do t’i bëhesh
mbrojtës atij? A mendon ti se
shumica e tyre dëgjojnë dhe
kuptojnë? Ata nuk janë tjetër,
veçse si bagëti. Madje, ata
janë edhe më të shmangur nga
rruga e drejtë.”*
(Furkan, 43-44)



Iluzioni i statistikave

— Rene Geunon —

Nëse i rikthehemi më specifikisht pikëpamjes “shkencore”, siç kjo e fundit kuptohet në botën moderne, karakteristika më qendrore e saj është qartësisht përpjekja për të shpjeguar gjithçka në terma sasiorë. Çdo gjë tjetër e patrajtuar dhe e patrajtueshme në këto terma, përjashtohet dhe konsiderohet thujtase joekzistuese. Në kohët e sotme, njerëzit përgjithësisht mendojnë se gjithçka që nuk “përkthehet në figura”, apo thënë ndryshe nuk mund të shprehet në terma sasiorë, është shkencërisht e pavlefshme. Ky këndvështrim nuk lidhet vetëm me fizikën (në kuptimin më parak të fjalës) por me të gjitha shkencat e pranuar si të tilla. Me sa kemi parë, as domeini psikologjik nuk mbetet larg këtij qëllimi. Kjo qasje nënkupton humbjen e ndjeshmërisë ndaj gjithçkaje që është esencialisht e vërtetë dhe gjithë “teprica” që mbetet nga tkurrja e një shkence të tillë është krejtësisht e paaftë për të shpjeguar ndonjë gjë çfarëdo. Një tjetër karakteristikë tipike e shkencës moderne, që meriton të theksohet, është vetëmashtrimi i shkencës lidhur me masën e asaj që mund të vilet prej disa llogaritjeve thjesht numerike.

Prirja drej uniformitetit, çka gjen zgjatim në një domein “natyral”, i cili nuk është përjashtimisht vetëm njerëzor, të çon tek ideja, e cila mund të jetë edhe një princip (në fakt duhet të jetë një pseudoprincip), se ekzistojnë ripërsëritje të dukurive të njëjta; por kjo, nëse mbështetemi te “principi i **padallueshmërisë**” është një pamundësi absolute. Një shembull i mirë i kësaj ideje mbështetet nga pohimi se “të gjithë shkaqet prodhojnë gjithnjë të njëjtat pasoja”. E shpallur në këtë formë, kjo përmban një absurditet inherent, pasi që në të vërtetë nuk mund të ndodhë që të njëjtat shkaqe apo të njëjtat pasoja të manifestohen në një rend njëpasnjeshmërie. Mundet që njerëzit të shkojnë aq larg sa të thonë se “historia ripërsërit vetveten”, ndërsa në të vërtetë ka vetëm korrespondime analogjike të periudhave dhe ngjarjeve të caktuara. Do të ishte korrekte të thuhej se shkaqet e krahasueshme mes tyre në disa ndërmjetësime lidhore të caktuara prodhojnë pasoja ngjashmërisht të krahasueshme në po të njëjtët ndërmjetës lidhorë; por krahas ngjashmërisë, e cila mund të shpërfaqë një farë identiteti të pjesshëm, ka gjithnjë dallime të pashmangshme, thjesht për

faktin se po parashtrihen dy gjësende të dallueshme dhe jo një gjësend i vetëm. Meqënëse dallimet janë cilësore, ato zvogëlohen me uljen e konsideratës për shpërfaqjen e tyre dhe rrjedhimisht haset një rritje e ngjashmërisë, çka në disa raste përmes vëzhgimit të sipërfaqshëm dhe të paplotë, mund të krijojë përshtypjen e një farë identiteti mes gjësendeve. Megjithatë, dallimet nuk mund të eliminohen tërësisht dhe kështu duhet të jetë në cilindo rast që nuk është nën nivelin e krejt manifestimit. Edhe po të mos ketë dallime të tjera përveç atyre që burojnë nga ndryshimi i pandërprerë i kohës dhe hapësirës, ato nuk mund të asgjësohen në asnjë rast. Kjo mund të kuptohet vetëm nëse, ndryshe nga botëkuptimi modern, koha dhe hapësira nuk shihen si enë mbajtëse homogjene dhe forma pastërtisht sasiore, kur në fakt bash e kundërta është e vërtetë: dimension kohor dhe hapësinor mbartin gjithashtu një aspekt cilësor. Sido që të jetë, është legjitime të pyesësh se si njerëzit që injorojnë dallimet, si me qenë të refuzuar prej shquarjes së tyre, mund të pretendojnë themelimin e një shkencë “ekzakte”. Nuk mund të ketë një shkencë “ekzakte”, por veçse matematikë të pastër, e cila ka fokus të vetëm domeinin sasior. Kjo dhe gjithë pjesa e mbetur, e të ashtuquajturës shkencë moderne është një çështje llogaritjesh të përafërta të papërpunuara. Jo vetëm nga aplikimi i shkencës, të cilit çdokush është i detyruar t’ia pranojë imperfeksionin e pashmangshëm të mjeteve të vëzhgimit dhe të matjes, por edhe nga një këndvështrim mirfilli teorik, supozimet e porealizueshme që mundësojnë pothuajse të gjithë themelimin e mekanikës “klasike”, ndërsa kjo e fundit është baza për themelimin e fizikës moderne, mund të përdoren për të dhënë një sërë shembujsh karakteristike.*

Themelimi i shkencës, i ngritur pak a shumë mbi nocionin e ripërsëritjes sjell një iluzion tjetër, kësaj here të llojit sasior. Besohet se akumulimi i një numri të madh faktesh mund të përdoret në vetvete si “provë” për teorinë. Do të duhej fare pak reflektim sidoqoftë, që të kuptohet se faktet e të njëjtit lloj mund të jenë të pafundme, kështu që jo të gjithë duhen marrë parasysh. E për më tepër, zakonisht, të njëjtat fakte vërtetojnë në të njëjtën masë teori të ndryshme. Shpesh thuhet se gjetja e sa më shumë fakteve rrit probabilitetin e vërtetësisë së një teorie. Të thuash këtë do të thotë të pranosh se asnjëherë nuk mund të arrihet një siguri e plotë dhe se përfundimet e shpallura nuk janë asnjëherë “ekzakte”. Kjo provon karakterin tërësisht “empirik” të shkencës moderne, pavarësisht se si për ironi të fatit, partizanët e saj akuzojnë antikët për njohuri “empiriciste”. Bash e kundërta është e vërtetë:

njohuritë e antikëve, të cilët s’kishin as një farë ideje për natyrën e vërtetë, zanafilluan nga principet dhe jo nga vëzhgimet empirike, kështu që mund të thuhet se shkenca profane është themeluar krejt në të kundërt me shkencën tradicionale. Për më tepër, meqë “empirizmi” është i pamjaftueshëm në vetvete, shkenca moderne është tepër larg të qenit integrale, meqë ajo injoron ose përjashton një pjesë të konsiderueshme të provave që vijnë prej përvojës, pikërisht asaj pjesë që ka karakter cilësor. Përvoja **perceptual**, më shumë se çdo lloj përvoje tjetër, nuk mund të ketë ndikim në aspektin sasior të kulluar. Sa më e afërt të jetë qasja kah aspekti sasior i kulluar, aq më e madhe bëhet distanca nga realiteti, i cili sidoqoftë supozohet të kuptohet dhe të shpjegohet. Në fakt nuk është dhe aq e vështirë të vërehet se shumica e teorive të vona janë bash ato që kanë lidhjet më të dobta me realitetin dhe që e zvendësojnë këtë të fundit me “konvencionet”. Këto konvencione nuk janë fare arbitrare, e natyrisht s’është e mundur që të jenë ndryshe meqënëse krijimi i çfarëdolloj konvencioni përfshin një proces të arsyes. Megjithatë, mund të themi se ato janë arbitrare me sa të mundin. Si të thuash, ato duket sikur dëshmojnë se mund të ketë fare pak mbështetje në natyrën e vërtetë të gjërave.


Sapo u tha se shkenca moderne, thjesht sepse mëton të jetë tërësisht sasiore, nuk merr parasysh diferencat midis fakteve të veçantë, edhe atëhere kur këto diferenca janë shumë të theksuara dhe kur elementët cilësorë kanë epërsi ndaj atyre sasiorë. Mund të thuhet se kjo është arsyeja pse pjesa më e madhe e realitetit e shmang shkencën dhe pse aspekte të pjesshme dhe inferiore të të vërtetës që ajo mund të rrokë pavarësisht gjithë dështimeve (sepse shkenca diç rrok, pasi gabimi total do ta shfuqizonte tërësisht) reduktohet deri në thujse asgjë. Ky është pjesërisht rasti kur faktet e rendit human merren në konsideratë, e pavarësisht se këto janë shumë më cilësorë nga sa përmban domeini i shkencës, kjo e fundit është e vendosur t’i trajtojë përpikshëm si faktet e tjera. Domethënë shkenca interesohet jo vetëm për “çështjet e organizimit” por edhe për “rradhën e çështjeve”, meqë në fund të fundit shkenca përdor një metodë, të cilën e aplikon në mënyrë uniforme në të gjitha objektet, pavarësisht diversitetit të tyre, pikërisht sepse sipas këndvështrimit të saj, ajo është e paaftë të perceptojë dallimet esenciale midis fakteve. Karakteri i rremë i “statistikave”, me të cilave shkenca moderne është kaq e lidhur, bëhet i dukshëm në fusha të tilla si historia, “sociologjia”, “psikologjia” apo çdo lloj studimi tjetër të cilit i vendoset një emër. Më shumë se kudo tjetër, këtu, statistikat, në kuptimin më të

parë të fjalës, lidhen me numërimin e fakteve, të cilët supozohen të jenë të ngjashëm, pasi në të kundërt mbledhja e tyre do të ishte e pakuptimtë. Është e qartë se piktura e përftuar në fund është një deformim i të vërtetës. Sa më pak fakte të ngjashme a të krahasueshme të merren parasysh dhe sa më e madhe të jetë rëndësia relative dhe kompleksiteti i elementëve cilësorë të përfshirë, aq më i thellë është deformimi, Megjithatë, përkthimi në figura dhe llogaritje, i jep statistikuesit një farë iluzioni për “ekzaktësinë” që ai mund t’u japë të tjerëve, por kjo në fakt është një “pseudo-matematikë”. Për shkak të pavëmendjes dhe të forcës me të cilën veprojnë idetë e paramenduara, çdo përfundim i dëshiruar nxirret tak-fak prej ca figurave, të cilat janë fare të zhveshura nga ndonjë lloj domethënieje. Dëshmi për këtë është fakti se të njëjtat statistika të përpunuara nga ekspertë të ndryshëm të së njëjtës fushë, japin teori respektive me përfundime të ndryshme, ndonjëherë edhe diametralisht të kundërta.

Kështu, shkencat moderne të vetëstiluar si “ekzakte”, shkojnë deri atje sa përdorin statistikat për të parashikuar të ardhmen (mbështetur në identitetin e supozuar të fakteve). Ato nuk janë më shumë se sa shkenca “hipotetike” që përdorin shprehje të lirshme në një farë astrologjie moderne gjasje « shkencore ». Duke përdorur këtë term (shkencore)ata pohojnë lirisht se në çfarë konsiston astrologjia e tyre. Është e sigurtë që ajo ka vetëm një lidhje të vagët dhe të largët, ose ndoshta asgjë më tepër se sa një terminologji të përbashkët, me astrologjinë tradicionale të antikëve, e cila, si të gjitha dijet e tjera të të njëjtit lloj, sot ka humbur tërësisht. Kjo neo-astrologji i përdor dhe stërpërdor

statistikat, në mënyrë që të gjejë mbështetje “empirike”. Duke qenë se kjo lloj astrologjie është e palidhur me ndonjë princip, statistikat luajnë një rol dominant në të. Arsyeya më kryesore pse është e drejtë që kjo astrologji të zbukurohet me epitetin “shkencore” lidhet me faktin se karakteri shkencor i astrologjisë së vërtetë mohohet kategorikisht. Edhe mohimi është shumë domethënës dhe karakteristik për mendësinë moderne.

Supozimi se faktet janë identike kur ato janë të të njëjtin lloj apo të krahasueshme vetëm në ndërsjelltësi të caktuara, ndërsa kontribuon në krijimin e iluzionit për një shkencë “të saktë”, kënaq njëkohësisht edhe dëshirën për një thjeshtëzim të tepruar, një karakteristikë tjetër e mendësisë moderne. Pa pasur synim ironizues mund të thuhet se kjo është kaq e tepruar sa ky mentalitet mund të kulaifikohet si “thjeshtëzues” si në konceptet “shkencore” ashtu edhe në të gjithë manifestimet e tjera. Këto ide shkojnë bashkë: dëshira për thjeshtëzim shoqërohet domosdoshmërisht me tendencën për të reduktuar çdo gjë në aspektin sasior, (është e qartë që asgjë nuk është më e thjeshtë se sa sasia). Nëse një qenie apo një send do të zhvishej nga të gjitha cilësitë dalluese, “mbetja” e përftuar do të ishte një thjeshtëzim maksimal. Ky thjeshtëzim ekstrem do të mund të jetë i tillë sa kohë t’i përkasë sasiores së kulluar, të llogaritur në njësi ekzaktësisht të njëjta, të cilat përbëjnë shumëllojshmërinë numerike.



TË KAMURIT e kohës së Kuranit

Ibrahim Sarmësh

Kurani i përgatit njerëzit për Dynjanë dhe Ahiretin, duke i edukuar ata me dije dhe udhëzim. Pa u dhënë mundësinë e të zgjedhurit mes Dynjasë dhe Ahiretit, u mëson të thonë: **“Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)”** (Bekare, 201.) Sipas botëkuptimit islam, Ahireti është vendi që duhet të ketë më shumë përparësi për një musliman, për arsye se është vendi më i përsosur dhe më i qëndrueshëm.


Njerëzit që e kuptojnë drejt qasjen islame ndaj Dynjasë dhe Ahiretit, e dinë se kalimi i mbarë i Kësaj Bote dhe fitimi i Botës Tjetër, realizohet përmes veprës që bëhet në Dynja. Të gjitha mundësitë fitohen duke punuar shumë në këtë botë dhe duke vepruar sipas Islamit. Nuk bëhet fjalë të jenë lart ata që nuk kanë qenë lart në këtë botë. **“Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë.”** (Isra, 72.)

Sikurse u mësoi njerëzve që më të lartit janë besimtarët e vërtetë, Islami i mësoi po ashtu, të jenë të fuqishëm edhe materialisht. Ashtu siç nuk aprovon jetesën e besimtarëve si jobesimtarë, po

ashtu nuk aprovon jetesën e tyre si të varfër dhe të skamur. Përkundrazi, duke thënë: **“Në të vërtetë, fuqia është e Allahut, e të Dërguarit të Tij dhe e besimtarëve.”** (Munafikun, 8.), u mëson të jetojnë të nderuar me besimin e tyre në jetën shoqërore. Nëse besimtari punon shumë, me qëllim për të jetuar mirë në këtë botë, kjo gjë nuk ka lidhje me të qenët i dhënë pas materies. Muhamed Gazali shprehet kështu, lidhur me këtë pikë:

“E di edhe unë, ashtu sikurse edhe të tjerët, se si u shkatërruan paraardhësit dhe pasardhësit e atyre që e deshën këtë botë, aq sa u bënë materialistë. E dimë se edhe pas çdo lloji faji që bëhet si pasojë e neglizhencës, ka një lloj idhujtarie të tillë. Këto faje, para se t'i bënte masa e gjerë, i kanë bërë intelektualët. Fillimisht i kanë bërë liderët, pastaj ithtarët e tyre. Para se ato faje t'i bënin të çmendurit, i kanë bërë të mençurit. Por shërimi i saktë i kësaj sëmundjeje bëhet duke zotëruar botën dhe duke përbuzur gjërat e pavlefshme të saj.

Bëj më shumë pasuri nga ç'kishte Karuni. Arriji më shumë pushtet nga ç'kishte Sulejmani. Mbajni nën kontroll këto, që, kur të ketë nevojë e vërteta,



ta mbështesësh me to dhe, kur të të vijë vdekja, në çastet e sakrificës, t'i dorëzosh të gjitha për hir të Zotit.

Të jetosh në mënyrë të skamur, duke menduar se varfëria është rruga që të shpie në Xhenet, nuk është asgjë tjetër përveç marrëzisë.

Ndërkohë që i ligu, me mundësitë që ka, vazhdon pushtetin, kurse ti heq dorë nga mundësitë materiale që të kesh pushtet në tokë, ta dish që është gjynah më i rëndë edhe se prostitucioni dhe kamata.” (M. Gazali, es-Sunnetun-nebevijje, (përkth. turq.), fq. 114.)

Gazali ka shumë të drejtë, nëse duam ta kuptojmë siç duhet Islamit dhe realitetin. Nuk duhet harruar se Xheneti nuk është banesa e përtacëve, e të pa aftëve, e atyre që kanë vënë pushtet duke ushtruar dhunë. Nuk është vendi i servilëve, i atyre që nuk kanë turp të jetojnë të varur nga ndihma dhe lëmosha e tjetrit. Nuk është vendi i atyre që shpërfillin madhësinë dhe nderin, lirinë dhe pavarësinë e Islamit. Nuk është vendi i atyre që neglizhojnë robërinë vetëm ndaj Allahut. Nuk është vendi për ata që kanë zgjedhur skamjen si praktikë të jetës. E as që mund të jetë vendi i atyre që nuk e kanë rrisht shpalljen hyjnore, etikën, virtytin, nderin, madhësinë, lirinë dhe pavarësinë. Nuk është vendi i atyre që jetojnë të kënaqur me atë çfarë ofron kundërshtari dhe të varur nga lëmoshat e rivalëve. E as që mund të jetë vendi i atyre që Islamit, etikën, virtytin dhe vlerat e tjera i formësojnë sipas kundërshtarit. Nuk ka sesi të jetë vendi i atyre që e hapin zemrën e mendjen ndaj arrogancës dhe që presin lëmosha prej tyre. Shkurtimisht, Xheneti nuk është vendi i atyre që kërkojnë nderin dhe krenarinë nga dikush tjetër, përveç Allahut dhe që e mendojnë këtë si pjesë të përcaktimit të Zotit.

Nuk duhet të harrojmë se nderimi dhe poshtërimi janë në një ekuilibër në të dy botët. Ata që janë lart këtej edhe andej do të jenë lart. Ata që janë poshtë këtej edhe andej do të jenë poshtë. **“Ai, që në këtë botë ka qenë i verbër, do të jetë i verbër edhe në botën tjetër dhe më i humbur nga rruga e drejtë.”** (Isra, 72.) Lumturia dhe fatkeqësia në Ahiret, të qenët prej banorëve të Xhenetit apo prej atyre të Xhehenemit, kalon përmes mbrojtjes së vlerave që bëhet në këtë Botë dhe mënyrës së jetesës që keni zgjedhur. Thënë ndryshe, në Xhenet kalohet përmes asaj që të faturohet dhe mundit që ke shpenzuar.

Muslimanët, për të ruajtur ekzistencën e tyre, për t'u zgjeruar, forcuar dhe për të rivalizuar armiqtë, duhet të jenë të fortë, duke bërë investimet e duhura në fushat e duhura. Si rrathët e zinxhirit, edukimi, arsimit, shëndeti, transporti, komunikimi, bujqësia dhe industria, janë fushat ku duhet investuar me të

gjitha format. Përndryshe, populli mysliman nuk mund të shpëtojë pa u bërë nevojtar dhe i varur nga popujt e tjerë. Ashtu sikurse sot popujt myslimanë, me një popullsi prej mbi një miliardë, janë të varur dhe të ndikuar nga trysnitë e popujve të tjerë në këto fusha. Ekonomia e tyre është e detyruar të varet nga kreditë me interes. Për të mbrojtur veten, kanë nevojën e armëve të tyre. Për të rregulluar popullin e tyre, kanë nevojë për sistemet e tyre qeverisëse dhe drejtësitë. Për të rregulluar anët e tjera të jetës, kanë nevojë për direktivat, produktet dhe mbështetjet e tyre. Në shkëmbim të arritjes së këtyre, e kemi vënë re të gjithë se si gjunjëzohen dhe varen nga dëshirat dhe kërkesat e popujve të tjerë edhe në çështjet më jetike, siç janë besimi, tradita, edukimi, arsimit dhe mbrojtja e popullit.

Natyrisht, investimi bëhet me para. Për të pasur para duhet të punosh dhe të fitosh. Ai që është bërë i pasur duke punuar dhe fituar, për të qëndruar në këmbë i duhet ta mbrojë e ta shtojë pasurinë, duke bërë kujdes edhe rivalitetin. Kjo gjë arrihet duke ndarë më shumë kohë dhe mund.

Dëshira për materien dhe për mirëqenien dhe trysnia e jetës sociale dhe e kushteve të tregut, të bëjnë që të punosh për t'u bërë i pasur. Allahu i Madhëruar, duke e bërë të ditur se brenda njeriut ekziston një dëshirë për këto gjëra, thotë: **“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu.”** (Ali Imran, 14.) Krahas grave, fëmijëve dhe parave, mund të vendosim transportin, komunikimin dhe gjithçka tjetër.

Ata që janë të pasur, për arsye të kujdesit që kanë për të ruajtur apo për të shumuar pasurinë e tyre, e kanë në një dizekuilibër kohën që ndajnë për këto, me atë që ndajnë për Kuranin, për ta lexuar e jetuar atë. Madje, gjithnjë është në shuarje të plotë kjo kohë. Sepse tamahu për të mbrojtur dhe shtuar pasurinë, vazhdon të vjedhë nga koha për të zbatuar parimet islame. Këshu, nevoja për të mbrojtur pasurinë dhe tamahu për ta shtuar atë, në një farë mënyre i bën rob ose i bën të punojë si robërit e saj. Besimtarët që punojnë, fitojnë, bëhen të pasur dhe shtojnë pasurinë për t'i shërbyer rrugës së Allahut. Kur themi se duhet punuar shumë për të fituar këtë botë dhe tjetrën, nuk duhet të harrojmë realitetin e qëndrueshmërisë në këmbë në këtë bazament të rrëshqitshëm dhe të baltosur.

Për të evituar këtë, krahas përpjekjeve të punës dhe zgjerimit të myslimanëve të pasur, duhet të kenë përpjekje/programe ditore për të kuptuar Kuranin.

Qoftë si grup nën udhëheqjen e ndonjërit, qoftë edhe në mënyrë individuale. Nëse kuptojnë gjuhën origjinale, le ta lexojnë nga gjuha origjinale, nëse jo, le ta lexojnë në gjuhën që ata kuptojnë, por medoemos duhet ta lexojnë, duhet të rregullojnë botëkuptimin dhe mënyrën e jetesës sipas tij.

Është mjaft e rrallë dhe e vështirë ta kuptojnë nevojën e një praktike të tillë vetë të pasurit - kjo vlen edhe për kategoritë e tjera. Përgjegjësia kryesore për t'i korigjuar ata, për t'i kapur për dore dhe për t'i drejtuar nga e drejta, është në dorën atyre të diturve që njohin Islamin. Njerëzit që lexojnë Kuranin, për ta kuptuar dhe për ta shpjeguar, ashtu siç janë të obliguar të interesohen për të tjerët dhe të bëhen udhëheqës të tyre, duhet të interesohen edhe për të pasurit, t'i takojnë ata me Kuranin dhe t'i ndihmojnë në programimin e ditës. Kështu krijohen të kamurit e kohës së Kuranit dhe vetëm kështu ngrihet në këmbë dhe fuqizohet populli mysliman. Islami nuk bie në kundërshtim me të qenët i pasur apo të qenët fetar, me të qenit i kamur. Ashtu siç duhet ta bëjnë këtë udhëheqje të diturit për të pasurit, po ashtu edhe të pasurit duhet të gjejnë njerëz që mund t'u shërbejnë dhe që mund t'i udhëheqin ata në këtë pikë. Kjo detyrë bie në mënyrë të barabartë mbi secilën palë.

Kjo është rruga e vetme e të pasurve për të ruajtur veten. Përndryshe do të largoheshin apo shkëputeshin nga feja, duke u rrëmbyer nga vorbullat e të mbrojturit dhe zgjeruarit të pasurisë. Një gjë e tillë është e detyruar të bëhet nga çdo mysliman, por veçanërisht myslimanët e kamur e kanë më të obliguar. Sepse rrallëherë mund të ndodhë të dalësh nga feja për arsye të skamjes. Kurse dalja nga feja për arsye të pasurisë është më e mundshme. Madje Kurani, nuk jep shembuj të atyre që dalin nga feja për arsye të varfërisë, por shembuj, sikurse ai i Karunit, që dalin nga feja për arsye të pasurisë, ka dhënë shumë. Kurani jep rastet se si të pasurit arrogantë ishin të parët që u kundërviheshin pejgamberëve, i mohonin ato çfarë thoshnin ata dhe ishin po ata që bëheshin shkak që ai popull të shkatërrohej nga dënimi i Zotit.

“Në çdo vendbanim që Ne kemi nisur ndonjë të dërguar, ata që bënin jetë luksoze thoshnin: “Me të vërtetë, ne nuk besojmë në mesazhin që keni sjellë!” (Sebe’, 34.)

Po ashtu, në çdo vend që Ne kemi dërguar paralajmërues para teje, pasanikët e atij vendi thoshnin: “Ne i kemi gjetur etërit tanë në këtë fe dhe po ndjekim gjurmët e tyre”. (Çdo i dërguar) thoshte: “Po sikur unë t’ju kem sjellë (një fe) më të ndriçuar se ajo e të parëve tuaj?!” Ata thoshnin: “Ne e mohojmë mesazhin me të cilën jeni dërguar!” Atëherë, Ne hakmerreshim kundër atyre, prandaj shiko si ka qenë përfundimi i femohuesve. (Zuhruf, 23 - 25.)

Kështu ka ndodhur dikur, por edhe në kohën e Profetit Muhamed (a.s.). Kurani e shpjegon në këtë mënyrë kundërvënien e njerit prej të pasurve arrogantë ndaj ftesës së Muhamedit (a.s.):

“Më ler Vetëm (të merrem) me atë që e krijova dhe i dhashë pasuri të pamatë e djem pranë vetes! Unë ia bëra kamjen të lehtë e të shtruar, e, megjithatë, ai lakmon që t’i jap më tepër. Jo, kurrsesi! Vërtet, ai i mohoi me kryeneçësi shpalljet Tona, prandaj Unë do ta ngarkoj atë me dënime të rënda. Ai mendoi dhe kurdisi (kundër Kuranit), - dhe qoftë mallkuar, si kurdisi! Dhe sërish qoftë mallkuar, si kurdisi! Pastaj vështroi rreth vetes, mblodhi vetullat e u vrenjt, pastaj u kthye i kapardisur dhe tha: “Ky (Kuran) nuk është gjë tjetër, veçse magji e trashëguar! Këto janë vetëm fjalë të një vdekatari!” Do ta hedh në Sekar (Xhehenem)! E si mund ta dish ti tamam se çfarë është Sekari (zjarri përvëlues)? Ai nuk lë gjë dhe nuk kursen asgjë, lëkurat i shkrumbon.” (Mudethir, 11-29.)

Ndërkohë që Kurani nuk përmend ndonjë rast që të jetë shkatërruar ndonjë qytet, si pasojë e kundërvënies ndaj pejgamberëve e as nuk bën fjalë për ata që kanë dalë nga rruga e fesë për arsye të skamjes së tyre, por jep shembuj se si janë shkatërruar qytetet, si pasojë e kundërvënies së të pasurve arrogantë ndaj pejgamberëve:

“Kur vendosim ta shkatërrojmë një qytet, Ne i urdhërojmë (për mirë) të pasurit e tij dhe, kur ata bëjnë mbrapshti në të, atëherë përmbushet Vendimi (i dënimit) kundër tyre dhe Ne i shkatërrojmë gjer në themel.” (Isra, 16.)

Djelmoshat që i besuan ALLAHUT

— Raziye Tekgyl —

Djelmoshat që sfiduan kohën, duke u rebeluar kundër paganizmit, shkatërrues të vlerave hyjnore, njihen në terminologjinë fetare si “Ashabul-Kehf”. Në Kuranin e shenjtë, ata përshkruhen me nderime dhe kosiderata të larta **“Ata ishin djelmosha që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcuan në rrugën e drejtë.”** Përsa i përket numrit, kohës dhe vendit ku kanë jetuar, ekzistojnë pikëpamje të ndryshme. Qëllimi i tregimit nuk është dhënia e informacionit historik, por paraqitja e qëndrimit fisnik dhe të palëkundur që mbajtën këta djelmosha përballë presionit të fortë të gjithë shoqërisë politeiste. Një reagim i tillë plot krenari mund të burojë vetëm nga një iman i sinqertë e i rrënjosur thellë në zemër. Një zemër e nënshtruar plotësisht ndaj Allahut qëndron e palëkundur përballë çdo lloj vështirësie apo joshjeje tokësore e të përkohshme. Pyetjes së mbretit të asaj kohe Dakjanusit: “Kush është Zoti juaj?”, këta djelmosha besimplotë iu përgjigjën në mënyrë të prerë dhe të sigurt: **“Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës.”** Në këtë mënyrë shprehën bindshëm dhe qartë identitetin e tyre, duke shpallur distancimin e plotë të tyre nga idhujtaria politeiste dhe çdo gjë që ka lidhje me të.

Të sfidosh realitetin, në një kohë kur idhujtaria mbisundon çdo pjesë të shoqërisë, duke u ndjekur dhe mbrojtur me një fanatizëm të verbëruar nga çdo anëtar i saj...

Kurani, i cili ka zbritur për të ndarë të vërtetën nga gënjeshtria, përmend me detaje personalitete shembullore, si Ibrahim (a.s.), me qëndrimin krenar përballë mbretit mizor apo si Jusuf (a.s.), i cili triumfoi me dinjitet mbi tundimin e imoralitetit.

Jeta kuptimplotë e këtyre djemve guximtarë, të cilët nuk ishin pejgamberë, është mësim dhe udhërrëfyes i çmueshëm për të gjithë brezat pasardhës në çdo periudhë historike. Jeta e tyre është më tepër se një pishtar që ndriçon ambientin përreth.

Ata u përpoqën me ç'mundën për të përhapur dritën jetëdhënëse të tevhidit. Kjo përpjekje e tyre është shumë domethënëse për ata që mendojnë për botën tjetër, siç mendojnë për jetën tokësore.

Dihet tashmë se si e harxhojnë të rinjtë periudhën më të bukur dhe aktive të jetës së tyre dhe nën udhëheqjen e kujt prijësi e kanë dorëzuar jetën. Sot gjendemi përballë një turme të rinjsh melankolikë që nuk njeh historinë, kulturën dhe vlerat njerëzore, madje i mohon me forcë këto vlera. Ky grup të rinjsh, me kalimin e kohës ka arritur përmasat e një rreziku potencial për shoqërinë. Ankimi i të gjithë prindërve për fëmijët e tyre, ndërsa janë shkaktarët kryesorë për gjendjen e tyre të mjerueshme, është një paradoks mjaft interesant.

Sot jemi ballë për ballë me prindër që bëjnë përpjekje titanike, gjoja për të garantuar të ardhmen e fëmijëve, por me keqardhje mund të themi se po e shkatërrojnë të ardhmen e tyre, pa filluar akoma. Me pretendimin se po i shpëtojnë fëmijët, po i hedhin me duart e veta në zjarrin përvëlues të materializmit, duke shkatërruar lumturinë e përjetshme të tyre. Për të rritur prestigjin e vet, përdorin fëmijët e tyre. Ngaqë në jetën e tyre nuk kanë realizuar asgjë, mburren me aftësitë e fëmijëve dhe përpiqen të ekzistojnë nën hijen e tyre.

Është e dhembshme kur shikon pasionin e tepëruar të myslimanëve ndaj kësaj bote. Pyes veten: kjo gjendje buron nga që myslimanët nuk i lexojnë urdhrat e Kuranit apo, megjithëse i kuptojnë, kanë rënë pre e dëshirave dhe epsheve. Fëmijët për të cilët po flasim, janë fëmijë të prindërve myslimanë. Ku është gabimi që po sjell shtimin e prindërve, të cilët po bëhen vrasës të fëmijëve të tyre? Si është e mundur që fëmijët, të lindur me natyrshmëri të pastër, braktisen nga prindërit e tyre në kopenë e ujqërve? A nuk duhej të ishte manteli i devotshmërisë një mburojë për ta? Përse fëmijët që rrjedhin prej familjeve besimtare po manifestojnë gjithnjë e më tepër sjellje të papëlqyeshme? Përse nuk nxirret mësim prej disa përvojave të hidhura? Si i lënë fëmijët me kaq dëshirë në dorën e një sistemi arsimor që synon shpëlarjen e trurit të të rinjve, nëpërmjet rrënimit të trashëgimisë së vlerave shpirtërore.

Me ndryshimin e madh që ka pësuar në mendësi dhe ndjesi kjo gjeneratë, mendoj se nuk e ekzagjeroj po të them se ka marrë një rrugë pa krye. Si Neroni që dogji Romën për hobi edhe në mesin tonë po rriten

adoleshentë që, ku ta di për çfarë dokrine apo ideali, fitojnë cilësinë "vrasës". Këta të rinj, që nuk janë pajisur me dije dhe nuk veprojnë sipas arsyes së shëndoshë, janë si Donkishoti, aventurierë, ëndërrimtarë të ekzaltuar që nuk i njohin ligjësitë e vërteta të jetës, duke këmbëngulur në veprime që bien ndesh me logjikën më të thjeshtë. Kësaj rinie pasive dhe të përhumbur i duhen ndriçuar zemrat me dritën e islamit. Kjo rini duhet ta ndjejë rrënqethjen hyjnore. Çfarë dallimi kemi ne nga Hamleti, nëse mendojmë se zgjidhja e vetme është kthimi nga Kurani dhe, nga ana tjetër, nuk vihemi në lëvizje për ta jetësuar. Nëse nuk i përvetësojmë siç duhet ajetet kuranore që na drejtohen pikërisht neve dhe t'i pasqyrojmë në sjelljet tona të përditshme, atëherë është me vend fjala e mendimtarit të shquar pakistanez Muhamed Ikbali, i cili thotë: "Është marrëzi të lexosh tefsiret e komentatorëve të famshëm të Kuranit." Myslimani nuk duhet ta pranojë këtë gjendje, i zhytur në indiferentizëm. Prindi mysliman duhet ta informojë fëmijën për personalitetet shembullore islame, sepse islami synon formimin e një njeriu model. A po edukohen sot personalitete shembullore, si Ibrahim (a.s.), që të thyejnë normat johyjnore që njeriu i sotëm i konsideron të shenjta apo si Jusuf (a.s.), që përballë tundimeve imorale të thotë: "Allahu më ruajtë!" (Jusuf/23.) ose si Musai (a.s.), i cili, përballë padrejtësive pa fund nuk u dorëzua, por punoi pa u lodhur për të mbajtur drejtësinë në këmbë.

Sot përballemi me turma njerëzish, të cilët u ngjajnë statujave që nuk reagojnë ndaj asnjë lloj ngacmimi.

Këto profile njerëzish që janë bërë një lëmsh i madh në shoqërinë tonë, përmenden me admirim nga ana e shoqërisë. Kjo tregon se kanë humbur aftësitë opozitare dhe gjithkush shikon interesin e vet. Në asnjë kohë dhe në asnjë mënyrë imani nuk i ka pranuar sjelljet dhe veprimet e kufrit, ndërsa sot besimtarët bashkëjetojnë me të. Si munden myslimanët ta anashkalojnë këtë realitet të hidhur, duke u treguar kaq indiferentë. Ne si myslimanë duhet të jemi të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që kemi për të kontribuar në ndryshimin e përmirësimin e gjendjes së mjerueshme në të cilën ndodhet shoqëria dhe jo të mburremi me atë që kanë bërë të parët tanë. Më së paku, ne si besimtarë duhet të jemi të vetëdijshëm që ky sistem jete nuk përputhet fare me parimet e islamit.



Parimi themelor i edukimit

Ali Byjyçapar

Ka shumë rëndësi të dish të lexosh dhe të kuptosh si duhet gjendjen shpirtërore apo mendimet e personit që ke përballë. Lidhje të afërt me këtë gjë kanë arsimimi dhe edukimi.

Kur dëgjojmë të thuhet “njeriu është krijuar”, menjëherë na vijnë ndër mend pyetjet “pse dhe kush e ka krijuar njeriun”? Përgjigjet e sakta që do të jepeshin, do të përcaktonin edhe përmbajtjen e arsimimit dhe edukimit.

Përgjigja “njeriun e krijoi leshteriku”, është shumë e ndryshme nga përgjigja “njeriun e krijoi Allahu”.

Çështja mund të përkufizohet edhe në këtë mënyrë:

Përcaktimin e natyrës së njeriut dhe detyrat e tij në këtë botë do t’i bëjmë sipas këndvështrimit të Kuranit apo çfarëdolloj këndvështrimi tjetër të ndryshëm prej tij.

Shkurtimisht, kur themi arsimimi dhe edukimi i njeriut, para së gjithash jemi të detyruar të sqarojmë këtë pikë.

Në qoftë se shprehni se **arsimimi i njeriut ka shumë lidhje të ngushtë me besimin e tij, prandaj edhe duhet pasur parasysh besimi që ai ka**, atëherë pedagogët duhet të njohin besimin dhe shfaqjet e tij. Në të kundërt, fëmijët që po edukohen, do të futen në një konfuzion aq të madh, saqë, në vend të arsimohen, do të edukohen për mbrapsht.

Fakti që ne jemi myslimanë, na mëson se nga cili këndvështrim duhet t’u qasemi problemeve.

Njeriu që beson se Kurani dhe suneti janë të saktë, do të thotë se ka pranuar edhe udhëzimin hyjnor. Kjo situatë na e bën punën më të lehtë. Refuzimi i kësaj

të vërtete, do të thotë të mbetesh në errësirë dhe të udhëtosh në një rrugë të gjatë këmba-doras, gjë që është shumë e rrezikshme. Si mund të perceptohet njeriu, veçanërisht bota e tij shpirtërore, në qoftë se nuk kemi një udhëzues për shpalljen hyjnore? Si do ta mësojmë se nga ka ardhur, për ku është duke shkuar dhe çfarë pune ka në këtë botë të përkohshme? Si mund t’i përmbushni nevojat e kësaj enigme, që është e tëra e ndërtuar mbi ekuilibra të ndjeshëm, gjithmonë duke dashur që t’i ruajmë këto ekuilibra?

A nuk do ta shkatërronit njeriun, duke aplikuar tek ai një program arsimor të rastësishëm?

Meqë udhëzuesi ynë është shpallja hyjnore, atëherë edhe qëllimin e jetës si dhe bazat e edukimit duhet t’i përcaktojë po shpallja hyjnore. Unë jam i mendimit se në këtë pikë ne duhet ta lexojmë drejt prirjen nga do të rrjedhë shekulli ynë, ta kuptojmë sa më mirë njeriun dhe ta komentojmë Kurantin dhe sunetin me mendje të ndritura.

Njeriu është krijuar nga Allahu dhe është caktuar mëkëmbësi i tij në tokë, një pozicion shumë i rëndë për t’u mbajtur mbi supe.

Allahu i ka krijuar botët, të cilat ia ka dorëzuar përkohësisht nën zotërim njeriut, i cili, me atributin e mëkëmbësit të Allahut në tokë, do ta trajtojë si veten e tij, ashtu edhe krijesat e tjera në përputhje me dëshirën hyjnore dhe do t’i paraqesë falënderimet më të sinqerta Allahut, që e krijoi, e pajisi dhe e caktoi mëkëmbës të Tij. Gjithë këto punë kërkojnë njohuri, mendim dhe nivel. Mëkëmbësia e Zotit nuk është gjë e lehtë, por një gjë që kërkon arsimim dhe edukim. Bijtë e Ademit do të përjetojnë procesin e zhvillimit,

duke përbushur fazat e edukimit, që e lartësojnë nga njeri i thjeshtë, në njeri të civilizuar, nga balta, drejt Arshit, nga kafsha që flet, në njeriun e përsosur. Vetëm po ta përjetojnë procesin në fjalë, atëherë meritojnë mëkëmbësinë hyjnore.

Procesi i arsimim-edukimit, që zë fill para martesës, me qëllime të mbara dhe ndjenja që nuk e përfillin anën materiale, do të vazhdojë për sa kohë që “syri sheh dhe zemra rreh”. Në të kundërt, njeriu do të mbetet në nivelin e instinkteve shtazarake dhe nuk do ta meritojë mëkëmbësinë.

Pasi të bëhen të qarta harta e rrugës dhe drejtimi që duhet marrë, do të dalë në pah edhe përbajtja e arsimim-edukimit.

Jeta duhet jetuar në përputhje me pëlqimin e Allahut, duke i vlerësuar kushtet materiale në përputhje me nderin e njeriut. Në këtë mënyrë, do të vazhdojë edhe zhvillimi, pra do të kryhen punët e edukimit dhe arsimimit.

Le t'i sqarojmë më shumë ato që sapo shkruam.

Pëlqimi hyjnor është qëllimi final, ndjesitë metafizike janë kushtet e domosdoshme, ndërsa kushtet materiale janë elementë plotësues. Njeriu duhet të njohë dhe të zhvillojë edhe njerzillëkun edhe myslimanllëkun e tij edhe kushtet materiale në të cilat jeton. Edukimi dhe arsimimi i tij do të drejtohen në këto tre drejtime.

Aty ka një udhëtar drejt përjetësisë. Përbajtja e rrugës që duhet të përfitojë udhëtari, shndërrimi i kësaj përbajtjeje në personalitet dhe mësues, që do ta ndihmojnë këtë udhëtar që të pajiset me këto përfitime. Nxënësi duhet të kërkojë dhe të jetë i talentuar, përbajtja e edukimit që do t'i jepet, të jetë e saktë dhe mësuesi duhet të jetë adekuat.

Një kuadër i respektuar dhe adekuat ndaj metafizikës duhet të përcaktojë përbajtjen e edukimit, nuk duhet të nxitohet në shpërndarjen e shkallëve edukative të kësaj përbajtjeje dhe mësuesi duhet ta marrë me seriozitet punën.

Ata që nuk u qasen problemeve nga këndvështrimi i Kuranit, nuk do të jenë të suksesshëm në edukim dhe arsimim, cilatdo qofshin qëllimet e tyre, sepse njeriu nuk do të mund të bëhet udhëzues për njeriun që nuk arrin ta perceptojë atë dhe problemet e tij. Prandaj njeriu i duhet lënë Allahut.

Dëshira është që të gjithë nxënësit në botën njerëzore të edukohen dhe të arsimohen në përputhje me prirjet dhe talentet që kanë, duke llogaritur në këtë mënyrë edhe dallimet ndërmjet tyre. Përbajtja e edukimit duhet përcaktuar duke llogaritur fizikun, mendjen dhe botën shpirtërore të personit. Mësuesit duhet të jenë mësues të vërtetë. Në të kundërt fëmijët, trëndafilat e kësaj bote, kanë për t'u tharë si mos më keq.

Njeriu nuk ka vetëm mend, por edhe zemër e shpirt. Për këtë arsye, nevoja për adhurim dhe estetikë është e barabartë me nevojën për dituri dhe shkencë. Njeriu duhet të marrë vesh edhe nga harmonia e tingujve

dhe zërave që mbushin këtë botë, edhe nga shpalljet hyjnore që vërshojnë nga toka dhe qiejt. Prandaj, ai duhet të shkojë shumë në shkollë dhe në xhami dhe të ngërthehet pas natyrës. Edukimit dhe arsimimit, të krasitur nga degët e metafizikës dhe estetikës, nuk do t'u qeshë fytyra.

Në goftë se shkollat do ta nxirrnin në pah dhe do ta zhvillonin dëshirën e fëmijëve për të lexuar, atëherë do të kishin bërë një të mirë të madhe, duke përbushur kështu një detyrë të tyre shumë fisnike. Falë kësaj, nxënësi do të njihej me mendjet më të mëdha dhe shpirtat më të pasur. Do të fliste dhe do të bëhej shok me ta. Koha e lirë nuk do të ishte më shkak mërzie dhe bota do të bëhej e shumëngjyrshme.

Për fat të keq, potenciali ynë për të lexuar po avullon për shkak të një programi mësimor që nuk e ka për shqetësim leximin e natyrës njerëzore.

Shkenca duhet të jetë një preokupim për t'u marrë me dashurinë dhe pasionin. Dëshira për dituri, që gjendet në natyrën tonë njerëzore, duhet ndezur nga ana e edukatorëve mjeshtra. Kjo do të thotë, ta mbushim jetën tonë me emocione të larta dhe dëshira sublime.

Mbase është mospërcaktimi i saktë i qëllimit të edukimit, fakti që nuk ditëm ta mësojmë mirë këtë dashuri pasionante. Shkollat nuk na përgatitnin për jetën, po për provimet. Diploma nuk qe dokumenti që vërtetonte se tashmë e ke edukuar veten, por diploma e bukës, që duhej siguruar në vitet në vazhdim. Mjeti u bë qëllim dhe kjo situatë prodhoi bezdi, mërzi dhe krizë shpirtërore e mendore.

Udhëtimi i dijes zgjat një jetë të tërë. Nuk mund të kalohen hapësira kaq të largëta me logjikën e metodave shtrënguese të tipit “mundohu edhe ca”. Duhet të ketë se s'bën dëshirë dhe pasion për arsimim, edukim dhe prodhim. Në të kundërt, do të jetë e pashmangshme të mos flesh rrugës, ta shesësh idealin dhe të shmangesh nga rruga e vërtetë.

Përpjekjet në këtë jetë nuk duhen bërë për 4-5 kacidhe dhe ca duartrokite të thata, por që të fitojmë prehjen shpirtërore në këtë botë dhe përjetësinë në botën tjetër.

Na ka marrë malli për mentalitetin që e koncepton fëmijën si “kryevepra e Zotit” dhe mirësjelljen që është e vështirë të harrohet.

Na ka marrë malli për mësuesin që uron që nxënësi të ketë mendje të hapur dhe shpirt të lehtësuar në jetë dhe që lutet që nxënësi të punojë sipas diturisë dhe të jetë përherë durimtar dhe i ndërgjegjshëm.

Na ka marrë malli për mësues që hyjnë në klasë si të jenë duke hyrë në faltore, plot respekt dhe që mendojnë se janë të gatshëm të durojnë një mijë dyfytyrësh, vetëm e vetëm që të arrijnë të edukojnë një nxënës.

Na ka marrë malli për ata që thonë “një ditë të gjithë do të vdesim, por jemi mërzitur se nuk mbaroi ende libri”. Për ata që u mbarojnë ditët e jetës, por jo dëshira për të mësuar dhe edukuar.



Nëse puna s'i jepet ekspertit

Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan

Transmetohet sipas Ebu Hurejres, (r.a.), se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “...Prit Kijametin në kohën kur puna t'i dorëzohet të paaftit.”¹

SHKAKU I TRANSMETIMIT

Në një mbledhje, ndërkohë që i Dërguari i Allahut, (a.s.), po u tregonte diçka sahabëve që ishin rreth tij, erdhi një beduin dhe e pyeti:

- Kur do të ndodhë Kiameti?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk e ndërpreu fjalën dhe vazhdoi ligjëratën. “E dëgjoji nomadin, por nuk i pëlqeu pyetja.” Dhe dikush tha: “Ndoshta nuk e ka dëgjuar.” Pikërisht në atë kohë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), mbaroi fjalën dhe tha:

- *Ku është ai që pyeti për Kijametin?*

Beduini tha:

- Unë, O i Dërguari i Allahut, jam këtu! I Dërguari i Allahut, (a.s.), iu përgjigj:

- *Në kohën kur të humbasë amaneti (mirëbesimi), prit Kijametin!*

- Nomadi tha:

- Si mund të humbasin amanetet?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), iu përgjigj:

- *Kur puna t'i dorëzohet të paaftit, prit Kijametin!*²

Mosdorëzimi i punës te eksperti i saj, vjen si pasojë e përhapjes së injorancës dhe e largimit të dijes nga mesi i njerëzve. Aty ku ka njerëz që e njohin thelbin e punës, nuk mund të mendohet që kjo punë t'u dorëzohej të paafteve. Por, nëse injoranca është përhapur gjithandej, punët mbeten në dorën e atij që nuk është i aftë t'i kryejë.

PROVA TË RËNDËSISHME

Në hadithin fisnik, na tërheqin vëmendjen tri pika dhe vendime të rëndësishme: mosdorëzimi i punëve te ata që nuk janë ekspertë, humbja e amanetit dhe koha e ndodhisë së Kijametit. Përveç kësaj, del në krye sjellja e Profetit, (a.s.), që tregon se në ç'formë duhet të jenë marrëdhëniet mësues-nxënës dhe atij që jep fetva me atë që kërkon fetva. Por ne do të qëndrojmë në disa çështje të tjera, duke u mjaftuar me përmendjen e rëndësisë së kësaj sjelljeje.

Fjala el-emr që kalon në hadith, do të thotë çdo lloj pune që ka lidhje me fenë. Është një vendim që përfshin angazhimin te dikush si “punë” ose çdo gjë që nxirret në pah. Ajo përfshin të gjitha punët, që nga administrata shtetërore, deri te punët komunale, të cilat kërkojnë çdo lloj energjie, aftësie dhe kompetence. Prandaj, el-emr, siç e ka përshkruar edhe komentuesi Ajni, përfshin edhe *fetvatë*, krahas kalifatit dhe kadillëkut.

Nga aspekti gjithëpërfshirës, *fetva-ja* është një çështje konsulence shumë e rëndësishme që kërkon dinamizëm, pjekuri dhe përgjegjësi të madhe, të cilat

1. Buhari, Ilim 2.

2. Shiko Buhari, Ilim 2.

sigurojnë një mbizotërim fetar në jetën e përditshme, madje një qëndrim në kuadër të parimeve fetare për çdo ecuri të ngjarjeve. Një hadith tjetër i nderuar na tërheq vëmendjen në këtë drejtim, duke thënë: “Allahu i Lartësuar nuk ua heq dijen njerëzve, pasi t’ua ketë dhënë. Por, Ai merr nga mesi tyre dijetarët bashkë me dijen e tyre, dhe injorantët, njerëzit e paditur mbeten pas. Populli i qan hallet tek këta, ndërsa ata i përgjigjen sipas mendimit të tyre. Kështu që edhe popullin edhe veten e tyre e çojnë në humbje.”³

Kjo situatë, pa dyshim sjell përfundime të rrezikshme në strukturën e shoqërisë. Ose e çon shoqërinë në një anarki që ngjan me kijametin. Shkaku kryesor i këtij përfundimi fatal, është iniciativa që ndërmarrin njerëzit e paaftë dhe të pakualifikuar me dëshira dhe ambiciet vetiake, për të udhëhequr popullin në emër të fesë. Në fakt, vështrimet që bazohen në parimet fetare, si Kuran, sunet dhe ixhma’ (*mendimet unanime të dijetarëve*), janë opinione dhe këndvështrime të lavdëruara dhe të mirëpritura.

Në mënyrë absolute, nuk është këndvështrimi dhe analogjia që nënçmohet, por nënçmohen këndvështrimet personale që janë larg nga mendimet që lidhen me argumentet bazë të fesë dhe që nuk përmbajnë një shqetësim të tillë. Kjo është më se e natyrshme. Sepse çdo sistem dhe çdo fe ka një parim të përgjithshëm dhe baza që ajo i çmon shumë. Mund të rrihet në një ambient të tillë, përderisa në atë vend zbatohen këto parime. Përndryshe, nuk mund të flitet për një jetesë dhe ecuri në përputhje me parimet fetare, por për një shpërbërje dhe zhdukje totale.

Sipas parimeve që kemi mësuar nga hadithi i lartpërmendur, t’ia dorëzosh punën një të paafti, tregon qartë për humbjen e mirëbesimit. Kështu që, zhdukja e dijetarëve ka një lidhje të ngushtë me humbjen e amaneteve. Ndërsa mirëbesimi, është emri i përgjithshëm që u vendoset të gjitha vlerave shpirtërore-materiale dhe përgjegjësi. Kjo do të thotë se amaneti është mirëbesimi për shkak të ditorisë. Nëse nuk ka mbetur më dije, do të thotë se ka humbur edhe mirëbesimi. Kurse treguesi i kësaj është se, ata që janë të paaftë kanë marrë përsipër punët e umetit.

SHKAKU KRYESOR

Dorëzimi i punës te ai që është i paaftë ta kryejë, vjen si pasojë e *përhapjes së injorancës* dhe largimit të dijes nga mesi i njerëzve. Normalisht, nuk mund të mendohet se kjo punë do t’u dorëzohej të paaftëve, në

një mjedis ku ka nga ata që njohin thelbin e punës. Por, nëse injoranca është përhapur gjithandej dhe punët janë kthyer së prapthi, punët mbeten tek ai i cili i rrëmben ato; pra, mbeten në dorën e atij që nuk është i aftë t’i kryejë. Në një farë mënyre, kjo do të thotë Kiameti i popujve. Po ta mendonim këtë situatë për Islamin, i cili është një fe hyjnore universale dhe për myslimanët, të cilët janë ithtarët e saj, do të shfaqej një katastrofë e llahtarshme. Siç dihet *dituri*, do të thotë *zgjidhje*. Patjetër që do të ketë një lehtësi në punë, përderisa dija të qëndrojë në këmbë dhe të përparojë. Shkaku kryesor i pazgjidhshmërisë dhe i shkatërrimit, është padituria, po të lëmë në një rëndësi anë faktorët e jashtëm.

Në këtë çështje do të ishte me vend të përmendnim ajetin: “Mos iu qas asaj, për të cilën nuk ke njohuri...”⁴ ose “... dhe për atë që nuk kishin kurrfarë dijeje, flisnit duke menduar se ajo ishte imtësi e parëndësishme...”⁵ Sepse një kuptim i këtyre ajeteve është: “*Mos jep opinionin dhe mendimin tënd pa kurrfarë dije!*”

Imam Shafi’iu kundërshton ata që i kushtojnë rëndësi *analogjisë* ndaj *revelatës (lajmit)* me ajetin: “**Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtronjeni atë te Allahu (te Libri i Tij) dhe te i Dërguari, në qoftë se i besoni Allahut dhe ditës së fundit.**”⁶ dhe mbron mendimin se ai ka këtë kuptim: “*Në raste mosmarrëveshesh kërkoni se çfarë ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe pasojini!*”

Bejhakui transmeton se Ibn Mes’udi, (r.a.), ka thënë: “*Nuk bëhet fjalë se asnjë vit që vjen pas një viti tjetër nuk është më i keq se viti pasardhës. Me këtë nuk dua të them se viti i mëparshëm është më i begatë se viti që vjen pas tij ose udhëheqësi i mëparshëm është më i mirë se ai pasardhësi i tij. Unë po bëj fjalë për asgjësimin e dijetarëve. Saqë puna, më në fund, do t’u mbetet njerëzve, të cilët u paraqesin njerëzve vëzhgimet e tyre personale në çdo çështje dhe si rrjedhojë, Islami do të shkatërrohet.*”⁷

Duhet të theksojmë menjëherë se, *largimi i dijes është zhdukja e dijetarëve*. Kjo situatë përcaktohet qartë në disa transmetime të tjera të hadithit, në të cilat thuhet: “*Asgjësimi i dijetarëve është largimi i dijes.*” Humbja e dijes, raf’u’l-ilm-*largimi i dijes*, paraqitet gjithnjë me dhehabu’l-ulema - largimin e dijetarëve.

Nga ana tjetër, sipar asaj që mësuam nga hadithi i lartpërmendur, në të cilën thuhet: “Punët do t’u lihen në dorë të paaftëve”, është një tregues i qartë për humbjen e mirëbesimit. Pra, ka një lidhje të ngushtë

3. Buhari, l’tisam 7, Muslim, Ilim 14, Ahmed b. Hanbel II, 203. Pë - veç kësaj, për shprehje të ndryshme nga ky hadith shiko Buhari, Ilim 34; Muslim, Ilim 13; Tirmidhi, Ilim 5; Ibn Maxhe, Mukaddime 8; Darimi, Mukaddime 26.

4. Isra, 37.

5. Nur, 15.

6. Nisa, 59.

7. Ibn Haxher, Fethu’l-Bari, XIII, 296.

të zhdukja e dijetarëve me humbjen e amaneteve. Ndërsa mirëbesimi, është emri i përgjithshëm që u vendoset të gjitha vlerave shpirtërore-materiale dhe përgjegjësi. Kjo do të thotë se amaneti është mirëbesimi për shkak të diturisë. Nëse nuk ka mbetur më dije, do të thotë se ka humbur edhe mirëbesimi. Treguesi i kësaj është se, ata që janë të paaftë, kanë marrë përsipër punët e umetit.

Ngritja e njerëzve të aftë, është xhihadi-përpjekja më e madhe në ditët tona dhe përbën kuptimin më të madh e të rëndësishëm për myslimanët.

DIJETARI-INJORANTI

Nga shprehja e hadithit kuptohet se zhdukje e dijetarëve në përgjithësi, nuk do të thotë zhdukje e njerëzve me dije. Por do të thotë zhdukje e dijetarëve që dinë burimet kryesore të fesë, d.m.th. zhdukje e atyre që dinë Kuranin dhe Sunetin, të cilët në fillim u japin zgjidhje problemeve nga këto parime. Ndërsa të paditurit ose injorantët, nuk janë ata që nuk dinë asgjë, por janë ata që nuk dinë mënyrën dhe argumentet fetare për t'u dhënë një zgjidhje fetare problemeve; për këtë shkak japin gjykime sipas kokës së tyre, japin fetva sipas pikëpamjeve të tyre, pa ndierë nevojën për t'u përshtatur me ndonjë parametër shkencor. Shkurtimisht, janë ata të cilët e vendosin veten e tyre, me kuptimin e plotë të fjalës, në vend të Gjykuesit-Shari' dhe që nuk njohin kufi.

Është e ndaluar të nxjerrësh përpara injorantë të tillë, për shkak të dëmeve që do të shkaktojnë nëse u referohesh atyre. Madje, dijetari mëkatar vlerësohet në këtë pikë nga njerëzit e thjeshtë dhe injorantët, të cilët nuk e kalojnë kufirin dhe e preferojnë atë. Sepse ndershmëria dhe devocioni e pengojnë njeriun të flasë nga padituria dhe e shtynjë atë të kontrollojë veten. Ndërsa mëkati, është shenjë dhe rezultat i kokfortësisë.

GJITHNJË E NJËJTA ANKESË

Nga ana tjetër, vihet re shpesh se shumica e dijetarëve shikojnë periudhat e tyre dhe deklarojnë e ankohen se koha e humbjes dhe e shkatërrimit që përmendet në hadith, po bëhet realitet, përballë

mbizotërimit mbi popullin injorant. Shembujt më të përafërt që kanë të bëjnë me këtë çështje, na i jep përkthyesi dhe komentuesi i Texhrid-i Sarih Kamil Miras Allahu e mëshiroftë dhe Ahmed Davudoglu, Allahu e mëshiroftë, i cili ka përkthyer dhe komentuar Sahihun e Muslimit.

Kamil Miras thotë: “Mendoj se ka ardhur koha e daljes nga rruga e drejtë, e cila përmendet në hadith. Sot, artikujt që flasin rreth çështjeve fetare, të cilat kalojnë në vargjet e gazetave, janë në një anarki totale.”⁸

Ndërsa A. Davudoglu, pasi transmeton fjalët e Kadi Ijaz-it dhe ankesat e Shejh Kutbuddin-it në lidhje me kohën e tij dhe veçanërisht fjalët e Ajnit, i cili thotë: “Qytetet kanë mbetur të zbratur prej dijetarëve, ndërsa injorantët kanë kaluar në krye të postit të fetvave dhe të arsimit, në sajë të emërimit. Më në fund, ne lutemi për paqe e shëndet.”

Thotë: “Ejani të shihni kohën tonë. Tashmë këto janë kthyer në modë. Sot u thuhet njerëz fetarë, intelektualë, atyre që japin fetva sipas mendjes së tyre.”⁹

Ne e ndiejmë të nevojshme të mbështesim faktet e këtyre dy dijetarëve, duke shtuar injorancën që transmetohet nga televizioni dhe veçanërisht mendjelehtësinë në çështjet fetare. Vëmë re se populli, madje të gjitha shtresat e tij, kanë nostalgji për islamit dhe duan ta mësojnë atë. Shohim se gjendemi në përpjekjet dhe zhvillimet serioze shkencore.

Kjo është për t'u shpresuar, madje në një farë mase, për t'u gëzuar dhe për më tej, mendojmë se do të na mjaftonte të jepnim përpjekjet tona në aspektin e zhvillimit të kësaj tendence.

Ja pra, edukimi dhe ngritja e njerëzve të aftë, është xhihadi-përpjekja më e madhe në ditët tona dhe përbën kuptimin më të madh e të rëndësishëm për myslimanët. Realizimi i kësaj deri në një farë mase, do të bëjë të mundur që ndodhia e Kiametit të shtyhet. Tani është koha e angazhimit me problemet e islamit dhe të myslimanëve. Pra, është koha t'ia japim punën atij që është i kualifikuar për këtë.

8. Shiko Përkthimi i Texhridi Sarih, XII, 408.

9. Shiko Përkthimi dhe Komentimi i Sahihi Muslim-it, X, 665.



A. Jasin Demirxhi

La Tahzen Mos u dëshpëro

*Shembulli yt le të jetë
Rasulallahu (a.s.), sepse
ai është prijësi, i cili shpie
në lumturi çdokënd që i
bindet. Është udhërrëfyesi,
që çon në shpëtim dhe
sukses.*

La Tahzen Mos u dëshpëro

*Ai që i hedh sytë haramit,
në zemër mbjell veç
hidhërim dhe shqetësim.
I lumtur është ai që i
frikësohet Allahut dhe i
ruan sytë prej haramit.*



Ë fshehta e shprehjes “La ilahe il-lallah”

Formula e Teuhidit është shprehja më e rëndësishme, e cila ndan besimin nga mohimi, njerëzit e lumtur nga të mjerët... Në të njëjtën kohë, **“La ilahe il-lallah”** është një themel, ku janë ndërtuar të gjitha punët e mira e të sinqerta. Ashtu siç është e dënuar të shkatërrohet një ndërtesë pa themel, ashtu edhe një punë, qoftë edhe shumë e rëndësishme, por që nuk është ndërtuar mbi atë themel, është e dënuar të shkatërrohet ose, siç shprehet edhe Kurani, **“hebaen mensura”**, pra të kthehet në pluhur që e merr era.

“La ilahe il-lallah”, do të thotë: “Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”.

Po çfarë kuptimi tjetër ka kjo shprehje?

Të thuash **“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”**, do të thotë:

Një ditë, herët a vonë, drejtësia dhe e vërteta, do të vijnë në mënyrë absolute...

Do të thotë mëshirë, do të thotë falje...

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Që lotët të mos rrjedhin kot, durimi, e mira dhe e keqja të mos ngelen pa shpërblim dhe vrasja e gjynahu të mos ngelen pa dënim...

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Të eliminohen shqetësimet dhe të garantohet se e drejta do t'i jepet të zotit. Do të thotë që zemrat të arrijnë kënaqësinë, nefset (egot) qetësinë dhe shpirtrat paqen...

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Që këtë botë nuk e drejton koprraci, por Bujari, më Bujari...

Të marrë atë që ka dhënë, nuk është në natyrën e Bujarisë. Allahu Teala, i Cili na ka falur jetën, nuk na e merr atë me anë të vdekjes. Vdekja kurrë nuk është marrja e jetës që na është falur. Përkundrazi, vdekja është një falje e një jete të re e të bukur për ata që thonë ashtu siç duhet **“La ilahe il-lallah”**.

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Në gjithësi nuk ka asnjë të metë dhe në mesin e krijesave, nuk ka asgjë të kotë...

Do të thotë se në çdo gjë ka një urtësi... Do të thotë se pas çdo ndodhie ka një urtësi... Do të thotë se në çdo krijesë ka një urtësi... Do të thotë se pas çdo dhimbjeje, hidhërimi, sëmundjeje, dëshpërimi, dobësie e fuqie, ka gjithmonë një urtësi.

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Që të gjitha hidhërimet, hallet, vështirësitë, të metat dhe gabimet tona të shkrihen në mëshirën e pafundme të Rrahmanit...

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

E gjithë fuqia dhe forca është në dorë të Tij... Do të thotë se njohuria e pafundme e të gjitha diturive është tek Ai... Do të thotë se të gjitha dëshirat dhe kërkesat tona janë në dorën e Tij...

“Përveç Allahut nuk ka zot tjetër”, do të thotë:

Nuk ka ikje prej Tij, përkundrazi, ikjet janë për tek Ai...

Do të thotë se Ai është vendstrehimi i të gjithë robërve...

Do të thotë se Ai është dera e vetme e lutjes dhe përgjërimit për vështirësitë, hallet dhe hidhërimet tona...

Shkurt, thënia me sinqeritet e **“La ilahe il-lallah”**, në veçanti për besimtarin, të cilit i është ngushtuar shpirti, do të thotë:

Shoqërim me Atë... Do të thotë shpëtim... Do të thotë garanci paqeje dhe lumturie në të dyja botët...



Dy fytyrat e vdekjes

Ali Riza Temel

Shkrimtari i famshëm rus, Tolstoi po përpëlitej në depresion. Atë e kishte kapur një sëmundje e rëndë dhe po përjetonte dhimbje të mëdha. Filloi të mendonte: “A t’i jap fund jetës sime me një plumb apo me një lak?!” Veten e tij ia përngjasonte një udhëtari në mesin e shkretëtirës:

Udhëtari hidhet në një pus pa ujë për të shpëtuar nga një kafshë e egër, e cila i kishte dalë përpara. Pikërisht në ato momente, në fund të pusit shikon një kuçedër, që e priste me gojën hapur. Ky udhëtar i shkretë nuk guxonte të dilte sipër sepse mund ta copëtonte kafsha e egër, por as poshtë nuk zbriste dot, sepse e hante kuçedra. Kështu që u kap fort te një degë që kishte dalë ndërmjet gurëve të murit të pusit. Pas pak, duart fillojnë t’i mpihen dhe ai e kupton se do të jetë i detyruar të bjerë në tragjedinë që e pret në njërin nga dy anët, por prapëseprapë mbahet fort. Në ato momente shikon disa minj që silleshin rreth degës ku ishte mbajtur dhe po e brenin atë. Dega do të këputet dhe ai do të bjerë në gojën e kuçedrës. Atëherë, udhëtari e kupton se tashmë nuk i ka mbetur më asnjë mundësi për të shpëtuar. Ndërkohë që sheh rreth e rrotull i dëshpëruar, vë re se nga gjethet e degës po del mjaltë. Ai e nxjerr gjuhën dhe fillon ta lëpijë.

Faktikisht, kjo është një përrallë e lindjes. Tolstoi thotë:

“Edhe unë i ngaj këtij udhëtari. Edhe pse e dija se vdekja po më priste në mënyrë absolute dhe se kuçedra ishte e gatshme të më copëtonte, kapesha te degët e jetës me një shpresë të fundit, edhe pse nuk e kuptoja pse kapesha te ato. Përpiqesha të lëpija mjaltin, i cili më kishte ngushëlluar deri atë ditë, por tashmë edhe atij nuk i kishte mbetur më shije. Ndërkohë që kuçedra e vdekjes e kishte hapur gojën dhe po priste të më gëlltiste, minjtë brenin degën e jetës në të cilën isha kapur. Ndërsa unë shikoja vetëm

kuçedrën dhe minjtë prej të cilëve nuk ikja dot. Sytë nuk i ndaja prej tyre. Mbi të gjitha, ky nuk ishte një shembull, por vetë e vërteta.”

Për ata që nuk i besojnë Allahut dhe Ditës së Gjykimit, vdekja është realiteti më i tmerrshëm. Ajo pothuajse është si një vrimë e zezë. Si perëndimi i diellit për të mos lindur kurrë më. Pothuajse është një vend ekzekutimi që shihet çdo moment. Është burimi i dhimbjes që i shkatërron dëshirat, shpresat dhe pasionet.

Ndërsa për besimtarin, vdekja është një dritare e hapur ndaj pavdekshmërisë dhe jetës së përherëshme. Është momenti i takimit me të dashurin. Sipas Mevlanës, është shebi arus (nata e dasmës). Është kthim te atdheu i vërtetë dhe përfundim i kurbetit. Është shpëtim i shpirtit nga burgu i trupit. Është dalje e zogut nga kafazi. Të dënuarit vetëm gëzohen nga shkatërrimi i burgut. Ata nuk thonë:

“Ah sa keq që u prish ndërtesa.” Të gjithë festojnë, përveç atij të dënuarit që do të çohet për t’u ekzekutuar. Shpirti shpëton nga zënka e trupit dhe fillon të fluturojë me flatrat e zemrës. Mevlana e përshkruan kështu këtë gjendje:

“Kjo gjendje është si ëndrra e atij që e kanë burgosur në errësirën e burgut, por në gjumë e sheh veten si të jetë në bahçe me trëndafila. Ky njeri thotë: ‘O Zot! Mos më kthe te trupi im, që të shëtis në këtë bahçe me trëndafila. Tashmë, a dëshiron ai njeri të zgjohet dhe të jetojë i lidhur me zinxhirë e me pranga në fund të pusit?’

Vdekja është shpëtim nga kafazi i trupit dhe dalje nga pusi si Jusufi (a.s.). Vdekja, që kafirit i duket si gijotinë, për besimtarin është një derë që hapet ndaj pavdekshmërisë. Mevlana e tregon kështu gëzimin e vdekjes:

“Aq sa gëzohet zogu kur e lë kafazin dhe fluturon, po aq gëzohem edhe unë kur të vdes dhe të largohem nga trupi. Zogu në kafaz i vendosur në bahçe, i shikon trëndafilat dhe pemët. Zogjtë që cicërojnë rreth e rrotull jashtë kafazit, këndojnë këngë të bukura për lirinë. Zogu në kafaz i dëgjon ata dhe e sheh gjelbërimin. Pastaj nuk ka as oreks, as durim dhe as vendosmëri. E nxjerr kokën në çdo vrimë të kafazit dhe dëshiron të shpëtojë nga ai burg. Ai zog e ka zemrën dhe shpirtin jashtë. Çfarë do të bënte në këtë gjendje, nëse ia hapim derën kafazit?”

Edhe gjendjen e jobesimtarit Mevlana e ka përngjarrë me gjendjen e një zogu në kafaz të rrethuar nga macet dhe thotë:

“Ky lloj zogu është i tmerruar nga frika. Ai kurrë nuk dëshiron të dalë nga ai kafaz. Madje, për shkak të së keqes që e pret, dëshiron të ketë edhe njëqind kafaze të tjera.”

Gjendja e jobesimtarit është si gjendja e fëmijës në barkun e nënës. Mirësia e Zotit e tërheq për të dalë jashtë, ndërsa ai përsëri ikën drejt mitrës. Edhe fëmija në bark të nënës nuk e di se jashtë mitrës ka një botë të madhe. Nuk e di se mirësitë në mitër janë nga begatia e botës së jashtme. Edhe uji dhe ushqimi në kafaz vijnë nga bota e jashtme. Zogu i trembur nga macet, shndërrohet në një mi që kërkon vrimë për t’u fshehur. Prandaj, shpirti i tij e ka bërë vatan vrimën e kësaj bote, sepse e ka prerë shpresën për të dalë jashtë. Por e vërteta është kjo: Sado që zogu të mbrohet, në fund nuk do të shpëtojë nga kthetrat e vdekjes.

Burimi i çdo lloj frike është frika e vdekjes. I sëmuri me kancer frikësohet më shumë nga vdekja se sa nga sëmundja, sepse kanceri sjell vdekjen. Heroizmi më i madh është mposhtja e frikës së vdekjes apo siç shprehet Ikbali: “Ta presësh vdekjen duke i buzëqeshur.” Dallimi më i rëndësishëm që e ndan besimtarin nga femohuesi është sjellja kundrejt vdekjes.

Besimi e kthen mosekzistencën në ekzistencë. Sa bukur ka thënë Junusi:

“Përse ke frikë nga vdekja?

Mos ki frikë dhe do të jesh i përhershëm.”

Tolstoi, që përjetoi gjithë këto vështirësi, më në fund shpëtoi nga fobia e tmerrshme e vdekjes në sajë të besimit dhe arriti të vërtetën e përhershme, që nuk mund ta vrasë as vdekja. Le ta dëgjojmë nga vetë ai se si e ka arritur këtë të vërtetë:

“Më së fundi, e hetova veten time dhe pashë se çfarë po ndodhte brenda meje. M’u kujtuan me qindra ngjarje rreth vdekjes dhe ringjalljes. Pashë se unë jetoja vetëm kur i besoja Zotit. Ndërsa kur e harroja Atë, apo kur nuk e besoja, zhdukej edhe jeta. Kur hu-

mbisja besimin ndaj ekzistencës së Zotit, pothuajse këputeshin edhe lidhjet e mia me jetën. Sikur të mos kisha pasur qoftë edhe pak shpresë për të gjetur Zotin, do të kisha bërë vetëvrasje që kohë më parë. Por po jetoja. Po jetoja kur e ndjeja dhe e kërkoja Atë. Atëherë, Ai ekziston. Ai është një genie, pa të Cilin nuk jetohet. Njohja e Zotit dhe zbatimi i urdhrave të tij, është diçka unike dhe e veçantë. Zoti është jetë. Përderisa jetoj duke e kërkuar Zotin, jeta pa Të është e pamundur.”

“Besimi i jep kuptimin e pafundësisë ekzistencës së vdekshme të njeriut. Domethënë, një kuptim që nuk zhduket nga vuajtjet, sakrificat dhe vdekja. Kjo do të thotë se kuptimi dhe mundësia e jetës mund të gjendet vetëm te besimi. Besimi është forca e jetës. Pa besim nuk jetohet.”

Tolstoi, në librin e tij me titull Ivan Iljiç, përshkruan gjendjen e dhimbshme të një njeriu që përpëlitej në dhimbje të padurueshme, që kishte frikë nga vdekja, që nuk e pranonte dot gjendjen e tij duke kundërshtuar Zotin, që nuk gjente rrugë përtej vdekjes dhe që po dirgjej. Ivan Iljiçi filloi të qante si fëmijë. Po qante për vetminë e tmerrshme dhe thoshte:

“Përse më bëre kështu? Përse më solle në këtë gjendje? Çfarë kam bërë unë? Çfarë kam bërë që po vuaj kaq shumë? Ç’është ky zemërim? Ç’nevojë kisha për këtë?”

Me këto shprehje ai po kundërshtonte Zotin, që pa ndehte se nuk e besonte. Faktikisht edhe kundërshtimi është shprehi e besimit, sepse njeriu nuk mund kundërshtojë një genie që nuk e beson. Edhe Ivan Iljiçi, që përpëlitej nga dhimbjet dhe frika, më në fund e kuptoi të vërtetën. Në vetvete thoshte:

“Vdekja iku. Tashmë ajo nuk është më.” Tashmë, në vend të vdekjes kishte dritë. Vdekja kishte vdekur, zhdukja ishte zhdukur dhe kishte ardhur ekzistenca e përhershme.

Sikur të mos ishte ekzistenca e përhershme, të gjitha krijesat nuk do të ekzistonin. Të përkohshmit vijnë nga përhershmeria. Mevlana shprehet:

“Nëse nuk ekziston bota tjetër, atëherë, nga vijnë ata që vijnë dhe ku shkojnë ata që shkojnë?”

Le ta përfundojmë artikullin tonë me këtë strofë të një poeti:

“Vdekja nuk është as larg dhe as afër,

Çfarë mund të na bëjë vdekja, përderisa kemi arritur përhershmerinë?”



Feja është

Në hadithin fisnik thuhet:

“Feja është këshillë, sinqeritet dhe dëlirësi.” I Dërguari i Allahut, (a.s.), e përsëriti tri herë këtë fjali. I thamë:

“O i Dërguari i Allahut! Ndaj kujt duhet sinqeriteti?”

Pejgamberi, (a.s.), u përgjigj:

“Ndaj Allahut, të Dërguarit të Tij, Librit të Tij, udhëheqësit të myslimanëve dhe ndaj të gjithë popullit.” (Buhari)

Sinqeriteti ndaj Allahut Teala është sinqeriteti në besimin, adhurimin dhe bindjen e plotë ndaj një-simit të Tij. Sinqeriteti ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është vërtetimi i shpalljes dhe profetësisë së tij, pranimi i shariatit të tij dhe bindja ndaj urdhrave dhe ndalesave të tij. Sinqeriteti ndaj Librit të Tij është pranimi i Kuranit Fisnik dhe veprimi sipas tij. Sinqeriteti ndaj prijësve myslimanë, domethënë, ndaj kryetarëve të shtetit është bindja ndaj urdhrave të tyre të ligjshëm. Ndërsa sinqeriteti ndaj të gjithë popullit është udhëzimi i të gjithë njerëzve në rrugën e drejtë dhe në mirësi.

Ebu Musa el-Esh’ariu, (r.a.), transmeton:

Një burrë erdhi te i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Ka prej burrave që pëpiqen për pasuri. Ka prej burrave që pëpiqen për famë. Ka prej burrave që pëpiqen për t’u parë, domethënë për t’u shtirur. Cilët prej këtyre janë në rrugë të Allahut?”

Pejgamberi, (a.s.), i tha:

“Kush pëpiqet për të lartësuar vetëm fjalën e Allahut, është në rrugën e Tij.” (Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi.)

Ebu Hurerja, (r.a.), transmeton se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, (a.s.), duke thënë:

“Njerëzit e parë, kundër të cilëve do të gjykohet në Ditën e Kiametit janë:

1. Ai që ka rënë dëshmor. Ai do të sillet në audiencën e Allahut Teala. Allahu i tregon mirësitë që i ka dhënë dhe ai i pohon ato.

Allahu Teala i thotë:

-Atëherë, çfarë ke bërë me to? Dëshmori përgjigjet:

-Kam rënë dëshmor në rrugën Tënde.

Allahu Teala i thotë:

-Gënjeve. Ti ke luftuar vetëm që të të thonë “trim dhe guximtar” dhe me të vërtetë për ty thanë një gjë



Etë këshillë

të tillë. Jepet urdhri për të dhe zvarritet me fytyrë për tokë, derisa të hidhet në xhehenem.

2. Ai që ka mësuar dije, ua ka mësuar të tjerëve dhe që ka lexuar Kuran. Ai sillet në audiencën e Allahut Teala. Allahu i tregon mirësitë që i ka dhënë dhe ai i pohon ato.

Allahu Teala i thotë:

-Atëherë, çfarë ke bërë me to? Ai përgjigjet:

-Kam mësuar dije, ua kam mësuar atë edhe të tjerëve dhe kam lexuar Kuran për hir të kënaqësisë Tënde.

Allahu Teala i thotë:

-Gënjeve. Ti ke mësuar dije që të të thoshin dijetar. Ke lexuar Kuran që të të thoshin lexues Kurani dhe me të vërtetë të thanë. Jepet urdhri për të dhe zvarritet me fytyrë për tokë, derisa të hidhet në xhehenem.

3. Ai që Allahu i Madhëruar i ka dhënë shumë mirësi dhe nga çdo lloj i pasurisë. Ai sillet në audiencën e Allahut Teala. Allahu i tregon mirësitë që i ka dhënë dhe ai i pohon ato.

Allahu Teala i thotë:

-Atëherë, çfarë ke bërë me to? Ai përgjigjet:

-Nuk kam lënë asnjë lloj mënyrë që ke urdhëruar pa dhënë nga pasuria ime për hir të kënaqësisë Tënde. Të gjithë pasurinë time e kam dhënë në rrugën Tënde.

Allahu Teala i thotë:

-Gënjeve. Ti ke dhënë vetëm që të të thoshin bujar. Me të vërtetë thanë ashtu. Pastaj jepet urdhri për të dhe zvarritet me fytyrë për tokë, derisa të hidhet në xhehenem. (Buhari)

“Kush përpiqet duke mos synuar gjë tjetër përveçse arritjes së një përfitimi të vogël, qoftë edhe sa lidhësja e këmbës së devesë, domethënë, duke menduar për çfarëdo lloj përfitimi material, pjesa e tij është vetëm ajo të cilën ka synuar. Ai nuk merr asnjë sevap nga Allahu Teala.” (Ahmed bin Hanbel)

“Njerëzit do të ringjallen vetëm sipas qëllimeve të tyre. Domethënë, ngrihen nga varret.” (Ibn Maxhe)

“Kush udhëzon për një mirësi, merr shpërblim sa ai që e ka bërë.” (Ahmed bin Hanbel)

“Pa hisbe nuk ka shpërblim dhe sevap. Edhe vepra pa qëllim është e papranueshme.” (Dejlemi)

Hisbe do të thotë të mos presësh asnjë vlerësim apo shpërblim nga njerëzit për mirësitë e bëra. Ta kryesh detyrën, ngaqë është detyrë dhe ta bësh me qëllim që të fitosh kënaqësinë e Allahut Teala.



CILËSITË E NJË EDUKUESI

NË KËRKIM TË MUNDËSIVE

Besimtari vazhdimisht duhet të jetë në kërkim të gjërave të cilat mundësojnë fitimin e kënaqësisë së Allahut (xh.sh.). Sepse në një ajet kuranor thuhet: **“E kur ta kryesh (obligimin), atëbotë mundohu me adhurim. Dhe vetëm te Zoti yt përqendro synimin!”** (Inshirah, 7-8)

Çfarë kuptojmë nga kjo? Zemra duhet të kërkojë vazhdimisht, në mënyrë që mundësia t’i dalë përpara. Kur i pyes disa mësues: “Sa nxënës keni?” Përgjigjen: “Nuk vjen asnjëri. Çfarë të bëj?” “Nëse i kërkon, do t’i gjesh. Zoti i madhëruar t’i krijon mundësitë sipas qëllimit tënd.”

Besimtari duhet të jetë në kërkim të vazhdueshëm të mundësive. Nëse i kërkon, Zoti do t’ia nxjerrë përpara. Por ata të cilët janë të pakujdesshëm ndaj ndjeshmërisë së shërbimit do të qëndrojnë si të tillë, edhe nëse para tyre radhiten mundësi të panumërta.

KRIJIMI I PERSONALITETIT

Shoqëritë gjithnjë kërkojnë personin për të cilin kanë nevojë. Edhe njerëzit me karakter të dobët mahnitën përballë njerëzve të mirë dhe me personalitet të fortë. I gjithë populli i Mekes e aprovonte moralin, drejtësinë, besnikërinë e Profetit (a.s.). Edhe i Dërguari i Allahut tregonte si argument jetën e tij shembullore kur dëshironte të bindte personin përballë në pranimin e Islamit. Ai hipi mbi kodrën Safa dhe u bëri thirrje kurejshëve:

‘O populli i kurejshëve! A më besoni nëse do t’ju thosha se pas këtij mali qëndrojnë armiqtë me kuajt e tyre dhe kërkojnë t’ju sulmojnë e t’ju marrin pa-

surinë? - i pyeti Profeti (a.s.).

-Po, të besojmë, sepse deri sot ke thënë vetëm të vërtetën. Nuk të kemi dëgjuar ndonjëherë duke gënjyer - iu përgjigjën ata pa u menduar fare.

Profeti (a.s.), pikë së pari vërtetoi personalitetin dhe karakterin e tij. Pas këtij vërtetimi dhe shpalljeje e shpalli veten si një profet të dërguar nga Zoti i madhëruar si paralajmërues. Pataj u bëri të qartë se ata që besojnë do të shpërblehen me Xhenet kurse mohuesit dhe refuzuesit i priste një dënim i tmerrshëm në botën tjetër. Por nuk ishte e lehtë të ndryshoje besimin e njerëzve. (Buhari, Tefsir, 26\2, Ahmed, I, 159, 111.)

Në ajetin 33 të sures En’am Zoti i madhëruar urdhëron: **Ne e dimë se ty të zemëron ajo që thonë ata. Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e Allahut.**

Edhe armiqtë më të betuar të Profetit (a.s.), e kanë pranuar se ai është një personalitet i besueshëm dhe i sigurt. Cilësia më e rëndësishme e një mësuesi është të zotërojë një karakter të denjë për profesionin e tij. Sepse njerëzit gjithmonë magjepsen pas personalitetit të fortë dhe mirësisë.

Edukuesi duhet të pasqyrojë një personalitet magjepsës, mahnitës për të tjerët.

Në mesin e rrëmujës së krijuar në luftën e Uhudit papritmas u përhap lajmi se Profeti (a.s.), kishte rënë dëshmor. Por jobsimtarët akoma nuk ishin të sigurt për vërtetësinë e lajmit të përhapur. Komandanti i ushtrisë armike, Ebu Sufjani i thirri Omerit: “Omer, ti e di se të besoj më shumë se burrave të mi. Po thonë se Muhamedi ka vdekur, a është e vërtetë?”



Pra një jobesimtar, i cili po luftonte myslimanët, i besonte më shumë një myslimani sesa njerëzve të tij. Gazi Osman qëndroi 6 muaj i rrethuar në një kala në Plevën dhe nuk u dorëzua. Ai doli nga kalaja nga një çarje por e zunë rob.

“Unë kam mbledhur xhizje (taksa) nga populli i krishterë për t’i mbrojtur ata. Por tani më kanë zënë rob. Nuk kam mundësi t’i mbroj më. Për këtë arsye le të vijmë ata që kanë paguar taksat, në mënyrë që t’ua kthejë mbrapsht”- tha Gazi Osman

Komandanti rus u çudit përballë personalitetit të rrallë të Gazi Osmanit dhe ia ktheu shpatën e tij. Ja pra personaliteti i vërtetë islam, i drejtë, i besueshëm, i sigurt. Edhe atëherë kur dorëzohen respektojnë të drejtat e të tjerëve.

KRITERI I PËRSOSMËRISË, MIRËSISË DHE HIJESHISË

Një besimtar i stolisur me moralin islam duhet të përkëdhelë shpirtin me aromën e tij të këndshme sikur të ishte një lule e sapoçelë. Çdo fjalë e tij duhet të jetë ushqim për shpirtin. Të mos e kursejë buzëqeshjen por të pasqyrojë mëshirë me ëmbëlsinë e gjuhës. Personaliteti dhe sjelljet e tij duhet të jenë në masën ekmel, exhmel, ahsen.

Ahsen - të bësh punën në formën më të bukur, të pasqyrosh gjithmonë mirësi.

Exhmel- shpirti të të dhurojë qetësi e freski, plot hijeshi e delikatesë.

Ekmel - të jetë shumë i matur, i pjekur, i mrekullueshëm dhe i përkryer.

Çdo vepër dhe punë e myslimanëve të tillë idealistë do të pasqyrojë fytyrën e qeshur të Islamit, estetikën, madhështinë dhe bukurinë e tij. Ashtu siç transmetohet sipas burimeve: në fytyrën e Profetit (a.s.), rrezatohej një dritë vezulluese, në fjalët

rrjedhshmëri, në lëvizjet hijeshi, në gjuhë oratori, në fjalë përsosmëri dhe në deklarimin e tij një fjalor të mrekullueshëm. E folura e tij ishte jashtëzakonisht e ëmbël dhe ledhatuese, nuk nxirrte as pak e as fjalë të tepërta. Fliste qartë dhe një nga një, çdo fjali kuptohej qartë nga të pranishmit. Nuk i radhiste fjalët me pakujdesi, nëse i duhej të fliste shpejt.

Ai (a.s.), ishte folësi më i qartë, i urtë në mesin e njerëzve, shprehte qartë dhe drejt fjalët e tij. Ebu Kursafe shprehet kështu: “Kur u ndamë me Profetin (a.s.), pasi dhamë besën nëna dhe tezja më thanë :

-Nuk kemi parë ndonjëherë njeri të tillë. Nuk kemi parë njeri me fytyrë më të bukur, roba më të pastra dhe më të butë se ai. Dukej sikur rrezatonte dritë nga goja e tij.” (Hejsemi, VIII, 279-280)

Nga goja e një mësuesi duhet të dalin fjalët si margaritarë. T’i dhurojë personit përballë freskinë e rrjedhshmërisë së ujit. Fjalët e rënda dhe veprat e pahijshme janë një nga dobësitë më të mëdha të një mësuesi.

BUZËQESHJA

Besimtari vazhdimisht duhet të jetë i buzëqeshur përballë njerëzve. Ëmbëlsia e besimit duhet t’i pasqyrohet në fytyrë. Ata që shohin fytyrën e tij duhet të shohin fytyrën e qeshur të Islamit.

Ummu Derda thotë: “Ebu Derda gjithmonë buzëqeshte kur fliste një fjalë. Një ditë i thashë:

-Kam frikë se njerëzit do të të paragjykojnë. ‘I Dërguarit i Allahut gjithmonë buzëqeshte pasi fliste diçka’, u përgjigj ai.” (Ahmed, V, 198,199.)

Mësuesit nuk duhet të jenë me turinj të varur. Njeriu mëson më lehtë dhe më mirë kur buzëqesh, sesa kur i var turinjtë. Qëndrimi vazhdimisht serioz e lodh mendjen dhe ngrin të menduarin. Shakatë e

*Mësuesit
nuk duhet të jenë me turinj të
varur. Njeriu mëson më lehtë
dhe më mirë kur buzëqesh,
sesa kur i var turinjtë.
Qëndrimi vazhdimisht serioz
e lodh mendjen dhe ngrin të
menduarin. Shakatë e bëra herë
pas here e freskojnë
mendjen dhe forcojnë
përqendrimin.*

bëra herë pas here e freskojnë mendjen dhe forcojnë përqendrimitin.

TË FITOSH ME BUJARI

Njeriu është i etur për mirësi. Një njeri të cilit i bën mirë, kthehet në mik, edhe nëse më parë e ke pasur armik.

Xhabir (r.a.), thotë: “Nuk është parë ndonjëherë që t’i kërkohet diçka Profetit (a.s.) dhe ai të thotë jo.” Ndërsa Sufjan Ibn Ujejne thotë: “Kur nuk i gjendej diçka pranë vetes, i premtonte se do t’ia jepte kur të kishte.” (Darimi , Mukaddime, 12.)

Bujaria, një nga cilësitë më të dashura të Allahut e shtyn njeriun drejt modestisë, dhembshurisë e shërbimit. E kundërta e saj koprracia, e shtyn njeriun drejt mungesës së mëshirës, mendjemadhësisë dhe foddullëkut.

BESUESHMËRIA

Njeriu bëhet besimtar me ndihmën e besimit të tij. Kuptimi hyjnor i njërit nga 99 emrat e Allahut, Mumin, është sjellja e dritës dhe besimit në shpirta, Mbrojtës i atyre që strehohen pranë Tij, i Besueshëm. Duke ua dhuruar këtë emër besimtarëve Zoti i madhëruar u ka dhuruar cilësi të denja për të. Sipas transmetimit të Ebu Hurejres, Profeti (a.s.), ka thënë: “Për Zotin nuk ka besuar! Për Zotin nuk ka besuar! Për Zotin nuk ka besuar!”

-Kush nuk ka besuar, o i Dërguari i Allahut? - e pyetën sahabët.

- Ai i cili nuk është i sigurt nga të këqijat e fqinjët të tij - iu përgjigj Profeti (a.s.).” (Buhari, Edeb, 29, Muslim, Imman, 73, Tirmidhi, kijamet, 60.)

Jeta e Profetit (a.s.), është e mbushur me shembuj pafund në lidhje me domosdoshmërinë e besueshmërisë të personalitetit islam. Edhe kur u çlirua Meka me anë të rrugës së paqes u falën të gjithë personat të cilët kishin ushqyer urrejtje ndaj myslimanëve dhe nga Meka nuk u mor asnjë plaçkë. (Ebu Davud, Haraxh, 24-25\3023.)

Profeti (a.s.), mori borxh para dhe pajisje luftarake nga të pasurit e Mekës për të përballuar nevojat e domosdoshme të ushtrisë myslimane të përbërë nga 10 mijë persona e që udhëtonte për ditë të tëra. Më pas këtë borxh e pagoi me anë të plaçkave të Hevazinit, duke thënë “borxhi kthehet me falënderim dhe pagesë.” (Vakidi, II, 863, Ebu Davud, Buyu, 88\3562, Muvatta, Nikah, 44.)

Çdo komandant i cili mund të ishte në vendin e Profetit (a.s.), do të dënonte dhe t’u merrte mallrat atyre personave që u kishin bërë keq. Por Profeti (a.s.), nuk e bëri këtë, megjithëse ushtria myslimane ndodhej në vështirësi të mëdha dhe krahas kësaj mori borxh nga të pasurit e qytetit.

Ndërkohë që personave të tjerë u jepej dy muaj

kohë për të menduar rreth pranimit apo jo të Islamit, Profeti (a.s.), i dha katër muaj kohë Safvan bin Ummejes, njërit nga më të pasurit e Mekes. Ai e pyeti:

- Safvan! A ke armë?

- Si borxh apo plaçkë?- e pyeti Safvan.

- Jo si plaçkë, po ta kërkoj si borxh - iu përgjigj Profeti (a.s.).

Pas kësaj Safvan i dhuroi 30-40 mburoja borxh. I Dërguari i Allahut (a.s.), u bë gati për luftën e Hunejnit. Kur jobesimtarët humbën, u mbloodhën mburojat e Safvanit, por disa prej tyre kishin humbur.

- Një pjesë të mburojave e kemi humbur, a mund të paguajmë për to? - e pyeti Profeti (a.s.).

- Jo, o i Dërguari i Allahut, sot zemra më është mbushur me ndjenja të cilat nuk i kam provuar ndonjëherë - iu përgjigj ai. Safvan i kishte dhënë mburojat borxh në kohën kur nuk kishte qenë mysliman, por më pas u kthye në mysliman. (Ebu Davud, Buju, 88\3563.)

Një ditë kur Profeti (a.s.), po merrte abdest, sahabët e nderuar morën ujën e përdorur nga ai dhe filluan të fërkonin fytyrën dhe sytë.

- Pse po veproni kështu? - i pyeti Profeti (a.s.), sahabët.

- Për shkak të dashurisë që ndiejmë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij- u përgjigjën.

Pas kësaj përgjigjeje Profeti (a.s.), tha: “Ai njeri i cili dëshiron të dojë Allahun dhe të Dërguarin e Tij apo dëshiron që Zoti dhe i Dërguarit ta duan atë:

Le të flasë drejtë.

Le të ruajë porosinë (amanetin) kur i besohet në mënyrën më të mirë, mos të çojë dëm besimin e njerëzve të tjerë.

Le të bëhet një komshi i mirë për fqinjët e tij. (Bejhaki, Shuab, II, 201, Tebrizi, Mishkat , III, 81.)

Ebu Rafi (r.a.), thotë: “Kurejshët më dërguan si përfaqësues pranë Profetit (a.s.). Kur e pashë atë, m’u ngjall dëshira për të pranuar Islamin.

-O i Dërguari i Allahut! Unë nuk do të kthehem më kurrë pranë kurejshëve - i thashë.

- Unë nuk e prish marrëveshjen dhe nuk mund të mbaj delegatët e dërguar. Ti tani kthehu pranë kurejshëve. Nëse kjo ndjenjë që ke në zemër (dëshira për të pranuar Islamin) vazhdon të jetojë në të, atëherë kthehu përsëri këtu - iu drejtua Profeti (a.s.). Pas kësaj u ktheva në Meke. Kur mbarova detyrën time si përfaqësues, u ktheva pranë Profetit (a.s.) dhe pranova Islamin.” (Ebu Davud, Xhihad, 151\2758.)

Besueshmëria është shenjë dalluese e personalitetit islam.

UMMETI MESATAR DHE CILËSIA E DËSHMITARIT

I Dërguari i Allahut thotë: Nuhu dhe populli i tij

do të vijnë Ditën e Kiametit.

- A e transmetove fenë tënde? - e pyet Zoti i madhëruar Nuhun (a.s.).

- Po, Zoti im e transmetova - i përgjigjet Nuhu (a.s.). Më pas Zoti i madhëruar do t'i drejtohet popullit të Nuhut:

- A ua transmetoi fenë e drejtë Nuhu (a.s.)?

- Jo, tek ne nuk ka ardhur asnjë profet - do t'i përgjigjen ata. Pas kësaj, Zoti i madhëruar do t'i drejtohet Nuhut (a.s.): Kush do të dëshmojë për drejtësinë tënde?

- Do të dëshmojë Muhamedi (a.s.) dhe populli i tij - do të përgjigjet Nuhu (a.s.). Edhe ata do të dëshmojnë për të.

Transmetuesi i hadithit ka bërë edhe këtë shtesë: Në një ajet kuranor bëhet e ditur se Muhamedi bashkë me umetin e tij do të jenë dëshmitarë të profetëve dhe popujve të tjerë: **“Ne ju bëmë juve një popull të drejtë për të qenë dëshmitarë ndaj njerëzve dhe për të qenë i Dërguari dëshmitar ndaj jush.”** (Bekare, 143) (Buhari, Tefsir 2\13, Enbija, 3, Tirmidhi, 2\2965.)

Me anë të këtij ajeti Zoti i madhëruar na tregon se na ka bërë dëshmitarë të gjithë njerëzimit.

Pra duke pasqyruar Kuranin dhe Sunetin në çdo faqe të jetës sonë, ne si besimtarë duhet të jetojmë me një shpirt i cili përfaqëson Islamin dhe të bëhemi të denjë për të qenë dëshmitarë të Zotit të madhëruar në tokë. Le të përfaqësojmë personalitetin islam në formën më të bukur, në mënyrë që Ditën e Kiametit, Profeti (a.s.), të dëshmojë dhe ndërhyjë për ne. Ata që na shohin, duhet të shohin fytyrën e qeshur të Islamit. Ata që shohin adhurimet dhe veprat tona duhet të shohin mirësitë e Islamit. Një dëshmi të tillë kërkon Zoti i madhëruar nga ne. Kërkon që t'ia pasqyrojmë gjithë botës personalitetin tonë islam. Sahabët e nderuar kanë transmetuar bukuritë e Islamit në çdo vend ku kanë shkuar. E mbartën Islamin në kontinente të ndryshme.

Në Kosovë shkoi populli i pastër i Anadollit. Pasqyruan bukuritë e Islamit me anë të jetës së tyre. 90% e shqiptarëve e pranuan Islamin. Fatih Sulltan Mehmeti çliroi Bosnjën. Përsëri njerëzit e thjeshtë të Anadollit shkuan atje dhe përfaqësuan Islamin. Të gjithë boshnjakët u bënë myslimanë.

Sa bukur e thotë hz. Mevlana: “Ai i cili këshillon me vepra është më i mirë se ai që këshillon me fjalë.”

AFTËSITË

Në një ajet kuranor thuhet: **“Allahu ju urdhëron t’ua ktheni amanetet të zotëve të tyre.”** (Nisa, 58)

Profeti (a.s.), i ngarkonte sahabët sipas aftësive duke i nxitur të shpalosnin aftësitë e tyre më të mira.

Nëse nuk tregohemi të kujdesshëm ndaj aftësive, lisi do mbetet një filiz i vogël i parritur.

Në të kundërt të kësaj, nëse personave të paaftë u jepen detyra më të mëdha nga ç’mund të mbajnë, atëherë kjo do të ishte një lloj dhune e shtypjeje për njerëzit. Për këtë arsye, Profeti (a.s.), u jepte detyra të tjera komandantëve të ushtrisë, detyra të tjera prefektëve e të tjera punë transmetuesve të fesë.

Enesi (r.a.), thotë: “Erdhi populli i Jemenit dhe iu drejtua Profetit (a.s.):

-Dërgo një person bashkë me ne, në mënyrë që të na mësojë Islamin dhe Sunetin. Pas këtyre fjalëve, Profeti (a.s.), kapi për dore Ebu Ubejde bin Xherrahun (r.a.), dhe tha: ‘Ky është njeriu më i besuar i ume-tit tim.’ Dhe kështu e nisi bashkë me jemenasit.” (Muslim, Fedailus-sahabe, 54, Ahmed, III,146.)

Përsëri Profeti (a.s.), nuk i la Abdullah Bin Zehd dhe Omerin të këndonin ezanin, edhe pse e kishin dëgjuar më parë në ëndërr.

Këtë detyrë ia dha Bilalit. Edhe një mësuës i mirë duhet të njohë mirë karakteret, aftësitë e nxënësve të tij. Një mësuës i zoti e edukon më lehtë dhe bukur nxënësin. E shpëton nxënësin nga marrja me punë të kota dhe ia lehtëson arritjen e qëllimit.

Zoti i madhëruar na mundësoftë të jemi nxënës të denjë të të dashurit të Tij, i dërguar si mësuës më shembullor dhe edukuesi më i përkryer i njerëzimit!

Na bëftë një nënë -baba, nxënës, mësuës i cili ia transmeton me dashuri të tjerëve të vërtetat e fesë duke e marrë si shembull Profetin (a.s.), në çdo hap të jetës sonë.

Zoti ynë!Na dhuro mirësi, begati dhe na shto dashurinë tonë ndaj Profetit a.s

Zbukuroji brezat e rinj dhe vendin tonë me pranverat e pavyshkura të dashurisë së Tij.

Amin!





Rrënjët Islamike të Evropës

Massimo Jevolella

Pas mijëra vitesh urrejtjeje të egër dhe gënjeshtërash të tmerrshme, thuhet papritur në epokën e Iluminizmit, Evropa zbuloi “magjinë islame” e, për herë të parë, me Gëten e Carlyle kultura perëndimore njohu edhe madhështinë e figurës së Muhamedit, Profetit të Allahut. Nga ky moment, falë përparimit të studimeve orientaliste, filloi të pranohej nga mjaft intelektualë perëndimorë se qytetërimi lindor ka luajtur një rol themelor në rilindjen e Evropës pas vitit Njëmijë.

Nga letërsia profane te ajo mistiko-fetare, nga filozofia racionaliste te fizika, nga mjekësia te astronomia, nga matematika tek të gjitha degët e tjera të shkencës, të përparimit të teknikës së lundrimit e të bujqësisë e deri në fushat e artit e të mënyrës së rafinuar të jetesës qytetare, në shekujt XI-XIII, ndikimi i botës islamike mbi Evropën kristiane është i fuqishëm dhe plot rrjedhime. Dhe në disa aspekte mund të pohohet që Rilindja e parë evropiane ka lulëzuar në Kordovë në kohët e Averroes e të Maïmonidit, disa shekuj para Firences.

Argumentimi i kësaj teme është i një gjerësie tronditëse dhe Massimo Jevolella e përballon në këtë libër duke privilegjuar një seri të vogël historish ekzemplare. Çështjeve magjepsëse të burimeve islamike të “Komedisë Hyjnore” autori u kushton një kapitull të ndërtimit të hollësishëm filologjik. Figurave të muzikantit Zyrab e të poetit teolog Ibn Hazm ngrihen

në afreskun e gjerë që ilustron shkëlqimin e Andaluzisë islamike. Më pas rrëfimi zhvendoset në Siçilinë e emirëve, të Altavilës, pararendës të arkitekturës arabo-normane e të perandorit Federiku II, mik i sulltanëve dhe filozofëve myslimanë.

Në fushën e shkencave asistohet në ngjarjet fantastike të Kostandin Afrikanit, që për herë të parë në Salerno, i komunikoi Evropës mjekësinë e arabëve; të Leonardo Fibonaçit që mësoi përdorimin e alogaritmeve dhe të shifrave indo-arabike nga një matematikan algerian; të Galileo Galileut që nxori ligjin e lëvizjes së trupave nga një pjesë e *Komentit* të Averroes prej fizikës aristoteliane; të Gerardos nga Kremona, përkthyes i madh në Toledo i veprave arabe në latinisht. Së fundi, me një udhëtim nëpër disa shekuj, arrihet në shekullin XVIII: epokë kur, pas suksesit të “Njëmijë e një netëve”, Evropa dashurohet me Lindjen.

Rreth vitit Njëmijë, ndërsa Perëndimi kristian ishte zhytur në fazën e një prapambetjeje të thellë që zgjati pesë shekuj, një valë e fuqishme qytetërimi, shkencë e kulturë e ardhur nga bota islamike filloi të zbrazej mbi Evropë, duke e shkulur atë nga pazhvillimi dhe duke e hedhur drejt pushtimit të Humanizmit dhe Revolucionit shkencor të shekujve XIV-XVII. Prandaj është me vend të theksohet që islami bën pjesë me plot të drejtë në rrënjët tona.

NJËMIJË VJET FALLSITET

I dyti nga tridhjetë e tre emrat e Zotit, parashtruar nga Marguerite Yourcenar në një poemth të tij të shkurtër, është: “*Bruit de la/ source dans/ les rochers/ sur les parois de/ pierre*”, “Zhurma e burimit në shkëmbinjin mbi faqet e gurta”. Dhe, në qoftë e vërtetë që Zoti është i Vërteti, detyra e atij që kërkon përlulësisht të vërtetën është të ngjitet përherë kundër rrymës së një lumi për të gjetur burimin e tij. Lumi mund të jetë i thellë, i rrëmbyeshëm, krenar, por burimi i vogël sekret është ai që vlen më shumë.

Në fillim të *Romanit të Trëndafil*, që poeti francez Gijom de Lorris shkroi në gjysmën e parë të shekullit XIII, një i ri 20 vjeçar zgjohet në mesin e një nate maji, del në të zbardhur të dritës nga shtëpia e tij dhe ecën kundër rrjedhës përgjatë shtratit të një lumi për të shkruar që të pasqyrohej në Burimin e kthjellët të Narcizit, që është gurra e tij dhe që ngjall në shpirtra Dashurinë e Pastër dhe qartësinë ndaj mistereve të fundit. Në Burim iu shfaq i pasqyruar Trëndafili me tetë petale, i njëjti që poetët tanë të stilit të ri e quajtën “Trëndafili i Sorias”, simbol antik i ringjalljes mistike i riçelur në lirikën e dashurisë së Lindjes myslimane. Ngrihet aty një intrigë e gjerë dhe e fshehtë ndjenjash e kulturash. Është një udhëtim zanafillor që përfundon me kthimin prapa në hapësirë e në kohë. A nuk është në esencë Burimi magjik i Jetës vetë kërkimi i së vërtetës?

Kur i riu Johan Wolfgang Gëte u deh prej këtyre kopshteve poetike të Lindjes dhe e përshkroi Profetin e Islamit me pamjen e një rrëkeje që bie trimërisht në luginë, a nuk mendoi edhe atë aspekt të thellë të metaforës së shkëlqyer? Nuk kishin mjaftuar vallë njëmijë vjet urrejtje dhe gënjeshtër për ta demonizuar në Evropë figurën e Të Dërguarit të Allahut?

Dymbëdhjetë shekuj më parë, ndër shkretëtirat e Arabisë jetoi një njeri që me fjalën e tij profetike ndryshoi rrjedhën e historisë botërore. Ne -ne që i themi vetes “perëndimorë”, dua të them-nuk jemi të sigurtë çfarë do të ishim, nëse ai njeri nuk do të ekzistonte kurrë; nëse kultura islame që shpërtheu nga gjenia e tij s’do ta kishte këputur përgjithmonë qarkun e palëvizshëm e rrënimtar të Mesjetës më të thellë prej Gangut në Pirenej, duke bërë të rrjedhë mes Indisë dhe Evropës një rrymë e freskët dhe pjellore e mendimit filozofik e shkencor, e risive teknike dhe shkëmbimeve tregtare, e diturisë dhe e frymës shpirtërore, e stërhollimit ekstrem në arte, në letërsi dhe në shijen e një jete të mirë.

Ai njeri quhej Muhamed, “I lavdëruari” dhe thuhej i frymëzuar nga Zoti. Nuk ishte një dijetar por një i thjeshtë. Nuk ishte një fanatik apo një i trishtuar, por një zemërbutë që dinte të buzëqeshte dhe të qeshte me gjithë zemër (sepse siç shkruan shën Agostini në librin XIII të *Rrëfimeve*: “E ushqen mendjen vetëm

ai që e gëzon”). I nxiste besnikët e tij të mposhtnin padijeninë duke u thënë: “Kërkojeni diturinë, edhe po të jetë në Kinë!”. Pohonte se lufta e brendshme për të përmirësuar vetveten është pakrahasueshmërisht më e rëndësishme se lufta që zhvillohet me shpatë dhe me heshtë. Përsë hëndeste me shprehjen *selam* (“paqe”) edhe ata që refuzonin predikimin e tij. I konsideronte Ibrahimin dhe Musain baballarë të tij. Besonte me vendosmëri në mesazhin e profetëve judej dhe të Isait, Jezu. Vlerësonte me kristianët devocionin për Marinë, edhe pse nuk arrinte të konceptonte se në ç’mënyrë biri i saj mund të quhej Biri i Zotit.

Por në fund ishte arab dhe, Zoti Një, për të nuk e kishte emrin *Jahweh*, apo *deus* a *theos*, por *All-llah*, domethënë Zot. *Shayt n*, Satana ishte emri i çdo qenieje, dukurie a mendimi që me prepotencën e vet boshe errësonte në botë gjurmët e ndritura të Pranisë Hyjnore. Sepse paradoksi i pashpjegueshëm i Pranisë Hyjnore qëndron në faktin se ajo, duke qenë shkëlqim i pafund dhe fuqi e pafundme, është pafundësisht e brishtë dhe e gatshme të shuhet si një ëndërr përballë arrogancës së zbrazët të hijeve që shqetësojnë mendjet njerëzore. Ajo tërhiqet, si një krijesë e ndrojtur dhe e frikësuar përballë britmës së një të çmenduri e çdo, që kalon rrugës.

Ishte pra shekulli VII i erës kristiane. Muhamedi ndërroi jetë në 632 dhe pak kohë më vonë armatat e sahabëve (nxënësve) të parë të tij, vërshonin në verilindje drejt Sirisë, Mesopotamisë e Persisë dhe në veriperëndim drejt Egjiptit e Afrikës veriore. Bota kristiane ishte si e zhytur në një det të pafund dhe pësonte disfatë pas disfate. Damasku po bëhej selia e kalifatit dhe bariqendra e Islamit po zhvendosej nga Gadishulli Arabik në zonën pjellore të Gjysmëhënës antike që kishte qenë djepi i qytetërimit mesdhetar. Nga Afrika në Spanjë hapi ishte i shkurtër dhe në fillim të shekullit VIII Islami berbero-arab depërtoi me një vrull të pandalshëm në tokën e vandalëve-Vandaluzi, Andaluzi, që ishte avamposti i Evropës kontinentale.

E ndërsa ndodhte gjithë kjo, nga tokat kristiane të sapoislamizuara përhapeshin thashetheme të çuditshme e të pakontrolluara drejt Italisë, Francës dhe vendeve të Evropës qendrore. Shqetësimi i të diturve dhe i të fortëve, tërbimi i hierarkive ekleziastike dhe mahnitja e vegjëlisë së frikësuar shkaktonin pikëpyetje të ngutshme. Tëtohej të dihej e të kuptohej se ç’ishte vallë ai barbar Makhomet a Makomet a Maomet që kishte ngjallur tek arabët një besim kaq të zjarrtë dhe një energji kaq të papërmbajtshme pushtimi. Por injoranca ishte e madhe-dhe është edhe tani, merreni me mend atëherë!-dhe hipotezat pak a shumë fantastike nuk mjaftonin kurrë të shuanin ankthin dhe kureshtjen.

Dhe kështu, pak nga pak, po bëhej zakon të përmendej e të përpunohej në mënyrë të makthshme një episod i vetëm dytësor i jetës së Maometit, që tradita islamike e kishte futur mjaft shpejt në biografinë zyrtare të Të Dërguarit të Zotit. Pra në këtë tregim të shkurtër thuhej që Muhamedi në moshë të re, shoqëroi një ditë xhaxhain Abu Talib në një udhëtim tregtar nga Meka në Siri. Me të mbërritur në portat e Bosrës, karvani i tregtarëve arabë u ndal të pushonte buzë mbrëmjes në një vend që shtrihej pranë një kuvendi kristian dhe Muhamedi që i ngarkuar të ruante ngarkesat me mallra. Të nesërmen, kur dielli ishte ngritur lart në qiell dhe afshi i tij zhuritës u bë i padurueshëm, një re misterioze e errët u shfaq duke qëndruar pezull si një mburojë për të bërë hije mbi kokën e djaloshit. Ndërkaq, nga një dritare e kuvendit, një murg me emrin Bahîrâ po vështronte skenën e jashtëzakonshme dhe po kuptonte manifestimin e një shestimi hyjnor. Bahîrâ doli atëherë për të takuar Muhamedin, i bëri disa pyetje në lidhje me jetën dhe familjen e tij, vërejt një shenjë të veçantë që ai kishte mes shpatullave dhe arriti në përfundim me një qartësi absolute se djali do të bëhej një profet i Zotit. Pastaj iu lut Abu Talibit të vigjëlonte me kujdes të madh mbi paprekshmërinë e Muhamedit e të mos e bënte të ndiqte udhëtimin drejt Sirisë, sepse kristianët dhe judejtë mund t'i grabisnin e t'i nënshtonin me dhunë e tortura.

Tekstet e biografëve arabë nuk shtojnë asgjë thelbësore nga kjo rrëfenjë e shkurtër, përveç faktit që murgu Bahîrâ donte të ishte një personazh i doktrinës së madhe e që në qelën e tij ishte ruajtur një libër dijeje kristiane që ai e kishte trashëguar nga paraardhësit e tij: një libër misterioz, ku, sipas gjasave, po shfaqeshin karakteristikat e njoftimit profetik dhe virtytet e veçanta që duhej të kishte një njeri për ta marrë atë dhuratë nga Zoti. Por pikërisht në këtë pikë, fantazia e interpretëve evropianë shfrenohet në mënyrë galopante, duke ngritur në pak kohë një kështjellë absurditeti dhe gënjeshtërash që në një seri gati të pafund përpunimesh e variantesh-do të krijonin për njëmijë vjet atë që, përtej një shekulli më parë, historiani italian Alessandro D'Ankona e përkufizoi "legjenda e Maometit në Lindje".

Tani, për ta kuptuar më mirë gjenezën dhe ndjenjën e kësaj legjende të pagjasë, është e nevojshme të sjellim ndër mend që feja islame, në vizionin e kristianizmit mesjetar, nuk mund të gjykohej veçse si një devijim heretik i vetë kristianizmit. Myslimanët, të udhëzuar prej Alkuranit (kështu e quanin në kohët antike Kuranin, duke latinizuar arabishten *Al-Qur'an*), i konsideronin Testamentin e Vjetër dhe të Ri si libra të shenjtë të frymëzuar prej Zotit, por mohonin teologjinë trinitare dhe natyrën e dyfish-të humano-hyjnore të Jezuit. Pra s'mund të ishin ndryshe veçse ndjekës të Arit, i cili mohonte që Biri

ishte nga e njëjta materie e Atit; dhe duhej të ishin edhe nxënës të Nestorit, i cili për të njëjtin motiv si Ari, rrëqetëj kur dëgjonte përcaktimin e Marisë si "Nënë e Zotit".

Njësimi i Zotit, për Arin e Nestorin, duhej të ishte absolut dhe i paprekshëm. Një humnerë duhej ta ndante Krijuesin nga krijesa dhe s'mund të kishte një Logos, një Bir të Zotit të mishëruar e të humanizuar, në gjendje që të shërbente si ndërmjetës mes natyrës hyjnore dhe asaj njerëzore. Në këtë këndvështrim, ideja e Shëlbuesit sfumohej dhe zhdukej. Dhe Jezui e humbiste epitetin Krisht, domethënë Mesia, i Mirosur prej Zotit dhe bëhej thjesht i fundit dhe më i përsosuri i profetëve judej. Një njeri i Zotit, por jo Zoti. Ekzaktësisht si Muhamedi, që për myslimanët bëhej kështu profeti i arabëve dhe, në të njëjtën kohë, ngrihet në rolin e shquar të Vulës së Profecisë universale.

Murgu misterioz Bahîrâ, u bë herët në fantazinë e evropianëve një heretik i lig nestorian, që, për të shfrytëzuar urrejtjen e tij të tmerrshme kundër Kishës së Romës, kishte ngulitur tek i riu Maomet doktrinën e tij rravguese që ta yshte pastaj atë të shtirej si profet, të konvertonte arabët e t'i bashkonte në një koalicion të fuqishëm luftarak të aftë për të sulmuar e përpirë botën kristiane. Po zinte fill e po rrënjosej menjëherë një "teori komploti" e vërtetë dhe e veçantë (prej atyre që do të shiheshin shpesh në histori deri tek ankthi paranojak nazist i "përбетimit universal hebraik" për të dominuar botën.

E prapëseprapë, akoma diçka nuk përputhej mirë në tregim: si shpjegohen, në fakt, arsyet e vërteta të gjithë atij tërbimi hakmarrës? Bahîrâ-që në versionet e panumërta të legjendës merr dora-dorës shumë emra të larmishëm, nga Baira në Serxho, nga Nestor në Feliks në Nikollë në Grosio e të tjerë akoma-nuk mund të ishte veçse një heretik i etur për shizma, një teolog i frustruar dhe në kërkim aventurash, një murg vizionar i prishur nga demoni. E pra: pse nuk u shndërrua në një eremit të brejtur nga zyrtësia dhe ambicia, që, me vdekjen e patriarkut të Jeruzalemit apo të Aleksandrisë të mëtonte e të intrigonte të bëhej pasardhës, që të fryhej pastaj nga zemërimi hakmarrës përballë refuzimit të papës? Ose: pse të mos imagjinohej që eremiti djallëzor në realitet nuk ishte as murg, por thjesht një kardinal i Kishës së Shenjtë Romane që, me vdekjen e papës, ëndërroi të ngjitej në fronin papal dhe, i zhgënjyer nga refuzimi i Selisë së Shenjtë, u nis drejt Lindjes dhe ra në Siri si një rrufe e çmendur për të goditur me bisedat e tij heretike të riun Maomet e për t'i turrur arabët kundër Krishtërit. Hap pas hapi, zinxhiri i gënjeshtërave fantazmagorike zgjatej gjithnjë e më tepër, deri aty sa të sigurohej që, në realitet, murgu famëkeq s'kishte qenë kush tjetër, veç vetë Maometi. Një Maomet kardinal katolik... Jo vetëm, por italian e, pse jo, roman

i shtëpisë Kolona apo edhe padan, i diplomuar në teologji në Universitetin e Bolonjës! E përfytyroni një Maomet bergamez që, shumë i zemëruar se nuk ishte zgjedhur papë, niset për Egjipt, sajon mijëra marifete për t'u bërë i besueshëm si arab dhe profet i Zotit, trillon Kuranin e shenjtë, duke vjedhur histori nga Testamenti i Vjetër dhe i Ri, çrrënjës paganizmin nga Meka dhe ndez tek ndjekësit e tij një urrejtje për vdekje ndaj Kishës së Romës? Ngjajnë si përralla të botës tjetër e, megjithatë, bëhet fjalë saktësisht për tregimet që popujt e Evropës së krishterë i kanë besuar e pranuar për ar të kulluar mijëra vjet: nga shek. VIII deri në shek. XVIII pas krishtit.

Por, natyrisht, kjo nuk është e gjitha. Sepse duhej shpjeguar edhe se me çfarë mënyrash të zgjuara profeti fals kishte arritur t'u impononte arabëve doktrinën e tij të paudha, ç'tip njeriu kishte qenë ai, si kishte jetuar dhe si kishte vdekur. E atëherë, biografia e Maometit mbështillet pa fre në një farë romani komik e pikaresk, plot me kthesa të papritura dhe aventura. Si fillim, gjymtohej emri i tij në mënyra të ndryshme -Mamuc, Maúma, Pelaxh, Oçin...-dhe jo rrallë me synimin e qartë për ta bërë qesharak dhe të urryer: për shembull, nga Maomet në Malkomet (Malkonmet në variantin "poetik" të një anonimi, i cili shkroi në vitin 1310 një ripunim mediokër në vargje të *Thesarit* të Bruneto Latinit), për të nënvizuar pa mundësi keqkuptimi, që heretiku mashtrues kishte si mision të vetëm atë të "të bërit keq". Figura e tij vizatohej si ajo e një burri të qullët, plot vese, i sëmurë nga epilepsia-gjë që mund t'u jepte një shpjegim ekstazave të tij vegimore-e, në mënyrë të veçantë, i prirur ndaj epshit (nëntë gratë e tij: çfarë çmendurie për moralin kristian!). Pastaj rrëfehej me një bollëk hollësirash, për ndërmarrjet e tij të famshme dhe se si ai arriti t'i bënte plebejtë paganë ta besonin si të shenjtë Alkuranin e tij të rremë. Maometi stërviste për ditë të tëra një lopë që t'u përgjigjej vetëm urdhrave të tij e të ushqejej vetëm prej duarve të tij. Pasi e kishte fshehur në një shpellë, lidhte mes brirëve të saj librin mashtrues, mblidhte një turmë guakësh dhe njoftonte solemnisht që së shpejti Allahu do t'u shfaqte atyre Ligjin e tij me një *cuop de théâtre* të vërtetë. E thirrur nga një sinjal, vinte pas pak aty lopa dhe shkonte gati e shtrirë në këmbët e Maometit për të marrë ushqimin, në atë mënyrë që t'i zgjaste në duar librin që i varej në kokë. Po atëherë, natyrisht, ndonjëri më pak sylesh, do ta pyeste profetin se në ç'mënyrë Allahu ia komunikonte Fjalën e tij. Dhe në një çast të tillë ishte gati demonstrimi praktik i sistemit: fshehurazi, Maometi vinte kokrra gruri në veshët e tij, pastaj, me t'u mbledhur turma e zakonshme, vihej sikur dëgjonte një zë nga lart dhe, pas pak castesh, fluturonte nga qielli deri mbi supet e tij një pëllumbeshë e stërvitur, që fuste sqepin në veshët

e tij për të çukitur kokrrat e grurit dhe që turmës së mahnitur i shitej për një krijesë engjëlllore, dërguar nga Zoti, që t'i pëshpëriste dëgjuesit të vet versetet e Kuranit.

Kapërcejmë mbi episode të tjera dhe vijmë në finalen mizore. Po, sepse *clou* (numri kryesor) i legendës perëndimore të Maometit qëndronte në tregimin poshtëruës mbi vdekjen e tij. Gjatë një udhëtimi në shoqërinë e ndjekësve të tij, mashtruesi urdhëroi befaz ndalimin e karvanit dhe u veçua pas një shkëmbi për të shfryrë nevojat e veta trupore. Por teksa kthehej drejt grupit, u sulmua nga një tufë derrash të egër, të cilët, të tërbuar nga uria, e vranë e pastaj tentuan ta përpinin. I shpëtuar *in extremis* nga fyerja e gëlltitjes prej derrave, trupi i sflitur i Maometit u varros në një varr guri e pastaj, u ngrit peshë në mënyrë magjike mes katër shtyllave, për hir të tërheqjes së fuqishme të fatkeqësisë. Për kulmin e absurdit, mund të kujtojmë edhe që fundi i Maometit të shqyer nga derrat, mbahej përgjithësisht prej kristianëve si motivi i vërtetë i ndalimit të konsumimit të mishit të dërrit. E po të duam një tjetër kuriozitet, mund të kujtojmë më tej në ç'mënyrë shpjegohej ndalimi i pirjes së verës: në një prej morisë së versioneve të legendës perëndimore rrëfehej se një grup ndjekësish të Maometit kishte marrë zët murgun Bahîrâ dhe, një natë, duke përfutur nga fakti që Maometi ishte i dehur tapë, i kishin marrë shpatën dhe me të kishin vranë Bahîrâ-n, duke e shpuar tejprtej. Kur Profeti e mori veten nga dehja madhështore, vrasësit e kishin bërë të besonte se kishte qenë ai, në një vrull të pavetëdijshëm zemërimi, që kishte masakruar murgun. Duke bërë hesap faktin se vera mund të errësojë arsyen, që atë ditë Maometi do t'ua ndalonte përgjithmonë myslimanëve ta pinin.

Këto përralla të pabesueshme krijuan thaujse gjithë çfarë popujt e Evropës së krishterë, njohën mbi Maometin, mbi jetën dhe doktrinën e tij, deri në shekullin e Iluminizmit. Dhe kur flas për popujt, nuk e kam fjalën vetëm për masat injorante dhe analfabete, që atëherë e kalonin nëntëdhjetë për qind të popullsisë së përgjithshme, por edhe për shumicën e madhe të letrarëve dhe të të kulturuarve, së paku deri në gjysmën e dytë të shek. XII.

Bindja absolute e një Maometi mashtrues, që me një dominim djallëzor pati krijuar një fe të re fallso, vetëm me qëllimin për të shkatërruar fenë e krishterë, pasqyrohet, siç e dimë mjaft mirë, në Këngën XXVIII të *Ferrit* të Dantes, ku, në tmerrin e lugut të nëntë të rrethit të shtatë, në mes të grupit të mbjellësve të përçarjes, Maometi i gjorë dërgjet me trupin e çarë nga mjekra deri në fund. Siç është e lehtë të shihet, bëhet fjalë për pjesën, mbase më të rëndë e të pështirë të gjithë *Komedisë hyjnore*. Të jetë kjo një rastësi? Apo, siç ka të ngjarë më shumë, një jehonë e mirëmenduar e atyre hollësive të neveritshme që

legjenda perëndimore e Maometit dëshiron ta lërë trashëgim?

Kaluan shekuj dhe asgjë nuk ndryshoi. Në gjysmën e dytë të shekullit XVII, duke dashur të trajtonte Maometin dhe Islamit në një kapitull të *Pensées* (Mendime), gjenia e Blez Paskalit nuk gjeti shprehje më të mirë se tonet e një kritike fshikulluese, bazuar e gjitha në kundërvënien mes shenjtërisë së Jezuit dhe mashtrimit të Maometit.

Pastaj befas, në vitin 1773, flakëroi mbi Evropë si “vezullim ylli”, “shpirti i mirë” i Maometit të Gëtes. Gjeniu i ri i Frankfurtit ëndërronte figurat heroike, shpirtrat faustianë që përgjatë historisë kishin tronditur e përtërirë jetën e njerëzimit. Dhe takoi atë njeri që ai e përfytyronte të pastër e të egër, të dalë në dritë si një burim i kulluar uji mes shkurreve e skërkave, i pushtuar nga Zoti. Pararendësi i romantizmit perëndimor takoi Profetin e Islamit dhe u dashurua me të me një dashuri të fuqishme e të sinqertë.

Ndoshta në idealizmin e tij epik e fantastik, ai ngatërroi pak figurën e revolucionarit fetar me atë të poetit rebel paraislamik Shánfara, banditit krenar të shkretëtirës së Arabisë, që thoshte për veten e tij: “Shokët e mi janë një çakall me hap të shpejtë, një panterë e lëmuar laramane dhe një hijenë e çalë me krifë të lëmuar.[...] Nuk i trembem errësirës së natës, kur një shkretëtirë e frikshme vërsulet kundër devesë së trembur që turret në një galop të verbër”. Dhe e krahason me një rrëke të vrullshme që zbret drejt detit në një vrapim triumfues duke mbarsur shkretëtirat e thata me limfën e fjalës së vet e duke krijuar nga asgjëja një qytetërim të ri e të harlisur.

Kur njëzetetrevjeçari Johan Wolfgang shkroi vargjet e *Mahomet Gesang*, duheshin edhe dy vjet deri në fillimin e luftës së Pavarësisë amerikane dhe gjashtëmbëdhjetë në atë të Revolucionit francez. Rrëkeja, në përshkrimin e plotë të lirikës gëtitane shembëllente pra-si një ëndërr mistike paralajmëruese-përmbysja e pashmangshme e ekuilibrave shekullorë, rrokullisja traumatike e vlerave antike, shtatzania heroike dhe e dhimbshme e një Perëndimi të ri. Rreth tridhjetë vjet më parë, as racionalizmi skeptik i Volterit s’kishte qenë në gjendje ta gjykonte figurën e Maometit në një këndvështrim realisht të ndryshëm prej atij të urrejtjes së verbër teologjike të Mesjetës (dhe jetohej atëherë, siç do të shihet më mirë në kapitullin “Aromë Lindjeje”, në klimën e plotë të entuziazmit orientalistik që prodhoi suksesi i *Një-mijë e një netëve*).

Në tragjedinë me pesë akte *Le fanatisme ou Mahomet le prophète* (“Fanatizmi ose profeti Mahomet”), me pretekstin e shembjes së fanatizmit fetar, autori i *Kandidit* dhe i *Traktatit mbi tolerancën* nuk ngurron të vërsulet kundër Maometit në mënyrën më të verbër e fyese, duke trilluar një ndodhi të ngjyer

me shpifje fantastike e që, në fakt, rilidhet qoftë në përbajtje, qoftë në stil me versionet më të vjetra të legjendës perëndimore të Maometit.

Mashtrues, idhnak, eposhor, i pabesë, i etur për hakmarrje, Profeti i Islamit bëhet këtu protagonist i një historie qesharake pasionesh erotike e xhelozish të çmendura, që e shtyjnë të bëhet nxitësi i një zinxhiri fatkeqësish e krimesh të ulëta (urdhëron skllavin Seid të vrasë në emër të Allahut sheikun Zopir, pastaj helmon vetë Seidin që e beson si të dashurin e skllaves Palmira, të lakmuar prej tij në mënyrë të sëmurë, së cilës ia merr jetën me thikë; e tutje me këtë hap, nga egërsia në egërsi, deri në fallsitetin suprem të fshirjes së çdo gjurme të krimeve për të lartësuar akoma më shumë lavdinë e tij në sytë e popullit që e adhuroi si një qenie mbinjerëzore).

Duke rilexuar gjeputat rrëqethëse të Volterit-Mjeshrtit të madh të Mendimit të lirë dhe babait mendjemprehtë të qytetërimit laik e modern perëndimor-qartësohen edhe origjinat ideologjike të disa rrymave aktuale të opinionit kundërshtar ndaj Islamit (por edhe integralizmi laik që ndalon mbulesën në shkolla, a nuk është vallë biri legjitim i kësaj “urrejtjeje fanatike ndaj fanatizmit”?).

Shpresat iluministe të Gëtes-idealiste deri në adhurim në paraqitjen poetike të Maometit-ishin caktuar, sidoqoftë, të hidhnin rrënjët dhe të jepnin në harkun e disa dekadave fruta vërtet të pjekura. Më 8 maj të vitit 1840, në të dytën prej konferencave të tij të njohura, kushtuar figurave historike të heronjve të njerëzimit, mendimtari scocez Thomas Carlyle, fillonte me këto fjalë të qarta: “Opinionit i përgjithshëm mes nesh mbi një Maomet intrigant e mashtrues që do të ishte fallsiteti i bërë person, feja e të cilit s’do të ishte veçse një grumbull sharlatanerie e budallallëqesh, po fillon vërtet të bëhet i padurueshëm për sytë e të gjithëve. Gënjeshttrat, që ca njerëz të zellshëm plot qëllime të mira kanë grumbulluar rreth këtij njeriu, po kthehen vetëm në turpin tonë. [...] Mendoj se kurrë ndonjëherë një teori e patënzone nuk është përhapur mbi këtë tokë. Një mashtrues të ketë ndërtuar një fe? Por një mashtrues nuk është i zoti të ndërtojë as një shtëpi tullash!”

Për Carlyle, Maometi, jo vetëm që nuk është një profet fals, por është imazhi vetë, është paradigma e besimit të sinqertë. Nga kjo dhunti e tij themelore rrjedhin të tjera që përfundojnë në skicimin e portretit të një njeriu të jashtëzakonshëm: “I matur, i ndershëm, i përzemërt, i kulluar, karakter i rreptë dhe i sinqertë e, prapëseprapë, i dashur, miqësor, i shoqërueshëm e deri gazmor. Dhe qeshja e tij është e mirë; ndërsa ka njerëz që kanë qeshje të gënjeshtërt, siç është e gënjeshtërt çdo gjë e tyre”.

Carlyle e përcakton Maometin si “një shpirt i madh i heshtur”, por në të argumentuarit e tij i kapër-

cen mjaft shpejt vlerësimet mbi personin e Profetit dhe -duke iu referuar tekstualisht disa pohimeve të Gëtes-zhvillon një diskutim tejet interesant mbi ekzistencën e vetë Islamit.

Në veçanti, një faqe e këtij diskutimi, të mahnit edhe sot me qartësinë e parashtrimeve, që besoj se kanë mbetur të pakapërcyeshme për të na dhënë ne perëndimorëve-besimtarë apo ateistë-çelësin më të përsosur e të dobishëm të leximit të besimit islam. Në thelb Carlyle thotë: shprehja *Allah Akbar* ("Zoti është më i madhi"), që myslimanët e përsërisin përshtur, nuk është aspak kërkesa e një supremacie të Allahut mbi Zotin e feve të tjera. *Allah Akbar* do të thotë që vetëm Ai është realiteti i vërtetë. Prandaj ne dhe të gjitha gjërat, s'janë tjetër veç hije të Tij, petk kalimtar që mbulon shkëlqimin e përjetshëm. Pra, *Islam* do të thotë njohje e kësaj të vërtete thelbësore dhe pastaj, medoemos nënshtrim ndaj vullnetit të Zotit. Dhe ky është besimi: të lëshuarit tek Ai tërësisht, në të mirë dhe në të keq. Ky nuk është fatalizëm pasiv, por përkundrazi: "Gjithmonë është konsideruar si forma më e lartë e maturisë, për një njeri, jo aq nënshtrimi ndaj nevojës-do ta mendojë mirë nevojën për të bërë nënshtrimin!-sesa njohja dhe të besuarit plotësisht se gjithë çfarë nevoja ka caktuar me rreptësi, është gjëja më e matur, më e mirë, pikërisht ajo që na duhej; të hequrit dorë nga mëtimi i rremë i gjurmimit, me atë pak tru që kemi, mbi këtë Gjithësi të madhe të krijuar prej Zotit". Duke realizuar këtë formë të urtësisë, njeriu "është fitimtar, për arsye se ka fituar vepra në harmoni me ligjin e madh qendror.[...] Dhe kjo është ekzistenca e Islamit, që është pikërisht e njëjtë me ekzistencën e Krishtëritit".

E jashtëzakonshme! Në vitin 1840, një filozof skocez zbulon se mes Islamit dhe Krishtëritit nuk ekziston në realitet asnjë konflikt besimi e qytetërimi. Pas njëmijë vjet shpifesh e gënjeshttrash perëndimore, deklaroi *apertis verbis* se ne duhet të respektojmë Muhamedin dhe Kuranin, saktësisht siç kanë respektuar përherë myslimanët Jezusin dhe shkrimet tona të shenjta (kujtojmë që Kurani, në versetin 25 të sures 35, arrin ta përcaktojë Ungjillin si *Al-Kitâb al-Munîr*, apo "Libri i ndritur").

Udhëtimi ynë drejt burimit të lumit sapo ka filluar. Do të na shpjerë shumë mbrapa në hapësirë e në kohë, pikërisht atje, në atë Mesjetë ku kridhen rrënjët aq të kërkuara kristiane që shumë shpesh hakmerren në mbështetje të një "identiteti" jo fort të qartë. Po përse hakmerren? Nuk kanë mjaftuar, vallë, dymijë vjet për të bindur askënd? Çfarë do të mbetej nga qytetet dhe fshatrat tona, nëse befaz do të zhdukeshin kishat, katedralet, kambanoret e manastiret? Faltoret prej guri e tullash nuk na i heq kush. Nëse mbahemi aq shumë pas Krishtit, përse nuk e kërkojmë brenda ndërgjegjes dhe zemrës sonë,

në vend që të vazhdojmë ta identifikojmë në monumente dhe institucione? Në fakt, cilat janë rrënjët tona të vërteta? Ato, që për më shumë se njëmijë vjet na kanë bërë të urrejmë, të shpifim e të luftojmë myslimanët (dhe heretikët, shtrigat, hebrejtë), apo ato-vërtet fetare, shpirtërore-që Gëte e Karlajl i tregojnë si "burime të përbashkëta" të besimeve monoteiste?

Duke gjurmuar historinë tonë kulturore mbi bazën dialektike të këtyre premisave, do të vihemi shumë shpejt përballë më paradoksales së surprizave: do të zbulojmë që edhe Islami bëhet pjesë, me plot gojën, e rrënjëve tona më të thella dhe Perëndimi ynë i dashur nuk do të ishte absolutisht ai që ne sot imagjinojmë se është, nëse Muhamedi dhe Kurani nuk do të kishin ekzistuar kurrë. Nganjëherë të vërtetat më të thjeshta mund t'u shfaqen syve tanë si gjëra të ndërlikuara, por në këtë rast e vërteta është e një thjeshtësie tronditëse: më se njëmijë vjet urrejtjeje fetare dhe arrogance eurocentriste, botës së krishterë ia kanë ndaluar të njohë gjithë atë borxh të madh në ballafaqimet me Islamin.

Rreth vitit Njëmijë, ndërsa Perëndimi flinte në pazhvillim dhe injorancë, një dallgë e fuqishme qytetërimi, shkence e kulture, e ardhur nga bota islamike, u derdh mbi Evropë duke e shkukur atë, në kuptimin e plotë të fjalës, nga prapambetja e duke e hedhur drejt pushtimit të Humanizmit, Rilindjes dhe Revolucionit shkencor të shek. XVII. Historianët e kanë gjurmuar gjerësisht dhe e kanë sqaruar atë fenomen të jashtëzakonshëm, por ndërgjegja e zakonshme nuk e ka pranuar akoma dhe në shumë raste as nuk e ka kuptuar. Ekstremizmi islamik aktual, nga njëra anë dhe teza perverse e "përplasjes së qytetërimeve", nga ana tjetër nuk bëjnë tjetër veçse ngadalësojnë arritjen e kësaj ndërgjegjeje të nevojshme, duke ngritur perden e një tymnaje gënjeshttrash që rrezikon të errësojë konturet e sakta të së vërtetës.

Miliona myslimanë-dhe kam parasysh edhe shumë prej atyre që jetojnë mes nesh në Evropë-refuzojnë akoma sot t'i qasen pasurisë së gjerë të kulturës perëndimore, për arsyen e thjeshtë se ajo "nuk është islamike". Dhe nuk e dinë që kjo bindja e tyre është vetëm fryt injorance dhe një largim total nga e vërteta historike. Nuk e dinë se Islami i tyre ka luajtur një rol thelbësor e të thellë në zhvillimin e kulturës evropiane e, për këtë arsye, ata nuk duhet të kenë asnjë motiv të ndihen "të huaj" e "të ndryshëm" mes popujve të kontinentit tonë. Evropa është edhe shtëpia e tyre dhe me plot gojën, edhe pse, me siguri nuk i përket *Dâr-al Islâm* -it. Pra, kthimi në burimet e historisë është një detyrë imponuese. Këmbëngulja për ta injoruar tregon ndihmesë në uljen e Perëndimit.

Përktheu: Zija Vukaj

Hasan Basriu

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Emri i tij është Hasan bin Ebi'l-Hasan el-Basri, ndërsa nofka është Ebu Muhamed dhe Ebu Said. Ai ishte kryeura e “Brezit të Artë”, që arrinte deri te “Shekulli i Lumturisë”. Ishte prej imamëve të brezit të tabiinëve dhe profesor në fikh e në tasavuf.

Përgjatë çlirimeve islame, babai i tij u soll si rob në Medine nga Mejsani, i cili është një vend afër Basrës së Irakut dhe u lirua nga Zejd bin Thabit el-Ensari. Nëna e tij është zonja Hajra, që u lirua nga Umu Seleme, e cila ishte njëra prej bashkëshorteve të Pejgamberit, sallallahu alejhi ve sellem. Ai lindi në vitin 21 hixhri (642 p.e.s.), në kohën e hilafetit të Hazretit Umer, (r.a.). Kur lindi, e dërguan te Umer për t'i vendosur emrin. Kur Umer pa fytyrën e tij të bukur, tha: “Emri i tij le të jetë Hasan!”

Hasan Basriu u rrit në shtëpinë e nënës së besimtarëve, Umu Seleme. Ai fitoi dashurinë, interesimin dhe lutjet e saj.

Lidhja e tij është me Imam Aliun, (r.a.). Nga ai veshi pelerinën e misticizmit. Ai është takuar me rreth njëqind e tridhjetë sahabë, shtatëdhjetë prej të cilëve patën marrë pjesë në Luftën e Bedrit. Po ashtu, ka transmetuar hadithe nga sahabët e mëdhenj, si Imran bin Husejn, Themure bin Xhunde, Ebu Hurejre, Ibn Umer dhe Ibn Abas.

Pasi përfundoi studimet shkencore dhe edukimin shpirtëror në Medinë, u vendos në Basra, që ishte vendi i babait të tij. Ai formoi një fushë të madhe ndikimi me karakterin e fortë, me asketizmin dhe devotshmërinë, me adhurimin dhe frikërespektin ndaj Allahut. U takua me personalitete të nderuara, si Ibn Shirin dhe Shabi. Në Basra u bë një xhema i madh, që dëgjonte vazat e tij. Rabiati'l-Adevije, Malik bin Dinar dhe Habib Axhemi, ishin prej mistikëve të mëdhenj që përftuan prej tij.

Ai u shkroi letra burrave të shtetit, si Imam Hasan bin Aliut, (r.a.), dhe Umer bin Abdulazizit, të cilat synonin predikimin. Me këto letra, ai konsiderohet prej mistikëve të parë që këshillonin njerëzit për në udhëzim. Duke shfaqur një trimëri të rrallë, ai i shkroi këto fjalë Umer bin Hubejre el-Fezarit, i cili ishte emëruar prefekt i Irakut dhe i Horosanit nga Jezid bin Abdulmeliku:

“O Ibn Hubejre! Ki frikë Allahun për Jezidin, por mos ki frikë Jezidin për Allahun! Sepse Alla-

hu të shpëton ty nga Jezidi, ndërsa Jezidi nuk mund të të shpëtojë ty nga Allahu. Allahu Teala të dërgon befasisht ëngjëllin e vdekjes dhe ti bie nga vila jote e bukur, drejt e në varrin e ngushtë. Aty asgjë nuk mund të të shpëtojë, përveç punës sate.”

Me punën e tij, Hasan Basriu konsiderohet përfaqësues i tasavvufit, që mbështetej në frikë dhe brengë. Cilësia dalluese e jetës së tij askete ishte meditimi, i cili e shpie njeriun te besimi dhe frika e brengosja që e pastrojnë veten, e bëjnë njeriun që të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe e shpien atë te mirësitë e xhenetit. Baza e jetës së tij shpirtërore, ishte heqja dorë nga kjo botë, mosinteresimi mbi të ardhmen e botës, drejtimi nga Allahu dhe besimi ndaj tij.

Vishte rroba prej leshi dhe këtë e konsideronte si shenjë të modestisë. Ai thoshte:

“Unë kam arritur rreth shtatëdhjetë sahabë që kanë marrë pjesë në Luftën e Bedrit. Asnjëherë nuk kam parë që këta të vishnin diçka tjetër përveç leshit.” Përsëri thoshte: “Atij që vesh rroba të bardha për modesti, Allahu ia shton dritën e largpamësisë, por, nëse i vesh për shtirje dhe mburrje, e hedh në xhehenem.”

Duke krahasuar brezin e mëvonshëm me sahabët, thoshte:

“Sikur t’i shihnit ata, do t’i pandehnit të çmendur. Sikur ata të shikonin të mirët tuaj, do të thoshnin: “Këta janë njerëz që nuk kanë pjesë nga e mira dhe mirësia”. Ndërsa po të shikonin të këqijtë tuaj, do të pyesnin: “Edhe këta janë myslimanë?”

Ai ishte asket. Shkaku i të drejtuarit nga asketizimi, ishte shpëtimi nga një e keqe dhe arritja e një mirësie. Mirësia që dëshironte të arrinte, ishte sevapi i xhenetit, ndërsa e keqja prej së cilës dëshironte të sigurohej, ishte ndëshkimi i xhehenemit. Sepse asketizmi i vërtetë, është mosvlerësimi i tepërt i kësaj bote.

Nuk është parë asnjë njeri që të gjejë ahiretin duke kërkuar këtë botë, por ka shumë prej atyre që e kanë gjetur këtë botë, duke kërkuar ahiretin. Kjo botë është vendi i punës. Ai që e shoqëron atë pa e dashur dhe heq dorë prej saj, arrin kënaqësinë nga kjo shoqëri dhe përfiton. Por ai që e shoqëron duke e dashur, bëhet fatkeq.

Një ditë, Malik bin Dinar pyeti Hasan Basriun:

- Cili është ndëshkimi më i rëndë në këtë botë?
- Është vdekja e zemrës së njeriut.
- Përse vdes zemra?

Hasan Basriu iu përgjigj:

- Për shkak se do këtë botë.

Sepse ai që e nderon interesin e kësaj bote, bie në poshtërim. Sado që të jetë e madhe, përsëri e përkohshmja nuk është e barabartë me të përhershmen.

* * *

Ai thotë:

“Vesvesi që vjen në zemër është nga shejtani. Nëse

diçka dëshirohet vazhdimisht, ajo vjen nga vetja. Mënyra për të shpëtuar nga këto dëshira, është praktikimi i rrugës së rijazetit me agjërim dhe namaz.”

Ai tregon:

Në Abadan ishte një njeri i zi, i cili jetonte në gërma-dha. Një ditë, mora disa gjëra nga pazari dhe shkova ta vizitoja. Ai më pyeti:

- Çfarë janë këto?

Unë i thashë:

- Disa gjëra për të cilat mund të kesh nevojë. Pa thënë asgjë, me dorën e tij më tregoi murin dhe qeshi. Befas pashë, por çfarë të shikoja, muret e atyre gërma-dhave ishin komplet flori. U pendova për atë që bëra, menjëherë i lashë ato që kisha sjellë dhe u largova me ndikimin e asaj madhështie.

* * *

Ai ishte i devotshëm. Gjithmonë thoshte: “Një grimcë e devotshmërisë së singertë, është më e mirë se mijëra rekate namaz.” Një ditë në Mekë, pa njërin prej fëmijëve të Hazretit Ali, i cili po mbante vazë duke u mbështetur në murin e Qabes dhe e pyeti:

-Cila është baza e fesë?

-Devotshmëria!

-Cili është shkatërrimi i fesë?

-Tamahu!

Hasan Basriu u kënaq shumë nga kjo përgjigje dhe u bë njeri i devotshëm. Për devotshmërinë thoshte kështu:

“Devotshmëria ka tri shkallë:

E para: I devotshmi thotë vetëm të drejtën edhe kur është i zemëruar edhe kur është i qetë.

E dyta: I mbron gjymtyrët e tij nga sjelljet që i hapin rrugë zemërimit të Allahut.

E treta: Synon çështjet prej të cilave Allahu është i kënaqur.”

* * *

Një herë, hyri në një xhami për të falur namazin e akshamit. Namazin po e falte Habib Axhemi. Ngaqë Habib Axhemi nuk ishte Arab, ai nuk e fali namazin pas tij, duke u shqetësuar se mos bënte ndonjë gabim në leximin e Kuranit. Atë natë në ëndërr, iu tha: “Përse nuk u fale pas tij? Sikur të ishe falur, do të të faleshin të gjitha mëkatet që ke bërë deri në atë çast.”

Një herë, u detyrua të dëgjonte një përgojim në kuverndin ku merrte pjesë. Gjërat që pa atë natë në ëndërr, i tregon kështu:

“Një njeri, i cili kishte një pjatë në dorë, u afrua te unë. Në pjatë kishte mish derri. Më urdhëroi që të haja nga ai. I thashë: “Ai është mish derri dhe nuk mund ta ha”. Duke insistuar që ta haja, ma hapi nofullën dhe më futi me zor një kafshatë në gojë. Unë kisha frikë që ta nxirrja mishin nga goja dhe, po ashtu, kisha neveri

ta gëlltisja. Në këtë gjendje u zgjova. Këtë erë e kam ndërë tridhjetë ditë e tridhjetë net, në çdo gjë që kam ngrënë dhe kam pirë.”

Edhe pse e dinte se ndëshkimi shpirtëror i imponi për të dëgjuar përgojimin, qoftë edhe pa dashje, është shumë i rëndë, asnjëherë nuk zemërohej me ata që e përgojnin. Një ditë, dikush i tha:

- Filani të ka përgojuar.

Ai i dërgoi një pjtatë ëmbëlsirë përgojuesit dhe i tha:

- Dëgjova se më ke dhuruar të mirat e tua. Edhe unë po të dhuroj këtë si kundërvlerë.

Jeta e tij askete ishte e mbushur plot me frikë dhe pendim ndaj Allahut të Madhëruar. Ishte i shqetësuar dhe i brengosur. Ai nuk flinte dhe nuk dinte ç'ishte dremitja. Ishte një adhures, i cili i kishte përveshur mëngët për ibadet. Ata që e shikonin, kujtonin se mos i kishte ndodhur ndonjë fatkeqësi, për shkak të brengosjes që kishte në aparcë. Ai shprehej:

“Besimtarët zgjohen të shqetësuar dhe ngrysen të shqetësuar ndërmjet dy frikëve. Njëra është një mëkat i kaluar, i cili nuk dihet se si pritët nga Allahu. Ndërsa tjetra është një jetë, përgjatë së cilës nuk dihet se me çfarë rreziqesh do të përballesh.”

“Ai që e di se në fund do të vdesë, që beson se do të ngrihet në kiamet dhe që është i bindur se, kur të ringjallet do të dalë në audiencën e Allahut, duhet të jetojë me brengosje dhe shqetësim.”

Sipas konceptit të tij në frikërespekt ndaj Allahut, zemra ka nevojë për një frikë të përhershme.

Ai frikësohej aq shumë nga zjarri i xhehenemit, sa që pandehte se xhehenemi është krijuar vetëm për të. Kështu, kur dëgjoi hadithin fisnik, i cili thotë: “*Njeriu i fundit që do të dalë nga xhehenemi, është një person i cili quhet Hunad*”, qau dhe tha: “Ah sikur të isha unë Hunadi, sepse qoftë edhe në fund, ai ka një siguri se do të dalë nga xhehenemi. Ndërsa ne nuk e kemi një siguri të tillë.”

Ai thotë:

“Nëse lexon Kuran dhe i beson atij, le të kesh shumë brengosje e shumë frikë në këtë botë. Po ashtu, qaj shumë.”

Atyre që thoshnin se i trembte njerëzit me fjalë të tilla, u përgjigjej kështu:

“Të frikësohesh derisa të arrish sigurinë, është më mirë se të frikësohesh pasi të arrish sigurinë.”

* * *

Një bedevi e pyeti se çdo të thotë sabër. Ai iu përgjigj:

- Sabri është dy llojesh: njëri është durimi ndaj belave e fatkeqësive dhe tjetri është durimi ndaj ndalesave hyjnore.

Kur bedeviu i tha:

- Unë nuk kam parë njeri më asket se ti.

Hasan Basriu iu përgjigj:

- Asketizmi im është plotësisht dëshirë. Durimi im është plotësisht qarje.

- Çdo të thotë kjo? A mund të ma shpjegosh pak? Më është ngatërruar koka fare.

- Durimi im në fatkeqësi e bindje, shpreh frikën time ndaj zjarrit të xhehenemit. Çfarë mund të jetë tjetër kjo, përveçse qarje? Ndërsa fakti që unë jam asket dhe nënvlerësues ndaj kësaj bote, çfarë mund të jetë tjetër përveçse dëshira ime për ahiretin? Lum për atë që duron vetëm për Allahun e jo për faktin se shqetësohet për xhenetin dhe xhehenemin!”

* * *

Ai thotë:

“Ëmbëlsinë shpirtërore kërkojeni në këto tri gjëra: Në namaz, në dhikër dhe në leximin e Kuranit. Lum për ju, nëse e gjeni. Nëse nuk e gjeni, dijeni se ju është mbyllur dera e veprës, e ëmbëlsisë shpirtërore, për shkak të ashpërsisë së zemrës.”

Kur i thanë:

- O shejhu ynë i nderuar! Zemra po na fle. Ju lutemi na qortoni.

Ai u tha:

- Ah sikur të flinte zemra juaj, sepse është shumë lehtë që ta zgjosh atë që fle. Por zemra juaj është e vdekur, sepse u bënë shumë kohë që përpiqem ta vë në lëvizje, por nuk ia dal dot mbanë.

Ilmu'l-Batin, sipas Hasan Basriut:

“Është një mister hyjnor, të cilin Allahu e vendos në zemrën e robërve të tij dhe të cilin nuk e di asnjë prej krijesave”. Ajetin: “Pastro rrobat e tua!” e komenton në formën: “Zbukuro moralin tënd!” dhe thotë: “Gjuha e të urtit është e lidhur me zemrën e tij. Kur dëshiron të thotë diçka, konsultohet me zemrën dhe, nëse është e dobishme, e thotë, përndryshe hesht. Ndërsa zemra e injorantit është e lidhur me gjuhën e tij. Gjuha nuk ndjen nevojë për t'u konsultuar me zemrën, kështu që flet mbarë e prapë.”

“Njerëzit e devotshëm vazhdimisht zgjedhin heshjen. Asnjëherë nuk flasin pa folur zemrat a tyre.”

Së fundi, burri i dijes dhe i veprës, murshidi i madh Hasan Basriu, i cili thotë: “Kur të duash t'i urdhërosh diçka dikujt, së pari bëje vetë!”, u bë shembull për popullin, duke i përjetuar në vetvete vazat dhe këshillat e tij.

Në vitin 110 hixhri (728 p.e.s.), kur ndërroi jetë, xhenazeja iu fal nga një kallaballëk i madh në vendin e tij, Basra. Madje, sipas një transmetimi, kur ai ndërroi jetë, disa miq të Allahut kanë parë se janë hapur dyert e qiellit dhe kanë dëgjuar një thirrës që thërriste kështu:

“Hasan Basriu ndërroi jetë, kur Allahu ishte i kënaqur prej tij.”



Qila është më e rëndësishme për lumturinë, pamja apo natyra e njeriut?!

..... ❧ *Sami Byjkkajnak* ❧

Njeriu vjen në këtë botë me formë fizike dhe pamje të caktuar, pasi Allahu ia jep formën që dëshiron, që në mitrën e nënës. Një nga atributet e Zotit është edhe Musavir (Ai që u jep formën krijesave). Ngjyrat dhe format e shumëllojshme janë shenja që tregojnë fuqinë e Zotit.

Meqë askush nuk e përcakton formën e tij që prej lindjes, por është Zoti Ai që përcakton gjatësinë, ngjyrën e lëkurës, formën e tij, atëherë kuptohet që të gjithë këto karakteristika nuk janë fryt i përpjekjeve dhe punës së tij personale. Njeriu nuk mund të tregohet superior ndaj të tjerëve me gjëra që nuk i fiton me punën e tij. Vlera e secilit matet në përputhje me ato që ai fiton. Allahu thotë kështu, në lidhje me këtë çështje: “Çdo njeri do të marrë atë që ka punuar.” (Tur, 21). Në thelb, dëshirohet një zemër e pastër, një iman që nuk u lë vend dyshimeve dhe veprat e mira. I dërguari i Allahut ka thënë: “Allahu nuk ju sheh pamjen e jashtme apo pasuritë që keni, por zemrat dhe veprat tuaja.” (Ibn Maxhe, Hadith no: 4143)

Natyrisht që çdo person dëshiron të ketë pamje dhe fizik të bukur. Vetëm se bukuria fizike nuk është kriteri themelor. Për më tepër, bukuria është relative dhe ndryshon nga personi në person. Mund të ndodhë që diçka, që dikujt i duket e bukur, të mos i duket e tillë dikujt tjetër. Ta shohësh Lejlanë me sytë e Mexhnunit, është tërësisht e ndryshme sikur ta shohësh atë me sytë e një personi tjetër.

Bukuria trupore është kalimtare dhe e improvizuar. Ata që janë të bukur në rini, nuk janë të tillë në pleqëri. Edhe nëse zbukurohen sadopak me anë të makijazhit apo operacioneve estetike, kjo bukuri e improvizuar nuk do të vazhdojë përherë dhe, për më tepër, nuk e zëvendëson kurrë bukurinë natyrale.



Gjithë këto duhet ta mësojnë njeriun të ndjekë bukurinë që nuk vyshket dhe nuk zhduket, e cila është bukuria morale. I dërguari i Allahut pati thënë se një mashkull martohet me një femër për hir të bukurisë, të pasurisë, të prejardhjes së saj, por ai i këshillonte myslimanët që të preferonin të martoheshin me një femër, për shkak të fetarisë së saj, sepse aty gjendej edhe begatia martesore. Sa e sa njerëz e kanë fytyrën të ndritshme si dielli, por zemrën e kanë sterrë. Mund të ndodhë edhe e kundërta. Bilali e kishte fytyrën të zezë si nata, por zemra e tij qe e bardhë si bora. Ebu Lehebi e kishte fytyrën të ndritshme, por përbrenda ishte i zi sterrë. Sado të zbukurohet dhe të ndriçohet nga jashtë, një ditë trupi i njeriut do të bëhet dhe. Shpirtrat vlerësohen sipas hijeshisë apo pabukurisë shpirtërore. Ata nuk do të zhduken. Sa bukur e ka shprehur Junus Emre: “Vetëm trupi do të vdesë, sepse shpirti nuk di ç`është vdekja. Trupi që ushqen, një ditë do të bëhet ushqim për krimbat.”

Edhe evlijatë theksojnë rëndësinë e shpirtit dhe jo të trupit, kur shprehen: “Sa e parfumos lëkurën, parfumose më mirë shpirtin, se trupi një ditë do të bëhet dhe.”

Bukuria e vërtetë është të ecësh në vijën e moralit, etikës dhe njerzillëkut, por në përgjithësi njerëzit i japin rëndësi bukurisë fizike dhe stolive të improvizuara, duke hedhur pas krahësh bukuritë shpirtërore. Kjo dobësi vihet re tek njeriu, në çdo kohë dhe në çdo vend. Dëshiroj të jap një shembull mahnitës se si duhen ndarë nga njëra-tjetra dhe duhen vlerësuar bukuria fizike dhe ajo shpirtërore:

Sad Sulejmi qe një skllav i zi, nga brezi i sahabëve. Ai qe një mysliman i devotshëm. Një ditë shkoi në xhami, fali namazin dhe iu afrua Profetit Muhamed. Njerëz të ndryshëm e kishin rrethuar Profetin dhe i bënë pyetje, në lidhje me punët e kësaj jete.

Sadi u ngrit në këmbë dhe e pyeti: “O i dërguari i Allahut! A thua vallë, unë nuk do të hyj në xhenet, sepse nuk kam pamje të bukur dhe jam i zi?” I dërguari i Allahut i tha: “Betohem tek Allahu, falë fuqisë së të Cilit jetoj, se ti do të hysh në xhenet, në qoftë se do të respektosh urdhrat e Zotit dhe do të besosh tek ato që të thotë Profeti i Tij.”

Pas këtyre fjalëve, Sadi tha: “Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij. Zotohem se do të luftoj në rrugën e

Allahut. Çfarë do të fitoj unë në këmbim të këtyre që sapo thashë?” Profeti tha: “Ti do të gëzosh të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë të gjithë besimtarët. Ti u bërë vëlla me ta në fe.” Pas këtyre fjalëve, Sadi tha: “Unë kam kërkuar dorën e bijave të atyre që janë dhe nuk janë krah teje, por që të gjithë refuzuan, sepse e kam fytyrën e zezë dhe nuk jam i pashëm. Unë rrjedh nga fisi i beni Sulejmëve.”

Pas këtyre fjalëve, profeti tha: “Shko tek shtëpia e Amr bin Vehbit, trokiti në derë, jepi selamin tim dhe thuaj se i Dërguari i Allahut më ka martuar me bijën tënde!” Sadi shkoi tek shtëpia e Amr bin Vehbit, siç e urdhëroi Profeti. Trokiti në derë. Kur u hap dera dha selam dhe tha: “Më ka dërguar Profeti i Zotit. Ai më tha që të të them të më japësh vajzën tënde për grua!”

Amr b. Vehb e shtyu me dhunë Sadin. Sadi u kthye që të largohej. Vajza e Amrit kishte dëgjuar pas perdes së çfarë kishte ngjarë dhe i thirri me zë të lartë Sadi: “O robi i Zotit! Në qoftë se është ashtu siç thua ti, se i dërguari i Allahut ka urdhëruar që ne të dy të martohemi, edhe unë jam e kënaqur me atë që është i kënaqur Allahu dhe i dërguari i tij!” Sadi ndali një çast, por pastaj u largua me mendimin se vajza nuk kishte të drejtën e fjalës së martesës, për sa kohë që kishte të atin gjallë.

E bija i tha të atit: “Baba! Shko menjëherë tek i dërguari i Allahut dhe pranoje propozimin e tij, para se të zbresë ndonjë ajet në lidhje me këtë çështje dhe pastaj të turpërohesh përgjithmonë në mesin e arabëve. Allahu urdhëron dhe thotë: “Besimtarët dhe besimtarët nuk kanë të drejtë të bëjnë çfarë të dëshirojnë, në lidhje me një çështje për të cilën kanë vendosur Allahu dhe i dërguari i Tij.” (Ahzab, 36) I ati e kuptoi se e bija qe më e ndjeshme dhe më e ndërgjegjësuar në këtë pikë, sesa ai, prandaj u ngrit menjëherë dhe u nis për tek i Dërguari i Allahut që t’i kërkonte ndjesë dhe t’i thoshte se ishte i kënaqur me urdhrin e tij. Sadi kishte mbërritur më parë tek i Dërguari i Allahut dhe i kishte treguar ç`kishte ngjarë. Kur erdhi Amri, i dërguari i Allahut e pyeti përse e kishte refuzuar Sadin për dhëndër. Amr b. Vehb i qe përgjigjur: “O i Dërguari i Allahut! Kujtova se nuk po më thoshte të vërtetën, prandaj erdha këtu tek ju që të mësoj si qëndron e vërteta. Tani që e shoh se ai më ka thënë të vërtetën, unë shpall këtu para



të gjithëve se bija ime do të martohet me Sadin.” I Dërguari i Allahut e uroi për këtë martesë Sadin dhe i tha: “Shko dhe hyr në gjerdek me gruan tënde.” Sadi qe shumë i lumtur. Ai shkoi në treg të merrte diçka për vete dhe për gruan e tij.

Kur mbërriti në treg, dëgjoi një zë që thërriste me të madhe: “O kalorësit e Allahut! Hipuni kuajve, që të gëzoheni me sihariqin e Allahut me xhenet!” Myslimanët po bëheshin gati për xhihad. Sadi hoqi dorë nga ato që donte të blinte për martesë dhe shkoi te tregu i armëve dhe i kuajve. Aty bleu një kalë, një shpatë dhe një shigjetë. Mori pjesë në betejë, ku luftoi si kalorës dhe si këmbësor dhe në fund fare, ra shehid. I Dërguari i Allahut i shkoi pranë, e mori në gushë dhe ia përkëdheli kokën. Kalin dhe shpatën e Sadit urdhëroi t`ia çonin gruas së tij dhe pastaj shtoi: “Thuajuni të afërmeve të Sadit se Allahu e martoi Sadin me një hyri, shumë më të mirë se bija juaj. Kjo është trashëgimia që ju ka lënë.” Pastaj Profeti lexoi ajetin: “*Nuk ka dyshim se ata që e ruajnë veten e tyre nga të këqijat, do të jenë në vende, në kopshte dhe në burime të sigurta. Ata do të rrinë kundruall njëri-tjetrit, të veshur me rroba të holla pambuku dhe me rroba të ndritshme prej atllasi. Ja kështu! Ne do t`i martojmë ata me hyri që kanë sy të bukur, të zinj dhe të mëdhenj.*” (Duhan, 51-54) (Ahmet Muhamed Asaf, Kabisatun min hajati-r-Rasul, fq. 164-166)

Ashtu siç kuptohet nga kjo ngjarje, nuk është e rëndësishme nëse njeriu e ka fytyrën të zezë dhe nuk është i bukur, por e rëndësishme është që ai të ketë zemrën e bardhë dhe jetën e rregullt. Gjëja më e pranueshme tek Allahu, është zemra e pastër. **“Atë ditë nuk do të bëjnë punë, as pasuria dhe as fëmijët. Atë ditë do të fitojnë vetëm ata që kanë një zemër të pastër.”** (Shuara, 88-89)

Vlera e vërtetë e një njeriu, matet me vlerat morale dhe shpirtërore që ai zotëron. Do të ishte krejt pa vend dhe e panevojshme të shtrohej pyetja: Më mirë i varfër, por i ndershëm apo i pasur dhe i pandershëm? Çdo gjë fiton vlerë me anë të njeriut të mirë. Edhe gjërat e bukura, në vetvete bëhen të shëmtuara, kur i zotëron një njeri i keq.

Le të tregoj edhe një ngjarje tjetër, që nxjerr në pah vlerën e vërtetë të njeriut:

Një ditë, një person erdhi tek profeti. Profeti e pyeti personin që qëndronte pranë tij:

- Çfarë mendimi ke për këtë njeri?

Ai u përgjigj:

- Ky njeri është nga paria dhe njeri me famë. Në goftë se ai kërkon dorën e një femre, e meriton t`ia japësh, në goftë se kërkon të bëjë ndërmjetësim, e meriton t`i dëgjohet fjala.

Pastaj aty kaloi një person tjetër, për të të cilin Profeti e pyeti atë që kishte pranë:

-Po për këtë person, çfarë mendon?

Këtë herë, ai u përgjigj:

-O i dërguari i Allahut! Ky është një mysliman i varfër. Po kërkoi dorën e një vajze, ia refuzojnë, po deshi të bëjë ndërmjetësim, nuk e respektojnë dhe, kur kërkon të flasë, nuk e dëgjon kush.

Pas këtyre fjalëve i dërguari i Allahut tha: “*Ky njeriu i fundit është më i vlefshëm, sesa njeriu i dhënë pas botës, siç ishte ai tjetri.*” (Buhari, Nikah 15; Ibn Maxhe, Zuhd 5)

Nga ky hadith mësojmë se varfëria nuk është më e mirë sesa pasuria apo se dobësia është më e mirë sesa forca, por njerëzit nuk mund të nënvleftësohen, për shkak se janë të dobët apo të varfër. Vlera e njeriut nuk matet me prejardhjen, pasurinë dhe pozitën e tij, por me devotshmërinë që ka.

Njerëzit shpeshherë mund të japin vlerësime të gabuara. Pasuria, pozita, fama dhe pamja e jashtme të gënjëjnë. Në mënyrë që të peshosh dhe të vlerësosh drejt gjërat, duhen përdorur masat e peshës hyjnore. Për të treguar se njerëzit vlerësojnë edhe gabim profeti, ka thënë:

“*Ditën e gjykimit do të vijnë njerëzit, që në jetën e përkohshme kanë pasur fizik të madh dhe famë, ndërsa, përpara Allahut nuk do të kenë vlerë më shumë, sesa flatra e një mize.*” (Rijadu’s-Salihin, Hadith no: 257)

Në lidhje me ata njerëz, që nga pamja e jashtme janë të mahnitshëm, por nga brenda janë të zbrazët, Zoti urdhëron dhe thotë: **“Kur i sheh, ty të mahnitin ata që janë trupmëdhenj. Kur të flasin, ua dëgjon fjalën. Ata janë në të vërtetë si dordolecë të veshur me rroba.”** (Munafikun, 4)

E gjithë çështja është të jesh njeri, jo me pamje, por me sjellje. E para është imitim, ndërsa e dyta është origjinale. Zoti na bëftë njerëz të vërtetë! Amin.

Domosdoshmëria e të lexuarit të Kuranit

Ma. Gilman Kazazi

Pse duhet të lexohet Kurani? Cilat janë motivet që mund ta nxisin opinionin shqiptar të interesohet për Kuranin? Çfarë na ofron Kurani? A do të ndryshojmë apo do vazhdojmë të ngelim buzë paragjykimeve shekullore?

Pyetje të njëjta janë diskutuar edhe në rrethet e jomyslimanëve për Librat e tyre. Le t'i parashtrijmë disa arsye për këtë domosdoshmëri islame. Çdo mysliman duhet të veprojë në përputhje me mësimet e Kuranit, si dhe t'i ftojë të tjerët për ta lexuar dhe ndjekur Udhëzimin Hyjnor.

1 - Kurani duhet të lexohet, sepse ai është baza dhe themeli i besimit islam, legjislatura dhe burimi themelor i mësimetve islame. Mund të themi se, nuk ka Islam pa Kuran dhe pa profet nuk mund të ketë një model perfekt të Islamit. Nuk mund të praktikohen parimet e Islamit dhe porositetet e Allahut, nëse nuk lexohet Kurani. Qëllimi i zbritjes së Kuranit është për t'u lexuar, kuptuar dhe zbatuar në jetë. Kurani nuk është shpallur vetëm për t'u puthur apo për të shërbyer si nuskë që Allahu të na mbrojë prej rreziqeve. Kurani nuk është hajmali, por është receta më e përkryer që i nevojitet njeriut në çdo situatë.

Allahu thotë: *"Ky është Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty atë që t'i studiojnë argumentet e tij dhe të marrin mësim prej tij ata që kanë mend."* (Sad, 29)

Në një tjetër verset thuhet: *"Ne të zbritëm ty, (o Muhamed) Librin (Kuranin) me plot të vërteta, që të gjykosësh mes njerëzve me atë që të mësoi Allahu..."* (en-Nisa', 105)

2 - Historia dëshmon se asnjë libër nuk ka pasur ndikim më të madh në jetën e njerëzimit, sesa Kurani.

Po të vërehet ndikimi i tij tek gjeneratat e para të myslimanëve, do të shohim se arabët, nga njerëz të paqytetëruar e primitivë, u shndërruan në njerëz të zhvilluar. Nga njerëz analfabetë, u kthyen në njerëz të shkolluar, nga njerëz dogmatikë e me bestytini,

u bënë njerëz racionalë me logjikë të shëndoshë, nga njerëz pasues e të shtypur, u ngritën në njerëz udhëheqës e sundimtarë. Kurani i shtyu arabët drejt civilizimit. Zhvillimi i çfarëdo disipline shkencore tek arabët, nuk mund të merret me mend pa Kuranin. Në sajë të këtij libri hyjnor, u përhap gjuha arabe në popuj të ndryshëm, të cilët, duke pranuar Islamit, pranuan edhe gjuhën e Kuranit dhe kontribuan në përparimin e civilizimit islam në gjuhën arabe. *"Është e vërtetë se ky Kuran udhëzon për atë rrugë që është më se e vërtetë (më e mira, më e drejta, më e qarta)..."* (el-Isra', 9), kurse profeti Muhamed (a.s.), thotë: *"Me të vërtetë Allahu i lartëson me këtë Libër disa popuj (njerëz), e disa të tjerë i nënçmon."* (Myslimi).

Ndikimi i Kuranit është prezent edhe sot në botën arabe. Ai është faktori themelor në ruajtjen e gjuhës letrare të dhjetëra shteteve arabë. Arabishtja e Kuranit është gjuha esenciale e shkencave islame dhe gjuha diplomatike e tërë myslimanëve. Kurani dhe gjuha e tij janë faktorët kryesorë në bashkimin e botës islame, aq heterogjene në pikpamje kulturore, ekonomike dhe politike e aq të përhapur gjeografikisht.

Ndikimi dhe udhëzimi i Kuranit vihen re edhe në botën perëndimore. **(Ket Stevens) Jusuf Islami**, prej yjeve të muzikës moderne, vitet '70, në moshën 27-vjeçare pranon Islamit e shkak për këtë ishte leximi i përkthimit të kuptimeve Kuranore. **Fadlullah Wilmont**, një historian nga Australia, gjatë studimeve universitare ka vënë re ndikimin e Islamit në mendimin evropian dhe kontributin e myslimanëve në shkencat e ndryshme. Myslimanët kishin trashëguar urtësinë e lashtë të Egjiptit e Babilonisë, kishin përkthyer dhe ruajtur shumë njohuri nga shkenca dhe filozofia e Persisë dhe e Greqisë së vjetër, që përndryshe do të kishin humbur. Në sajë të kureshtjes dhe mendjes së vyer e të hapur, myslimanët kishin genë të aftë të sillnin të reja nga shkenca dhe tek-

nikat e Indisë dhe të Kinës. Kështu që, F. Wilmont u interesua për librin e shenjtë të myslimanëve, libër të cilin e gjeti në bibliotekën e universitetit ku studionte. Pasi vendos që ta lexojë Kuranin me një sy kritik, ngelet i ndikuar nga madhështia kuranore dhe pranon Islam, duke arsyetuar si më poshtë: "Në Kuran nuk ka kundërshtime e kontradikta; Kurani nuk u bie ndesh të vërtetave shkencore; Kurani përfshin çdo aspekt të jetës".

Kurani, i cili vazhdimisht thërret për kultivimin e shkencës, përmban shqyrtime të shumta shkencore me detaje shpjeguese, që janë tërësisht në përputhje me arritjet e shkencës bashkëkohore. Ekuivalentet e këtij lloji nuk ekzistojnë në shkrimet hebraiko-krishtere.¹

"Sa herë që ne i drejtohem Kuranit, në fillim na shkakton neveritje, dhe çdoherë sërish ai së shpejti bëhet tërheqës, na mallëngjen dhe më në fund na detyron ta nderojmë... Stili i tij, në pajtim me kontekstin dhe qëllimin e tij, është i rreptë, madhështor dhe i tmerrshëm - përgjithmonë i lartësuar - kështu që ky libër do të ushtrojë ndikim shumë të fuqishëm gjatë tërë kohës." Johan Volfgang fon Gëte (1794 - 1832)².

"Kurani, sipas mendimit përgjithësisht të pranuar, zë vend të rëndësishëm ndër librat e mëdhenj religjiozë në botë. Ndonëse është më e reja prej veprave më të rëndësishme që i përkasin këtij niveli të literaturës, ai nuk ia lëshon rrugën asnjë veprë tjetër në efektin e mrekullueshëm që ka ndikuar në masat e gjera të njerëzve. Ai ka krijuar një fazë gati të re të mendimit njerëzor dhe një tip të ri të karakterit. Ai së pari ka transformuar një numër të fiseve heterogjene në shkretëtirën e Gadishullit Arabik në një popull heroik, dhe pastaj ka vazhduar të krijojë organizata të panumërta politike-fetare të Botës Islame, të cilat janë një nga format më të mëdha, në të cilat Evropa dhe Lindja duhet të llogarisin sot". George Margoliouth (1853-1924).³

3 - Kurani është i vetmi libër në botë, në të cilin ndodhen fjalët origjinale të Zotit të Gjithësisë, i pandryshuar, i pastër nga çdo ndërhyrje njerëzore. As peygamber, as sundimtar, as qeveritar e as dijetar nuk kanë guximin të shtojnë apo pakësojnë, qoftë edhe një germë në Kuran.

Originaliteti i pakundërshtueshëm i jep tekstit kuranor vend të posaçëm ndër të gjitha librat e Shpalljes. Tekstin e tij, ashtu siç është shpallur, e kanë mësuar përmendsh Profeti (a.s.) dhe shokët e tij dhe e kanë shënuar shkruarit e tij të afërt. Pra, që në fillim të shpalljes, Kurani përmban këto dy elemente të autenticitetit, që nuk i kanë as Teurati, as Psallmet e as Ungjijtë.

1. Bibla Kurani dhe shkenca, Maurice Bacuille, Istanbul, 2007, fq: 135.

2. Cituar në T.P. Hughes, Dictionary of Islam, p. 526.

3. The Koran, New York, Everymans Library, 1977, fq. VII.

Për dallim nga Bësëlidhja e Vjetër, në të cilën mund të gjejmë versione të ndryshme të të njëjtit tregim, kundërthënie, gabime historike, gjëra të pabesueshme dhe mospërputhje me njohuritë shkencore të vërtetuara mirë. Këto janë krejtësisht të natyrshme në të gjitha veprat njerëzore të lashtësisë.⁴

E njëjta gjë vlen edhe për Ungjijtë. Fantazmagoritë e Mateut, kundërthëniet e hapta mes Ungjijve, gjërat e pabesueshme, mospërputhjet me të arriturat e shkencës bashkëkohore, ndryshimet e vazhdueshme në tekste, bëjnë që Ungjijtë të kenë kapituj dhe fragmente që vetëm e zbulojnë imagjinatën e njeriut. Por këto mangësi nuk e vënë në dyshim ekzistimin e misionit të Jezusit.⁵

4 - Kurani është zbritur për ne, njerëzimin. Ai është dhurata më e madhe që Allahu i ka dhuruar njerëzimit. Kurani nuk u drejtohet vetëm arabëve, në gjuhën e të cilëve është shpallur, ai i drejtohet njeriut si qenie njerëzore: "O njeri! Çka ju ka larguar juve prej Zotit tuaj". (el-Infitar, 6). "O ju njerëz! Juve ju erdhi nga Zoti juaj Këshilla (Kurani) dhe Shërimi i asaj që gjendet në kraharorët tuaj (në zemra), edhe Udhëzim e Mëshirë për besimtarët." (Junus, 57). Është shpallur që t'u përgjigjet nevojave të jetës, t'u japë zgjidhje problemeve të jetës, t'i tregojë njerëzimit qëllimin e jetës në këtë botë dhe t'i mundësojë njeriut ta njohë vetveten. Në Kuran gjendet ilaçi i shërimit të ndjenjave egoiste dhe epshore që e robërojnë njeriun dhe e ulin atë me poshtë se kafsha. Në të gjendet çelësi i lumturisë dhe balsami i qetësisë shpirtërore.

Paramendoni, nëse një udhëheqës apo një njeri shumë i dashur ju dërgon një letër ose një shkresë, a do ta lexoni atë letër? Sunduesi dhe Krijuesi i gjithësisë ju ka dërguar Kuranin, që jeta juaj të jetë më e mbarë, më e begatë, më e dobishme: "Ne të shpallim Kuranin, që është Shërim dhe Mëshirë për besimtarët..." (el-Isra', 82).

Fjalët: *Këshillë, Shërim, Udhëzim dhe Mëshirë*, janë epitetet e Kuranit dhe mesazhet që ai përçon tek njerëzimi.

Lexues i nderuar, nuk mund të përcillet mesazhi i saktë i Kuranit, nëse nuk e lexojmë dhe nuk e kuptojmë. Nuk mund të reflektojmë Kurani në paraqitjen tonë, në mentalitetin tonë dhe në sjelljen tonë, nëse nuk e studiojmë atë.

Në vitin 1895 ish-kryeministri britanik (W. E. Gladstone, 1809-1898), me Kuranin në duar ka thënë: "Nuk do të realizojë Britania asnjë nga qëllimet e saj ndër arabë e myslimanë, vetëm nëse heq sundimin e këtij libri nga ata. Nxirreni sekretin e këtij libri nga mesi i myslimanëve, do të rrënohen para jush të gjitha pengesat e tjera."⁶

4. Bibla Kurani dhe shkenca, Maurice Bacuille, fq: 63.

5. Po aty, fq: 129.

6. Min revail-Kuran, Dr. Muhamed Seid el-Buti, Damask, 2002, fq.7-8.



Çtë mbjellësh, do të korrësh

Mustafa Erish

Për njeriun janë fitorja dhe humbja.

Njeriu, ose ecën andej nga Zoti e drejton dhe fiton xhenetin, vendin e lumturisë së përhershme, ose devijon dhe e humbet atë.

Ardhja e njeriut në këtë botë për t'u provuar, realizohet vetëm një herë në jetë.

Ndaj, duke u treguar të zgjuar, duhet të përpiqemi me gjithë fuqinë që kemi të shtojmë veprat e mira në këtë botë.

Çtë mbjellësh në këtë botë, atë do të korrësh në botën tjetër.

Miqtë e Allahut e kanë vlerësuar këtë botë, si vendin e mbjelljeve dhe botën tjetër si vendin e korrjeve.

Në tefsirin *“Ruhulbejan”*, është tregimi i një skllavi, që bëhet shkak të zgjohet dhe të shpëtojë i zoti i tij.

Është shumë e vështirë të kthesh në rrugë të drejtë një njeri që jeton në kryengritje dhe shkujdesje.

Por, të përpiqesh të udhëzosh një njeri, që të hyjë në rrugë të vërtetë, është një vepër shumë e vyer dhe me shumë shpërblime.

Le ta përmendim këtë tregim që jep mësimë shumë domethënëse dhe shton vullnetin për kumtesë në fe:

Tregohet se në Belh, një njeri i tha shërbëtorit që të mbillte grurë.

Ai mbolli elb.

Kur erdhi koha e të korrave, i zoti pa që ishte mbjellë elb dhe pyeti menjëherë shërbëtorin për arsyen.

Shërbëtori, duke bërë sikur nuk po e kuptonte se përse kishte ndodhur ashtu, dha një përgjigje prej naivi:

- Zotëri, mbolla elb me qëllim që të dalë grurë.

Zotëria, duke menduar se shërbëtori po tallej me të, i tha i nxehur:

- O budalla! Ke parë ti ndonjëherë që të mbillet elb dhe të korret grurë?

Shërbëtori, i cili kurrë nuk ia kishte bërë fjalën dysh të zotit dhe që kish treguar gjithnjë kujdes dhe kishte punuar shumë për të, po përpiqej me çdo kusht të shpëtonte dhe të thoshte të vërtetën.

Kur mendoi se ishte koha e duhur, dha një përgjigje të tillë, që aty e tutje ndryshoi gjithçka:

- Atëherë, o zotëri! Si shpreson se do të meritosh mëshirën e Zotit, ndërkohë që i kundërvihesh gjithnjë Atij?

Pas kësaj përgjigjeje, i zoti u shtang i tëri.

Kjo ishte një fjalë e vërtetë, qortuese dhe shumë ndikuese.

Shërbëtori ishte i vetëdijshëm dhe i sigurtë me sjelljet e tij.

Duke ndikuar që zotëria i tij të zgjohej, dëshironte me gjithë zemër që ai të shmangej nga kundërvënia ndaj Allahut.

I zoti u ndikua shumë nga kjo përgjigje, e ndjeu veten fajtor dhe nisi të pendohej.

Iu mbështet Allahut dhe i bëri istigfar Atij, duke u penduar për kryengritjet që i kishte bërë Atij prej vitesh.

Pastaj, i dha lirinë skllavit të vet, që kishte dhënë këtë përgjigje kaq domethënëse, që u bë shkak të zgjohej dhe të shpëtonte.

Edhe ai edhe i zoti arritën shpëtimin.

Ja pra, përpjekja që tregohet për të shpëtuar një njeri!

Ja pra, kujdesi që tregohet për kumtin islam!

Ja pra, mençuria dhe zgjuarsia!

Mbi të gjitha, qëllimi i pastër!

Pastaj, sinqeriteti, zgjuarsia dhe përpjekja!

Dhe pastaj, me këtë metodë, të përgatisësh zemrën që të ta pranojë Zoti!

Çfarëdo që të ketë mbjellë njeriu në këtë botë, atë do të korrë në tjetrën.

Bota është ara e ahiretit.

Në arë duhet të mbjellësh gjëra të mira.

Duhet të krijosh miqësi për hir të Allahut dhe duhet nisur rrugëtimi drejt Tij.

Në “*Ruhulbejan*”, lidhur me veprat e mira dhe sjelljet e bukura, në *Tevilatun-Nexhmijje*, thuhet këto:

“Për njerëzit e imanit dhe të veprave të mira do të ketë një shpërblim të përshtatshëm me sinqeritetin dhe bukurinë e veprave.

Me disa nga veprat e mira arrihet në xhenet dhe në qoshqet e tij.

Këto janë ibadete fizike, që bëhen me qëllim të mirë.

Me disa nga veprat e sinqerta arrihet tek Allahu.

Ato janë ibadete shpirtërore.

Të kërkosh sinqeritetin dhe të vërtetën.

Sinqeritetin në tevhid.

Të heqësh nga zemra dashurinë për këtë botë.

Të heqësh dorë nga gjithçka tjetër përveç Allahut.

Të drejtohesh nga Allahu, me tërë qenien tënde.

Të dorëzosh tek një murshid vullnetin tënd, i cili të shpie tek e përsosura, tek sinqeriteti dhe tek e vërteta,

Ta përqafosh fort atë dhe të mos mashtrohesh nga dëshirat e kota.

Sepse ai që mbjell elb, kurrë nuk do të korrë grurë.

*Arhja e njeriut
në këtë botë për t'u provuar,
realizohet vetëm një herë në jetë.*

*Ndaj, duke u treguar të zgjuar,
duhet të përpiqemi me gjithë
fuqinë që kemi të shtojmë veprat
e mira në këtë botë.*

*Ç'të mbjellësh në këtë botë,
atë do të korrësh
në botën tjetër.*

Besimi në Allahun

Prof. dr. M. Jashar Kandemir

Allahu Teala, i ka urdhëruar të gjithë robërit e Tij, duke u thënë:

“...S’ka Zot tjetër përveç Meje, andaj vetëm Mua më adhuroni!” (Enbija, 25)

Me anë të këtij urdhri të prerë, Allahu i Madhëruar na e bën të ditur se s’ka Zot tjetër përveç Tij. Dhe na thotë se ai që i beson Atij, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë.

Ai thekson se çdo krijesë në qiej dhe në tokë, me dëshirë apo pa dëshirë, i përulet Atij dhe se njeriu nuk duhet të kërkojë fe tjetër përveç Islamit.

SHKURTIMISHT

Të gjithë duhet t’i kthehen Zotit të tyre dhe të gjithë duhet të nxjerrin në pah ndjenjën e fesë, të cilën Allahu Teala e ka vendosur brenda njeriut, kur e ka krijuar. Kjo, sepse ashtu siç ka thënë edhe Profeti (a.s.), të gjithë kanë kapacitetin e duhur për të pranuar fenë e Allahut.

Në shumë ajete të Kuranit Kerim thuhet:

Ata që i besojnë Allahut dhe bëjnë punë të mira, përgëzohen me mirësitë e pafundme të xhenetit. Ndërsa, ata që nuk besojnë Allahun, do të përballen me fatkeqësi, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

AJETI QË TREGON MË MIRË PËR ALLAHUN

Allahu Teala, në Kuranin Kerim, ka treguar për Vetën e Tij, aq sa ka dëshiruar që ne të dimë për Të. Ajeti që jep informacione më të qarta dhe më

të organizuara në lidhje me besimin në një Zot të vetëm, është “ajetu’l-Kursi”. Profeti (a.s.), ka thënë se ai është ajeti më rëndësishëm i Kuranit.

Kuptimi i këtij ajeti, është si më poshtë:

“Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!” (Bekare, 255)

FORMULA E TEUHIDIT

Si do ta tregojë një rob që i ka besuar Allahut, pra që është besimtar? Sipas asaj që ka thënë Profeti (a.s.), besimi ka deri në gjashtëdhjetë ose shtatëdhjetë degë. Në krye të këtyre, zë vend fjala, “La ilaheil-lallah”.

Ai që thotë “La ilaheil-lallah”, ka thënë se



“Allahu është një dhe i vetëm”. Këtë shprehje e njohim ndryshe edhe si Formula e Teuhidit. Por le të dëgjojmë se çfarë ka thënë i Dërguari i Allahut (a.s.), në lidhje me rëndësinë e Formulës së Teuhidit dhe se çfarë përfitojmë prej saj:

“Kush thotë La ilaheil-lallah, hyn në xhenet.”

“Kush vdes duke besuar se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, hyn në xhenet.”

“Ai që thotë fjalën e fundit të tij: “La ilaheil-lallah”, hyn në xhenet.”

“Ai që thotë “La ilaheil-lallah”, le të ketë bërë ç’ të dojë më parë, sepse një ditë kjo fjalë do ta shpëtojë.”

Profeti ynë (a.s.), kishte shumë dëshirë që xhaxhai i tij, EbuTalibi, të bëhej mysliman. Dhe këtë dëshirë ia paraqiti shumë herë. Prandaj, kur xhaxhai i tij ishte në shtratin e vdekjes, ai i tha edhe njëherë:

“Xhaxha! Thuaj La ilaheil-lallah, që në ditën e gjykimit të dëshmoj pro teje.”

Mirëpo, xhaxhai i tha:

“Nipi im! Sikur ta dija se kurejshët nuk do të më akuzonin duke thënë se “u bë mysliman nga frika”, do ta kisha plotësuar dëshirën tënde duke e thënë atë fjalë.”

Mbi këtë ngjarje zbriti edhe ajeti i më poshtëm:

“Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njuh më mirë ata që janë të udhëzuar.” (Kasas, 56)

EMRAT E BUKUR TË ALLAHUT

Kur idhujtarët e Mekës i kërkuan Profetit (a.s.), t’u tregonte për Zotin në të cilin besonte, zbriti surja el-ihlas, e cila e prezanton Allahun shkurt dhe me cilësitë më të spikatura:

“Thuaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amëshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Të!’” (Ihlas, 1-4)

Në Kuranin Kerim janë përmendur **“Emrat më të bukur të Allahut”.**

Këta emra, të cilat quhen edhe “esmau’l-husna”, janë përmbledhur në këto tre ajete:

“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!”

“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim!)”

“Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që i jep trajtë çdo gjëje. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (Hashr, 22-24)


Profeti ynë (a.s.), na ka përgëzuar, duke thënë: “Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra. Njëqind pa një. Kush i mëson përmendsh, duke ua ditur edhe kuptimin, hyn në xhenet. Allahu është tek dhe e do tekun.” (Buhari, Muslim, Nesai, Tirmidhi, Ibën Maxhe)

AI ËSHTË KRIJUESI I ÇDO GJËJE

Sipas atyre që kemi mësuar prej shumë ajeteve, Allahu Teala është i Vetmi që mban gjithçka në dorë, që merr dhe jep, që lartëson dhe poshtëron, që vdes dhe ngjall. Këtë e tregojnë më së miri këto dy ajete:

“Thuaj (o Muhamed): ‘O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.’”

“Ti bën që nata të hyjë tek dita dhe dita të hyjë tek nata. Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës. Ti i jep kujt të duash pa kufij.” (Ali Imran, 26-27)



Bajramet

e dashurisë dhe respektit

Xhafer Durmush

Dy dhuratat më të bukura të islamit janë festa e Fitër Bajramit dhe ajo e Kurban Bajramit. Në të parën, shpresojmë arritjen e mëshirës së Allahut Teala, ngaqë përgjatë një muaji jemi përpjekur ta kalojmë Ramazanin me ibadet, bindje dhe mirësi. Ndërsa në festën e Kurban Bajramit, përpiqemi të gjallërojmë kujtimin e faljes hyjnore, e cila u realizua prej nënshtrimit të Hz. Ibrahimit dhe Hz. Ismailit duke përfitur nga nënshtrimi i tyre. Në ajetet 3 dhe 4 të sures el-Enfal, përkufizohen cilësitë dalluese të besimtarëve dhe thuhet:

“Ata japin (për hir të Allahut) **prej asaj që u kemi dhënë.”** Edhe ne përpiqemi të hyjmë në grupin e këtyre fatlumëve.

Kur i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, përgatitej për këto ditë të bekuara, këshillonte që të mos nënvlerësohej ana shpirtërore e tyre dhe thoshte se “gjallërimi i netëve të bajrameve me ibadet ka një virtyt të veçantë.” (Shik. Ibn Maxhe, Sijam, 68.) Në lidhje me këtë, mund të themi:

Për ta kryer çdo gjë me atmosferën e adhurimit, duke filluar nga vizitat e deri te nderimet dhe dhuratat që bëhen, duhet ta përgatisim zemrën një natë më parë. Duhet të pendohemi dhe t’i kërkojmë falje Allahut të Madhëruar. Së pari, duhet ta qortojmë veten në mënyrë që të shtrijmë dorën e pajtimit. Duhet ta përgatisim veten për dhuratën më të mirë që do të bëjmë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), për të treguar se si duhet t’i fillojmë këto ditë të veçanta që trokasin në derën tonë dy herë në vit, ka thënë:

“Gjëja e parë që do të bëjmë sot është falja e namazit.” (Buhari, Idejn, 3.) Pejgamberi (a.s.), atmosferën e lumtur në ditët e bajrameve, dëshiron t’i fillojmë duke u bashkuar me njerëzit që tubohen plot hare nëpër xhami. Pa u larguar shumë nga atmosfera e namazit të sabahut, i cili falet me shoqërimin e tekbireve dhe të salavateve, Pejgamberi dëshiron që në namazin e bajramit të gjithë duart të ngrihen drejt qiellit. Kështu duhet të fillojnë besimtarët ta perceptojnë bajramin. Të gjitha aktivitetet e tjera duhet të fillojnë pasi të përjetohet kjo atmosferë.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, thotë: “Këto ditë, janë ditë ngrënieje dhe pirjeje.” (Ebu Davud, Saum, 50.) Pejgamberi (a.s.), dëshiron ta dimë se sofrat më të bukura që mund të shtrohen ditëve të bajrameve janë ato që shtrohen me vetëdijen e zbatimit të urdhrat profetik.

Veçanërisht duhet të mendojmë për faljen e namazit të bajramit në sheshe të mëdha që bënte i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, për të siguruar sa më shumë pjesëmarrje. Duhet të mendojmë për gjetjen e jetimit të brengosur dhe ngushëllimin e tij.

Erzurumllu Ibrahim Hakkë shprehet në Marifet-namen e tij:

Ju i jepni vetëm atij që ju jep, i shkoni atij që ju vjen, i flisni atij që ju flet, i jepni për të ngrënë atij që ju jep për të ngrënë dhe nderoni atë që ju nderon. Këtu nuk keni ndonjë epërsi ndaj njëri-tjetrit. Por

virtyti është t'i bësh mirësi atij që të bën keq, të shkosh te ai që nuk të vjen, të flasësh me atë që të qëndron larg, t'i japësh për të ngrënë atij që nuk të jep dhe të nderosh atë që të tradhton. Atëherë, ju jini falës dhe modestë! Mbuloni gabimet e njerëzve dhe silluni me dhembshuri ndaj tyre, në mënyrë që të mëshiroheni!..

Pastaj i jep vend transmetimit të hadithit kudsij të mëposhtëm:

“Besimtarët duhet ta këshillojnë njëri-tjetrin për mirësi. Duhet ta mëshirojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin. Duhet t'ua lehtësojnë hallet vëllezërve të tyre duke i diskutuar dhe duke i ndarë ato me njëri-tjetrin. Kur ndonjëri prej organeve të trupit dhemb, edhe organet e tjera e ndjejnë atë dhimbje, dhe ndihmojnë derisa ai shërohet. Kur ndjen dhimbje një organ, i gjithë trupi shqetësohet.” (203. Muslim, Birr, 65.)

“Kushdo që e lumturon vëllain e tij mysliman në këtë botë, Allahu Teala e gëzon atë në këtë botë dhe

në botën tjetër. Kushdo që e shpëton vëllain e tij mysliman nga njëra prej vështirësive të kësaj bote, edhe Allahu Teala do ta shpëtojë atë nga vështirësitë e Ditës së Kiametit.” (209. Buhari, Mezalim, 3.)

Elhamdulillah, sot kemi më shumë mundësi për të vizituar njëri tjetrin se sa në të kaluarën. Kemi shumë mjete, me anë të të cilave mund të komunikojmë dhe t'u shprehim të tjerëve dashurinë e respektin, kemi institucione bamirësie, me anë të të cilave mund ta ndajmë kafshatën tonë me myslimanin, që mund të ndodhet në anën tjetër të botës.

Atëherë, të gjithë duhet t'i kërkojnë llogari vetes: “Sa i vetëdijshëm jam unë për përcjelljen e traditave në të ardhmen, tradita të cilat janë mbujtur me shumë finesë e modesti, derisa kanë ardhur te ne?” Ne duhet të përpiqemi të japim kontributin tonë për zhdukjen e zemërimeve në shoqëri, në sajë të festave të bajrameve dhe ta respektojmë e ta duam në mënyrë reciproke njëri-tjetrin.

Lexo, Mendo

Pastërtia shpirtërore dhe fizike

Në suren Bekare, thuhet: **“Me të vërtetë, Allahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen.”**

Islami i ndërlihd bashkë, pastërtinë fizike e shpirtërore me pastërtinë e mjedisit, shëndetin e individit me shëndetin e shoqërisë. Prandaj ka nxjerrë në pah një shoqëri që do të jetë shembull gjithmonë për të gjithë njerëzimin. Sepse në Islam nuk mund të ndahet pastërtia fizike nga ajo shpirtërore. Ato konsiderohen plotësuese të njëra-tjetrës. Çdo fjalë apo sjellje që i dëmton njerëzit, është rixhs (ligësi).

Ka shumë ajete fisnike që e thërrasin myslimanin për t'u pastruar shpirtërisht dhe fizikisht. Në suren el-Ahzab, thuhet:

“Ata që i lëndojnë besimtarët dhe besimtare, duke i akuzuar për diçka që nuk e kanë bërë, në të vërtetë, i

kanë ngarkuar vetes fajin për shpifje dhe një gjynah të qartë.”

Imam Neveviu e përmend ajetin e mësipërm para haditheve që bëjnë fjalë për pastërtinë dhe pastaj bën këtë shpjegim: “Ata që ndotin rrugët, sokaqet, vendet me hije, vendet me ujë dhe fusha të tjera që janë vende publike, kanë lënduar të gjithë njerëzit.” Sepse, ata që i bëjnë këto gjëra të shëmtuara kanë dhunuar të drejtat e të gjithë njerëzve. Nisur nga kjo, ata kanë bërë një mëkat të hapur.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:


“Pastërtia është gjysma e besimit.”

Hz. Pejgamberi ka njoftuar:

“Ndotja e rrugëve ku kalojnë njerëzit dhe e vendeve me hije”, janë dy sjellje që tërheqin mallkimin. Nisur nga kjo, në çdo vend dhe kohë jemi të obliguar ta mbajmë pastërtinë në të gjitha aspektet.

KURANI

LAJMI TRONDITËS



Abdullah Draz

Kurani, për vetë rëndësinë e madhe që ka, duke qenë jo vetëm libër hyjnor, por edhe gur themeli mbi të cilin është ndërtuar qytetërimi, kultura dhe shoqëria islame, është bërë objekt studimi për shumë shkencëtarë, myslimanë dhe jomyslimanë. Shumë orientalistë janë përpjekur të hedhin dyshime mbi autorësinë e Tij hyjnore, duke ia mveshur atë Muhamedit (a.s.). Mbi mrekullitë shkencore të Kuranit, që vërtetojnë burimin e Tij hyjnor, janë shkruar shumë libra. Por ne këtu do të përpiqemi të trajtojmë karakterin hyjnor dhe pamundësinë e Muhamedit (a.s.), për të qenë autor i Kuranit në një këndvështrim ndryshe.

Për myslimanët, Kurani është fjalë e Allahut, si nga përmbajtja edhe nga forma. Ai nuk mund të jetë kurrë një vepër njerëzore. Kurani është një kryevepër letrare dhe estetike. Për nga këshillat, parimet morale, juridike dhe shoqërore që përmban, është një vepër madhështore. Ai po ashtu është një thesar dhe burim i pashtershëm. Për nga informacionet metafizike që jep, është një mrekulli më vete. Një mendimtari ose shkrimtari i mjafton të ketë autorësinë e vetëm një pjesë të vogël të këtij libri, për t'u bërë i pavdekshëm në historinë e njerëzimit. Megjithatë, Pejgamberi (a.s.), nuk pretendon autorësinë e këtij libri, të cilin

do ta dëshironte çdo shkrimtar. Ai jo vetëm që nuk e pretendon, por me zë të lartë predikon autorësinë e Tij hyjnore. Përballë refuzimit të autorësisë së këtij thesari, kur të tjerët do të sakrifikonin gjithçka për ta pasur, nuk mbetet gjë tjetër përveçse të pranohet siç është. Është për t'u habitur nga disa që kërkojnë argumente për të pranuar autorësinë hyjnore të këtij libri.

Një mendje djallëzore mund të thotë: Muhamedi (a.s.), ia ka atribuar autorësinë, Allahut për të fituar prestigj dhe autoritet. Por përsa i përket lidhjes dhe besimit të fortë të tij tek Allahu, e gjithë jeta e Tij është dëshmi për këtë. Po ashtu, të gjithë janë të një zëri, qofshin miq apo armiq të tij, përsa i përket besnikërisë dhe sinqeritetit të tij. Një njeri që thotë vetëm të vërtetën për njerëzit, nuk mund të mendohet se do të gënjejë për Allahun. Historia e Muhamedit (a.s.), na jep një profil të qartë të sinqeritetit dhe besnikërisë së tij. Në një rast kur një grup vajzash të vogla po thurnin vargje lëvduese për dëshmorët e luftës së Bedrit, një vajzë ndër të tjera thuri një varg të tillë: "Në mesin tonë ndodhet një Pejgamber që di të ardhmen." Pejgamberi (a.s.), sapo e dëgjoi, ndërhyri duke e korrigjuar dhe e ndaloi të thoshte një gjë të tillë. Kurse në një rast tjetër, kur

vdiq Osman ibn Maz, një grua tha: “Unë jam dëshmitare që Allahu të ka shpërblyer dhe vendosur në një pozitë të lartë.” Pejgamberi (a.s.), i tha: “Ku e di ti se Allahu e ka shpërblyer atë, unë jam i dërguari i Allahut dhe nuk e di përfundimin tim...” Kjo sjellje e tij është paralel me ajetin Kuranor: **Thuaju: “Unë nuk jam i pari i dërguar dhe nuk e di çfarë do të ndodhë me mua ose me ju. Unë ndjek vetëm atë që më është shpallur dhe kam për detyrë vetëm të jap paralajmërime të qarta.”** (Ahkaf, 9) Të mendojmë për një moment se Pejgamberi (a.s.), nuk gënjente, sepse kishte frikë se mbas një kohe mund t’i dilte gënjeshtria në shesh. Atëherë, çfarë e pengonte të gënjente për çështje metafizike, ku mundësia për t’u zbuluar gënjeshtria nuk ekziston, përveç frikës nga Gjykatësi Suprem.

Vetë Muhamedi (a.s.), ka konfirmuar se fjalët e Tij për nga vlera juridike janë të barasvlefshme me dispozitat kuranore. Prandaj, për të përcaktuar ndalesën apo lejimin e diçkaje nuk është kusht konfirmimi kuranor. Mjafton gjykimi i hadithit për të përcaktuar dispozitën juridike të saj dhe vlefshmëria e kësaj dispozite është e njëjtë me një dispozitë të përcaktuar qartë nga Kurani. Megjithatë, Ai bënte një ndarje të qartë midis hadithit dhe Kuranit. Madje, për një kohë relativisht të gjatë, nga frika e përzjerjes me njëritjetrin, e pati ndaluar shkrimin e haditheve. Nga ana tjetër, një njeri që ka sadopak shije letrare e kupton shumë lehtë dallimin midis stilit kuranor dhe hadithit sepse kanë stile qartësisht të dallueshme midis tyre. Një kritik letrar, duke lexuar hadithet dhe jetën e Pejgamberit, mund të nxjerrë një profil të qartë në lidhje me mendimet, idetë, ndjenjat dhe botën shpirtërore të tij, gjë që nuk ndodh me Kuranin.

Autori i Kuranit nuk mund të gjendet as midis politeistëve, të krishterëve apo hebregjeve. Sepse Kurani, megjithëse përfshin histori dhe ngjarje nga Bibla dhe Teurati, ai flet për detaje që nuk gjenden në to dhe herë-herë bën korigjimet e duhura. Një nxënës, që mëson dy gjëra nga një mësues, nuk mund të marrë guximin të sfidojë mësuesin. Është e pamundur për një person analfabet të japë informacione të tilla të detajuara historike. Detajet historike hasen edhe në numra, si në ajetin:

“Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet (diellorë), duke shtuar nëntë (për vitet hënore).” (Kehf, 25.)

Nuk thotë 309 vjet, por treqind plus nëntë për të shprehur ndryshimin midis kalendarit diellor dhe hënor. Kjo është një matematikë shumë e hollë për një analfabet. Nëse të dhënat historike do të ishin produkte të intelektit të tij, patjetër që me kalimin e kohës do të përballej me gabime. Mendjes së shë-

ndoshë i ka hije të pranojë revelatën hyjnore të Kuranit.

Kurani flet për fitoren dhe triumfin e myslimanëve qysh në periudhën e Mekës. Si mund të marrë guximin një njeri të pretendojë një gjë të tillë në ato kushte që ishin myslimanët, ku ishte në dyshim ekzistenca, jo më të bëhej fjalë për fitore dhe sundim mbi tokë. Si mundet një njeri të jetë kaq i sigurt për fitoren përveçse me ndihmën e një informacioni qiellor? Kush do ta siguronte atë pas vdekjes se feja e tij nuk do të zhdukej?

“Në të vërtetë, jobesimtarët e shpenzojnë pasurinë e tyre për t’i penguar njerëzit nga rruga e Allahut. Ata do ta shpenzojnë atë, por në fund ajo do jetë vetëm dëshpërim për ta, sepse do të jenë të mundur.” (Enfal, 36.)

“Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët.” (Saff, 9.)

Përveç disfatës së mushrikëve, Allahu flet edhe për përplasjet e myslimanëve me hebregjtë. **“Kudo që gjenden, ata janë të kapluar nga poshtërimi, vetëm nëse kanë ndonjë mbrojtje prej Allahut apo prej njerëzve. Ata merituan zemërimin e Allahut dhe do t’i kaplojë mjerimi.”** (Al ‘Imran, 111.)

Historia është dëshmitare e poshtërimit të hebregjeve dhe pamundësisë për të jetuar dhe siguruar ekzistencën e një shteti normal vetëm kur kanë qenë nën mbrojtjen e myslimanëve dhe kur janë mbështetur nga ndonjë fuqi tjetër botërore. Vetëm në këtë mënyrë kanë arritur ta sigurojnë ekzistencën e vet. Si mundet një njeri të japë informata kaq të përpikta dhe të sakta për të ardhmen dhe të kaluarën. Vetëm Krijuesi i gjithësisë mund të japë një verdikt kaq të prerë për një popull të tërë.

Ku e gjente sigurinë se nuk do të vdiste pa e përbushur misionin? Kjo është një siguri që nuk mund ta pretendojnë as njerëzit më të fuqishëm të botës, sepse vdekja mund t’i vijë në çdo moment njeriut. Një siguri të tillë mund ta japë vetëm Ai që jep dhe merr jetën. **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë.”** (Maide, 67.)

Kur besimtarët emigruan në Medine, menduan se gjetën qetësinë, mirëpo atje u përballën me luftë, armiqësi dhe rrezik për shfarosje. Në një gjendje të tillë frike dhe pasigurie, ku myslimanët flinin me armë te koka dhe bënë roje me turne për t’u ruajtur nga sulmet, Kurani i lajmëronte për sundim planetar. **“Allahu u ka premtuar atyre që besuan prej jush dhe bëjnë vepra të mira se do t’i bëjë mëkëmbës në Tokë,**

ashtu siç kanë bërë ata para tyre dhe do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe frikën do t'ua shndërrojë në siguri.” (Nur, 55.)


Përmes këtij ajeti, Allahu u premtonte besimtarëve brenda një kohe të shkurtër sundim botëror. Ky sundim nuk u premtohet vetëm besimtarëve të pranishëm në atë kohë, por të gjithë besimtarëve që do të bëjnë vepra të mira.

Një tjetër anë që tregon burimin hyjnor të Kuranit është mungesa e diturisë dhe informacionit të Pejgamberit (a.s.), në lidhje me disa detaje, përfundime dhe kuptimin e ajeteve. Nëse Kurani do të ishte veprë e Tij, është e pashpjegueshme thurja e vargjeve pa u ditur kuptimin. Për më tepër, kur kjo gjendje i trondiste atij autoritetin dhe shpesh e vendoste në një pozitë shumë qesharake. Një person nuk mund t'i urdhërojë as vetes e as të tjerëve urdhëresa që nuk ua di kuptimin dhe urtësinë. Kjo tregon që Ai ishte thjesht një transmetues i mesazhit.

Në vitin e gjashtë të hixhretit Pejgamberi (a.s.), së bashku me 1500 sahabë niset nga Medina për në Mekë, për të vizituar vendin e shenjtë, Qaben, sepse kishin vite që nuk e vizitonin dot për shkak të idhujtarëve kurejshë. Nga ana tjetër, myslimanët ishin fuqizuar shumë gjatë kësaj kohe, kurse kurejshët ishin dobësuar nga ana ekonomike dhe ushtarake. Nëse do të donte Pejgamberi (a.s.), mund ta merrte me forcë Mekën që atëherë, por nuk e bëri një gjë të tillë, sepse qëllimi ishte vetëm vizita. Kur arriti në vendin e quajtur Hudejbije, deveja e tij ndaloi së ecuri. Me gjithë përpjekjet, nuk e bënë dot të ecte. Përballë kësaj, Pejgamberi (a.s.), tha: “E ndaloi Ai, i Cili ndaloi edhe elefantin”. Kjo nënkuptonte që Allahu, ashtu si nuk lejoi Ebrehenë të pushtonte Qaben me luftë, nuk do të lejonte as myslimanët të merrnin Mekën me luftë. Pejgamberi (a.s.), pa e kuptuar urtësinë iu bind shenjës hyjnore dhe fushoi në Hudjebije, duke e ndaluar kështu përparimin drejt Mekës. Kërkesës së myslimanëve për të vizituar Qaben kurejshët iu përgjigjën negativisht, megjithëse myslimanët ishin të veshur me ihram dhe kishin marrë me vete kafshët për kurban. Pra ishin përgatitur me gjithë zemër

për të vizituar Qaben. Megjithëse nuk kishte forcë që mund t'i ndalonte të hynin në Mekë, kurejshët vendosën kushte shumë të rënda për myslimanët. Pejgamberi (a.s.), e pranoi marrëveshjen me gjithë kushtet e rënda që përmbante. Ngaqë nuk mundën të vizitonin Qaben, Pejgameri (a.s.), i urdhëroi të dilyn nga Ihrami dhe të bënin kurbanet aty ku ishin. Me gjithë bindjen absolute ndaj Pejgamberit, sahabët hezituan në zbatimin e urdhrat të Tij. Omeri (r.a.), si përfaqësues i grupit të pakënaqur me kushtet e marrëveshjes, i thotë Pejgamberit (a.s.): “Përse po e nënçmojmë kështu fenë tonë?” Pejgamberi (a.s.), megjithë rrezikun për t'u përballur me kundërshtimin e të gjithë sahabëve, i përgjigjet: “Unë jam i Dërguari i Allahut dhe nuk mund t'i dal kundër Atij, Ai është ndihmësi im.” Me këtë donte të thoshte se edhe ai ishte një njeri si ata dhe marrja e këtij vendimi nuk ishte në kompetencën e Tij. Si përfundim, Pejgamberi (a.s.), së bashku me sahabët u kthyen mbrapsht pa e kuptuar urtësinë e kësaj marrëveshjeje, në pamje të parë krejtësisht në disfavor të myslimanëve. Urtësia e kësaj marrëveshjeje mbeti enigmë, deri sa Allahu e zbuloi në suren Fet'h. Kur u realizuan sihariqet e Kuranit, e kuptuan që marrëveshja, në dukje kundër tyre, kishte qenë një fitore e madhe për ta. Çfarë vlere kanë masat që merr njeriu përballë masave që merr kaderi?! Dijetari i famshëm Zuhri bën një evidentim shumë interesant në lidhje me marrëveshjen e Hudejbijes: “Asnjë fitore përpara Hudejbijese nuk ka qenë më e madhe se ajo, sepse më parë, sapo myslimanët përballëshin me idhujtarët, fillonte grindja dhe luftimi. Por me nënshkrimin e marrëveshjes, gjendja u qetësua, gjakrat u ulën, kjo sollti reflektimin e palës kundërshtare dhe gjatë kësaj kohe u kthyen në myslimanë, armiqtë e përbetuar të Islamit, si: Halid ibn Velidi, Amr ibn Asi e shumë figura të tjera të shquara të kurejshëve. Numri i njerëzve që pranuan Islamit gjatë kësaj periudhe, e kaloi numrin e myslimanëve të konvertuar gjatë 19 të viteve të kaluara.”

Një nga kushtet e marrëveshjes ishte që myslimanët të vizitonin Qaben vitin tjetër dhe përveç shpatës që mbahet vazhdimisht me vete të mos merrnin asnjë armë tjetër. Si mund t'u besonin myslimanët kurej-



shëve, kur ata ishin të gatshëm të bënin gjithçka për të vrarë Pejgamberin (a.s.)? Si mund të ishin të sigurt se ata nuk dëshironin shfarosjen e të gjithëve? Mirëpo Allahu u siguroi atyre kryerjen e ritit dhe kthimin e sigurt. **“Allahu e vërtetoi saktësinë e ëndrrës së të Dërguarit të Tij, Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë Allahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtuar, pa kurrfarë frike. Ai e dinte atë që nuk e dinit ju dhe, veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt.”** (Fet’h, 27.)

Shpallja shpesh vinte në kundërshtim me mendimin e Tij për një çështje të caktuar, madje në disa raste kishte ngjyra të forta kritike.

“Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre, pasi u është bërë e qartë se ata janë banorë të Xhehenemit.” (Teube, 113)

Sa për atë që është i pasur, ti atij po i kushton vëmendje, megjithëse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet. Sa për atë që të vjen duke nxituar dhe ndjen frikë (nga Allahu), ti atij nuk po ia veshin. Mos vepro ashtu! Në të vërtetë, ky (Kuran) është këshillë, pra, kush të dojë, le të marrë këshillë! (Abese, 5-12.)

“Asnjë profet s’ka të drejtë të ketë rob për vete, derisa të arrijë fitore të plotë në Tokë. Ju dëshironi të mirat kalimtare të kësaj bote, kurse Allahu dëshiron botën tjetër. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë. Sikur të mos ishin urdhërimet e mëparshme të Allahut (për lejimin e plaçkës së luftës), do t’ju godiste një dënim i madh për atë që keni marrë.” (Enfal, 67-68.)

Nëse Muhamedi (a.s.), do të ishte autor i Kuranit, vënia në dukje e gabimeve të veta do ishte jashtë arsyes, i parrokshëm për mendjen e njeriut.


Megjithëse profetët janë njerëzit më inteligjentë dhe të urtë në botë, ata përsëri kanë rënë në gabime. Për ilustrim po japim rastin e Jakubit (a.s.), kur i akuzoi fëmijët për sjelljen e dëshmisë së rreme në lidhje me gjakun, duke u thënë: **“Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka.”** (Jusuf, 18.) dhe në lidhje me vjedhjen në sarajet e Faraonit, kur i thanë se në trastën e Benjaminut u gjet një send i vjedhur. Ai

edhe në rastin e dytë tha të njëjtën gjë: **“Nuk është kështu, por ju keni sajuar diçka.”** (Jusuf, 83.) Jakubi (a.s.), në rastin e parë qëlloi, kurse në të dytin gaboi, sepse ata thanë të vërtetën.

Vetë Pejgamberi (a.s.), ka mbrojtur fajtorin duke e gjykuar si të pafajshëm, deri sa i ka ardhur zbulesa hyjnore. **“Vërtet, Ne (o Muhamed) ta kemi zbritur Kuranin me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykosh ndërmjet njerëzve sipas asaj që të ka shpallur Allahu. Dhe mos u bëj mbrojtës i tradhtarëve!”** (Nisa, 105.)

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti ishte gjykimi i gabuar që dha Pejgamberi (a.s.), në lidhje me një vjedhje. Myslimani Tuame ibn Ubejrik i kishte vjedhur parzmoren fqinjit të tij Katade ibn Numanit. Kur Numani filloi kërkimet për gjetjen e parztores, Ibn Ubejriku nga frika e zbulimit e fshehu parzmoren në oborrin e një hebreu. Kur Numani e gjeti parzmoren në shtëpinë e hebreut, çështjen ia çoi Pejgamberit (a.s.), për gjykim. Kur Pejgamberi (a.s.), e mori në gjykim çështjen, hebreu pohoi se parzmoren e kishte lënë ibn Ubejriku tek ai. Ibn Ubejriku së bashku me një grup burrash nga fisi i tij e mohuan fjalën e hebreut dhe të gjithë dëshmuan se vjedhjen e kishte kryer hebreu. Kur Pejgamberi (a.s.), duke u nisur nga provat dhe dëshmitë po mendonte të jepte gjykim kundër hebreut, zbriti ajeti i mësipërm, i cili e shpallte të pafajshëm hebreun, në këtë mënyrë Allahu zbardhi të vërtetën duke dhënë një gjykim të kundërt me të Pejgamberit (a.s.).

Si mundet një njeri të nxjerrë me anë të mendjes dhe logjikës përfundime të vërteta në lidhje me të ardhmen dhe të shkuarën, kur nuk mund të gjejë të vërtetën midis dy njerëzve në konflikt. Arsyeja dhe inteligjenca humbasin vlerën për sa i përket identifikimit të ngjarjeve që kanë lidhje me të ardhmen dhe botën metafizike. Një njeri që gjykon në këtë sistem, njëherë qëllon dhe shumë herë të tjera gabon. Nëse do të ishte kështu, ajeti Kuranor: **“A nuk përsiatin ata mbi Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”** (Nisa, 82.) do të ishte një sfidë e pakalueshme.



DIJETARË TË ROBËRUAR PAS DYNJASË

Prof. dr. Sulejman Derin

Imam Rabbani në kryevepërn e tij të famshme “Mektubat”, nuk prek vetëm temat e mistikës, por në të njëjtën kohë prek dhe përpiket të gjejë zgjidhje për shumë çështje që i interesojnë shoqërisë islame. Kjo vepër nuk u drejtohet vetëm njerëzve të ditur, por edhe popullit.

Siç dihet, feja islame i jep një rëndësi të madhe diturisë dhe shkencës. Nga hadithet e Pejgamberit (a.s.), informohemi se boja e penës së dijetarit është më e shtrejtë se gjaku i martirit dhe humbja nga vdekja e një dijetari është si humbja e tërë njerëzimit. Dijetarët janë elementi më i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për përhapjen e fjalës së Allahut, por në të njëjtën kohë ndonjëherë janë përgjegjësit kryesorë për dëmet që mund t'i vinë fesë. Sidomos dijetarët që nuk e kanë pastruar zemrën nga dashuria e kësaj bote dhe vazhdimisht punojnë për përfitimet e kësaj bote, janë duke i shkaktuar dëme të mëdha kësaj feje.

Dashuria dhe dhënia e dijetarëve pas botës qëndron si një njollë e zezë në fytyrat e tyre të bukura.

Dituria e dijetarëve të tillë mund të jetë e dobishme për njerëzit, por ajo nuk i jep asnjë dobi zotëruesit të saj. Ata mund të kontribuojnë për forcimin dhe përhapjen e Islamit, mirëpo ndonjëherë këtë gjë e bëjnë edhe të shtururit dhe jobesimtarët. Ashtu siç na informon vetë Pejgamberi (a.s.), në një hadith: “Allahu do ta lartësojë këtë fe, qoftë edhe përmes njerëzve të shturur.” (33. Mektub)

Sipas Imam Rabbanit, dijetarët që e përdorin diturinë për përfitime materiale janë në një humbje të madhe, sepse dijetarë të tillë, për të siguruar përfitime, e interpretojnë fenë sipas egos së tyre. Kështu, në vend që t'i shërbejnë fesë, u shërbejnë interesave të veta. Imam Rabbani në formë kritike për ta thotë:

“Ata janë si guri i çakmakut. Në gurin e çakmakut ka energji. Njerëzit përfitojnë nga kjo energji duke ndezur zjarr, kurse guri nuk përfiton asgjë nga zjarri që ndez. E njëjta gjë ndodh edhe me dijetarët e pasinqertë, të cilët nuk përfitojnë asgjë nga dituria që zotërojnë. Madje kjo dituri, shpesh është e dëmshme dhe kundër tyre. Sepse në Ditën e Gjykimit, nëse i pa-

dituri do të mund të justifikohet duke thënë se nuk e dinte, dijetarët nuk kanë asnjë mundësi për një alibi të tillë.” Hadithi profetik në lidhje me këtë thotë: “Në Ditën e Gjykimit, dënimin më të ashpër do ta ketë dijetari që nuk ka përfituar nga dituria e vet.”

Kurse shkakun se përse është mëkat i madh përdorimi i diturisë për përfitime materiale, Imam Rabbani e tregon kështu: “Si mund të mos jetë mëkat i madh përdorimi i diturisë për përfitime materiale? Dituria ka një vlerë të paçmuar tek Allahu. Si mundet atëherë një dijetar i fesë ta përdorë diturinë për pasuri, famë dhe interesa të ulëta materiale? Dhënia pas kësaj bote është diçka e urryer nga Allahu. Atëherë, të shpenzosh diçka që Allahu e ka vlerësuar për të përfituar diçka që Ai e ka urryer, është një veprim shumë i ulët. Është nënçmim për atë që ka vlerësuar Allahu dhe vlerësim për atë që ka nënvlerësuar Allahu.

Thënë shkurt, kjo është të marrësh qëndrim kundër Zotit tënd. Dituria, mësimi, ligjërata, shkrimi janë të mira kur bëhen për hir të Allahut. Nëse dituria nuk përdoret për përfitime dhe interesa të kësaj bote, dobia e saj është e pallogaritshme për zotëruesin. Shenjë e dijetarit të sinqertë është mosdhënia pas kësaj bote.”

Sipas Imam Rabbanit, dijetari që ka në zemër këtë botë, në fakt nuk është dijetar i fesë. Sipas tij, ata janë vjedhës të thesarit fetar. “Dijetarët që janë dhënë pas kësaj bote, në të vërtetë nuk janë dijetarë të fesë, por dijetarë të pasurisë. Dijetarë të tillë janë vjedhës të paskrupullt të imanit.” Ajeti Kuranor: **“Ditën, kur Allahu t’i ringjallë të gjithë, ata do t’i betohen Atij, ashtu siç të betohen ty tani, duke menduar se kjo do t’u sjellë dobi. Në të vërtetë, pikërisht ata janë gënjeshtarët! Ata i ka vënë poshtë djalli dhe i ka bërë që të harrojnë përmendjen e Allahut. Ata janë pala e djallit; në të vërtetë, pala e djallit janë humbësit.”** (Muxhadele,18-19.), bën përkufizimin më të mirë të këtij lloj dijetari.

Detyra kryesore e dijetarëve të fesë është zbatimi i fesë dhe udhëzimi i njerëzve në çështjet fetare. Mirëpo, dijetarët e këqinj përpiqen të gjejnë mënyra për t’i larguar njerëzit nga feja. Në realitet, largimi dhe ftohja e njerëzve prej fesë është për shkak të fjalëve,

shkrimeve dhe qëllimeve të këqija të dijetarëve.

Dijetarët që duhet t’u qëndrojnë përballë këtyre, janë dijetarët e vërtetë të fesë. Dijetarët e vërtetë të fesë janë ata që e kanë pastruar zemrën nga ndotjet e kësaj bote, si: pasuria, pozita dhe fama. Këta janë dijetarët që Pejgamberi (a.s.), i ka shpallur si trashëgimtarët e pejgamberëve. Këta janë dijetarët, boja e penës e të cilëve është më e rëndë në peshoren hyjnore se gjaku i martirëve të rënë në rrugën e Allahut. Këta janë dijetarët, gjumi i të cilëve është adhurim. Janë pikërisht këta dijetarë, që në zemrat e tyre kanë vetëm Ahiretin. Këta kanë arritur ta kuptojnë natyrën mashtruese të kësaj bote. Prandaj nuk jepen pas gjërave të përkohshme dhe kalimtare, por fokusohen vetëm tek e përhershëmja dhe e amëshueshmja.

Por, nëse dijetarët interesohen për pasuritë e kësaj bote, jo për vete, por për të mirën e umetit, atëherë kjo është e lejueshme. Siç thotë edhe Rumi: “Pasuria e dijetarit që nuk pengon zemrën nga ibadeti ndaj Allahut, është një mirësi e madhe në shërbim të Islamit.” Por fatkeqësisht numri i këtyre dijetarëve është shumë i vogël.

Disa dijetarë, të cilët duket sikur janë dhënë pas pasurisë së kësaj bote, i kanë zemrat e tyre të zbrazura nga çdo shenjë dashurie për të, qëllimi i tyre është harxhimi i saj në rrugë të Allahut. Ajeti Kuranor: **“Ata shitblerja nuk i pengon nga përmendja e Allahut”** (Nur, 37.), bën fjalë pikërisht për këtë lloj dijetarësh.

Sot njerëzimi ka më shumë se kurrë nevojë për dijetarë altruistë dhe sakrifikes. Duke qenë se ngritja dhe rënia e Islamit është në dorë të dijetarëve, besimtarët që arsimohen në fushën e fesë duhet t’i shërbejnë kësaj feje me gjithë qenien e tyre, ashtu si sahabët, pa e preukopuar aspak zemrën për pasuritë e kësaj bote. Nëse dijetarët islam nuk sakrifikojnë dot as sa dijetarët e feve të devijuara, atëherë në mënyrë emergjente duhet kërkuar rruga për të shpëtuar nga kjo amulli dhe neglizhencë. Allahu i jep rizik dijetarit të vërtetë të fesë andej nga ai nuk e imagjnon dot. Prandaj është shumë gabim të luash me urdhëresat fetare nga frika e varfërisë.

Si mund të mos jetë mëkat i madh përdorimi i diturisë për përfitime materiale? Dituria ka një vlerë të paçmuar tek Allahu. Si mundet atëherë një dijetar i fesë ta përdorë diturinë për pasuri, famë dhe interesa të ulëta materiale? Dhënia pas kësaj bote është diçka e urryer nga Allahu.

Allahu ia jep urtësinë
kujt të dojë.
Atij që i është
dhënë urtësia,
i është dhënë
një mirësi e madhe.
Por këtë e kuptojnë
vetëm njerëzit
e mençur.

(Bekare, 269)

